

PLANIFIKIMI I PROKURIMIT NË KOMUNA



Autore: Samire Sahiti

Hulumtuese: Artë Kastrati

Monitorues: Qëndrim Arifi, Diell Haxhimusa

Redaktore: Albulena Nrecaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e INPO-s dhe IKD-së.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Iniciativa për Progres - INPO dhe Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan.

Ky botim është produkt i projektit “Kërko Drejtësi: Fuqizimi i qasjes në drejtësi në Kosovë”, i cili mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan përmes Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe zbatohet nga Instituti i Kosovës për Drejtësi - IKD në partneritet me Iniciativa për Progres - INPO.

Përkrahur nga:

Mars 2021

Prishtinë, Republika e Kosovës



PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
METODOLOGJIA	6
1. Rëndësia e planifikimit të prokurimit, sfidat dhe sukseset në realizimin e prokurimit.....	7
2. Dërgimi i planifikimit në AQP dhe ndryshimet si pasojë e rishikimit të buxhetit	9
3. Pasqyrë e përgjithshme e planeve të prokurimit 2020	10
3.1 Kontratat e planifikuara për punë dhe buxheti në 20 Komuna	10
3.2 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë në 20 komuna.....	11
3.3 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim në 20 komuna	13
PASQYRË INDIVIDUALE E KOMUNAVE	15
4.1 Kontratat e planifikuara për punë dhe buxheti	15
4.2 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë	16
4.3 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim	16
5. DRAGASH.....	18
6. FERIZAJ	21
7. GLLOGOC	24
8. GJAKOVË	26
9. GJILAN	29
10. KOMUNA KAÇANIK	33
11. KAMENICË.....	36
12. KLINË.....	39
13. LEPOSAVIQ	45
14. MITROVICË E JUGUT	48
15. MITROVICË E VERIUT	52
16. PEJË	54
16.3 ZBATUESHMËRIA E PLANIFIKIMIT TË KONTRATAVE PËR PUNË.....	55
17. PODUJEVË	58
18. PRISHTINË	62
19. PRIZREN.....	65
20. SUHAREKË	69
21. SHTIME	72
22. VITI	76
23. VUSHTRRI.....	79
KONKLuzionET	82
REKOMANDIMET	83

LISTA E SHKURTESAVE

AK	Autoritet Kontraktues
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LPP	Ligji për Prokurim Publik
LP	Planifikimi i Prokurimit
RrUOPP	Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik
ZKA	Zyrtari Kryesor Administrativ
ZKF	Zyrtari Kryesor Financiar

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

INPO ka monitoruar planifikimin e prokurimit për vitin 2020 të komunave: Deçan, Dragash, Ferizaj, Gllogoc, Gjakovë, Gjiilan, Kaçanik, Kamenicë, Klinë, Leposaviq, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Suharekë, Shtime, Viti dhe Vushtrri. Të gjeturat dëshmojnë se përkundër përpjekjeve, komunat kanë dështuar që të hartojnë planifikimin e prokurimit konform kërkesave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, RrUOPP dhe Formularit B01.

Në kuadër të hulumtimit, fillimisht është analizuar planifikimi sa i përket aktiviteteve për punë, përkatësisht është analizuar nëse vlera e aktiviteteve të planifikuara për punë a përputhet me kapacitetin buxhetor që komunat kanë në dispozicion. Gjetjet tregojnë se sa i përket aktiviteteve për punë, përveç Komunës së Kamenicës, Mitrovicës së Veriut, Vitisë dhe Gllogocit, komunat tjera kanë planifikuar të shpenzojnë shumë më shumë sesa që kanë buxhet në dispozicion. Kryesisht këto dallime të mëdha janë pasojë e asaj se komunat dështojnë që në plane të prokurimit të saktësojnë që projekti është me kohëzgjatje një (1), dy (2) apo më shumë vjeçar.

Tutje, Komunat kanë inicuar aktivitete për punë në vlerë më të madhe se sa ajo që është planifikuar për aktivitete. Kjo dukuri e mosrespektimit të planit të prokurimit vërehet tek të gjitha komunat e monitoruar, përjashtuar Komunën e Mitrovicës së Jugut, Deçanit, Gjakovës, Mitrovicë e Veriut, Vushtrrisë dhe Leposaviqit.

LPP-ja dhe Formulari B01 i miratuar nga KRPP, kërkojnë që aktivitetet e planifikuara për furnizim të hartohen në detaje të mjaftueshme, përkatësisht përveç emërimit të aktivitetit, vlerës së parashikuar, datës së planifikuar se kur do të filloj aktiviteti, të paraqiten edhe sasitë, njësitë dhe artikujt. Në bazë të hulumtimit të INPO-së, nga njëzetë (20) komunat e monitoruara, rezulton se vetëm Komuna e Klinës e ka hartuar planin e prokurimit konformë kërkesave ligjore, mirëpo pas analizimit vërejmë se edhe Komuna e Klinës gjatë fazave tenderuese e ka anashkuar planin e prokurimit gjë që përkundër që formalisht i ka vendosur artikujt, sasitë dhe njësitë të njëjtat nuk kanë qenë të identike gjatë fazës tenderuese, respektivisht nuk kanë qenë të planifikuara mirë.

Përveç që është e rëndësishme që aktivitetet për furnizim të hartohen në detaje të arsyeshme gjatë fazës së planifikimit, po aq e rëndësishme është që edhe gjatë fazës së inicimit të aktiviteteve, komunat të qëndrojnë prapa planifikimit për furnizime që kanë bërë. Për këtë qëllim është analizuar paramasa/lista e çmimeve gjatë fazës së inicimit të aktivitetit të prokurimit dhe e njëjta është krahasuar me artikujt, sasitë dhe njësitë e paraqitura në plan të prokurimit. Të gjeturat dëshmojnë për mospërputhje të mëdha. Kjo dukuri vërehet tek të gjitha komunat pa përjashtim. Se plani i prokurimit nuk është një dokument i cili respektohet nga ana e komunave të monitoruara, apo edhe se planifikimit të prokurimit nuk i kushtohet rëndësi, dëshmohet edhe për faktin se komunat inicojnë një varg të aktiviteteve të prokurimit të cilat nuk janë të përfshira në plan vjetor. Kjo dukuri vërehet tek komunat: Deçan, Mitrovicë e Jugut, Kamenicë dhe Gjiilan Dragash, Ferizaj, Klinë dhe Mitrovicë e Jugut.

Aktivitetet e planifikuara mund të realizohen vetëm nëse komunat kanë buxhet për e tyre. Nga hulumtimi i INPO-së, rezulton që jo për të gjitha aktivitetet për punë, të planifikuara nga komunat mund të identifikohen në buxhet. Përjashtuar komunën e Vitisë, Prizrenit, Dragashit, Mitrovicës së Veriut dhe Kamenicës, komunat tjera të monitoruara kanë projekte që janë planifikuar me plan të prokurimit, por që të njëjtat nuk mund të identifikohen në Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020. Secili projekt i planifikuar për punë do të duhej që të identifikohet lehtë edhe në buxhet, mirëpo gjatë hulumtimit, vërejmë që komunat nuk përdorin emërtime apo tituj të njëjtë, si në plan ashtu edhe në buxhet. Madje shumë nga to i fuzionojnë apo ndajnë aktivitetet e caktuara duke e vështirësuar dhe pamundësuar identifikimin e tyre. Tek komunat Pejë, Prishtinë dhe Gjiilan, vërejmë dukurinë e futjes së disa projekteve për punë në një kod të vetëm buxhetor, kjo mënyrë përveç që pamundëson identifikimin e projekteve, e njëjta lë hapësirë që mjetet e dedikuara për një aktivitet të caktuar të ri destinohen për ndonjë aktivitet tjetër të asaj kategorie pa u vërejtur nga jashtë dhe kjo praktikë si e tillë duhet të eliminohet.

METODOLOGJIA

Iniciativa për Progres (INPO) dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) *(në vazhdim të raportit e gjeni si INPO)* me qëllim që të hartojnë një raport sa më real dhe analitik në lidhje me zbatimin konceptual dhe sipas obligimeve ligjore të planifikimit të prokurimit, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit dhe analizës.

Fillimisht, hulumtimi përfshinë analziën e përgjithshme të planeve të prokurimit duke vlerësuar rregullësinë sipas kërkesave ligjore. Tutje, është bërë analiza në mes të kapaciteve buxhetore të komunave për vitin 2020-2023 për të gjitha kontratat e planifikuara për punë me planin e prokurimit dhe njoftimin për kontratë. Po, ashtu, INPO ka analizuar edhe kontratat e planifikuara për furnizime.

Gjithsej janë monitoruar dhe analizuar 175 kontrata në 20 komuna të Republikës së Kosovës, respektivisht në Deçan, Dragash, Ferizaj, Gllogoc, Gjakovë, Gjilan, Kaçanik, Kamenicë, Klinë, Leposaviç, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Suharekë, Shtime, Viti dhe Vushtrri (90 kontrata të punës dhe 85 kontrata për furnizime).

Mesatarisht secilës komunë i janë monitoruar 5 kontrata të planifikuara për punë dhe 5 kontrata të planifikuara për furnizime. Në disa komuna numri i monitoruar i kontratave për punë është më i vogël për arsye se gjatë periudhës së monitorimit vetëm kontratat e paraqitura në raport kanë qenë të iniciuara. Monitorimi përfshinë periudhën qershor - tetor 2020. Monitorimi i kontratave të planifikuara për punë është bërë duke krahasuar vlerën e parashikuar të kontratës në planifikimin përfundimtar të prokurimit me buxhetin e komunës si dhe njoftimin për kontratë. Ndërkaq, tek kontratat për furnizime, analiza është bërë duke krahasuar sasinë, njësitë dhe vlerën e parashikuar të kontratës sipas planit përfundimtar të prokurimit me njoftimin për kontratë dhe listën e përshkrimit të çmimeve (gjatë procesit të tenderimit).

Përzgjedhja e tenderëve të punës është bërë duke u bazuar në tejkalimin e vlerës së parashikuar të kontratës, ndërkaq tek kontratat e furnizimeve janë zgjedhur kryesisht kontratat që në planin e prokurimit kanë pasur të paraqitura artikujt, sasinë apo njësitë.

Janë zhvilluar intervista me zyrtarët përgjegjës të prokurimit si dhe është realizuar një pyetësor online me pyetje të hapura.

1. Rëndësia e planifikimit të prokurimit, sfidat dhe sukseset në realizimin e prokurimit

Prokurimi publik përbën një nga shtyllat e zhvillimit ekonomik të vendit duke marrë parasysh që përbën 1/5 e bruto produktit vendor dhe rreth gjysma e buxhetit të shtetit shpenzohet përmes sistemit të prokurimit.

Qëllimi i prokurimit është që të sigurojë shfrytëzim më efikas të fondeve publike, burimeve publike dhe që të arrijë vlerë për paratë që shpenzohen, gjatë ofrimit të shërbimeve publike nga organet shtetërore. Për të arritur këtë qëllim, prokurimi publik zhvillohet nëpërpjet tetë (8) fazave, të cilat në mënyrë zingjirore afektojnë zgjidhjet e prokurimit.

Hapi i parë në prokurim është planifikimi i prokurimit. Praktikisht, planifikimi i prokurimit është procesi i identifikimit dhe konsolidimit të kërkesave dhe përcaktimi i afateve kohore për prokurimin e tyre me qëllim që AK-ja t'i ketë ato kur i nevojiten. Planifikimi i prokurimit duhet të përfshijë analizën e të gjitha kontraktave apo aktiviteteve të prokurimit që priten të zhvillohen brenda një periudhe një (1) vjeçare.

Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë kërkon që “Jo më pak se tridhjetë (30) ditë para fillimit të çdo viti fiskal, secili autoritet kontraktues duhet të përgatisë, planifikimin paraprak të prokurimit, dhe në rast të një autoriteti publik apo një ndërmarrje publike duhet të dorëzojë me shkrim te Zyrtari Kryesor Administrativ i Autoritetit Kontraktues, në të cilat identifikohen me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët, që autoriteti kontraktues parasheh t'i prokurorë gjatë vitit fiskal në fjalë”. Gjithashtu, brenda 15 ditësh pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal, autoritetet kontraktuese janë të obliguara që Agjencisë Qendrore të Prokurimit t'i dërgojnë një planifikim përfundimtar.¹ Mirëpo, legjislacioni aktual, primar dhe sekondar nuk parasheh rregulla të qarta sa i përket planifikimit të prokurimit, duke mos përcaktuar apo dhënë udhëzime se KUR duhet të fillojë procesi i planifikimit, KUSH duhet të përshihet në proces dhe ÇFARË metodash dhe indikatorësh duhet përdorur për të bërë një planifikim të mirëfilltë të prokurimit.

Ndërkaq, në paragrafin 5.13 të nenit 5, të RrUOPP, thuhet se: *“Për të kryer një planifikim të mirë të prokurimit zyrtarit të prokurimit do ti nevojitet bashkëpunimi i ngushtë me departamentin e buxhetit dhe departamentet tjera. Zyrtari i prokurimit do të takohet me personat përgjegjës për buxhet dhe departamentet që bëjnë kërkesat(përdoruesit) dhe të diskutojë kërkesat e tyre për prokurim dhe buxhetin në disponueshmëri për vitin e ardhshëm dhe do të vendosë cilët artikuj të përfshihen në planifikimin paraprak dhe final të prokurimit.”* Në bazë të këtij neni, mund të kuptojmë se zyrtari përgjegjës i prokurimit është bartës i procesit të hartimit të planit të prokurimit, ndërkaq kërkesat dhe nevojat për prokurime duhet të burojnë dhe planifikohen direkt nga departamentet apo njësitë e kërkesës. Shpesh herë keqkuptohet roli i zyrës së prokurimit në procesin e planifikimit të prokurimeve ku kërkesa për llogaridhënie apo fatura e dështimit të planifikimit të mirëfilltë i adresohet zyrës së prokurimit.

Për të pasur një plan të mirëfilltë të prokurimit duhet që njësitë e kërkesës apo departamentet komunale t'i kenë të qarta kërkesat dhe nevojat e tyre dhe t'ia paraqesin zyrtarit/ëve të prokurimit dhe në bashkëpunim me ZKF-në të sigurohen se ka fonde të mjaftueshme në dispozicion për të mbuluar ato kërkesa, të cilat në fund të procesit miratohen nga ZKA-ja e AK-së.

¹ Neni 8, i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092




Figura 1. Akterët e përfshirë në planifikim të prokurimit

Kësisoj, planifikimi i prokurimit përveç që është një obligim ligjor, i njëjti është përcaktuesi kryesor lidhur me atë se a do të jetë AK-ja e suksesshme për atë vit ose jo.

Në këtë kuptim, planifikimi i prokurimit është procesi i vendosjes se *Çfarë* do të blihet, *Kur* dhe nga *Cili* burim. Gjatë procesit të planifikimit të prokurimit caktohet metoda e prokurimit dhe përcaktohen pritjet për përmbushjen e kërkesave të prokurimit.²

Për kundër, faktit që komunat fillojnë planifikimet me kohë dhe përfshijnë të gjithë akterët, ato deklarojnë së sfidat janë të pashmangshme dhe më të shpeshtat janë: mos përfshirja e aktiviteteve me kohë në planifikim, hartimi/ projektimi jo i saktë i projekteve, ndërrimi i shpeshtë i zyrtarëve bartës të buxhetit, dhe mos përshtatja e planifikimi me vlerat buxhetore në dispozicion.

Planifikimi i prokurimit i përgatitur me kohë dhe në mënyrë profesionale do të identifikonte kërkesat e njëjta ose të ndërlidhura brenda AK-së, për të cilat do të udhëhiqej vetëm një procedurë e prokurimit apo procedurë e përbashkët, e gjithë kjo për faktin e efikasitetit në kohë dhe e ruajtjes së parasë që do të shpenzohej për prokurime të shumta për çështje të njëjta ose të ndërlidhura.

Po ashtu, një planifikim i mirë do t'i grumbullonte të gjitha kërkesat e njësive brenda AK-së, të cilat pastaj do të prokurroheshin në mënyrë të planifikuar duke u anashkaluar mungesat e ndryshme brenda AK-së si dhe më e rëndësishmja do të kursehej paraja publike si pasojë e planifikimeve të shpeshta dhe të pa-koordinuara brenda AK-së.


Jo rastësisht më lartë u potencua fakti i një prokurimi profesional, pra sa është e rëndësishme që AK-të të kenë një plan të prokurimit brenda afateve ligjore, po aq e rëndësishme është që plani i prokurimit të jetë profesional. Profesionalizmi i planifikimit të prokurimit respektivisht, i përmbajtjes së tij ndër tjerash vlerësohet edhe me atë se sa AK-ja brenda vitit do t'i qëndrojë prapa planifikimit që ka bërë.

² The Procurement Classroom (Shkolla e Prokurimit) "Procurement-planning-and-the-procurement-plan-ëhy-are-they-important".

2. Dërgimi i planifikimit në AQP dhe ndryshimet si pasojë e rishikimit të buxhetit

Të gjitha autoritetet kontraktuese në bazë të ligjit janë të obliguara që në AQP ta dërgojnë planifikimin përfundimtar të prokurimit, jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal, respektivisht pas miratimit të buxhetit, për vitin 2020 buxheti është publikuar në gazetën zyrtare më 19.03.2020. Por, këtë vit kemi një situatë të jashtëzakonshme ku komunat janë përballur më devijim/ ndryshim të zhvillimit të aktiviteteve si pasojë e pandemisë COVID-19.

Figura 1. Publikimi i planeve të prokurimit



Për më tepër, rishikimi i buxhetit ka ndodhur në muajin gusht 2020, dhe me këtë rast AQP ka lëshuar një njoftim Nr. 124/20 më 01.07.2020, me ç'rast i ka mundësuar AK-ve të plotësojnë/modifikojnë planifikimet e prokurimit për vitin 2020. INPO, më këtë rast ka shprehur interesim dhe ka zhvilluar intervista me menaxherët/ zyrtarët e prokurimit në komuna dhe ka pyetur nëse ata do të shfrytëzojnë këtë mundësi dhe ata janë shprehur se kanë pasur pak ndryshime dhe nuk kanë interesim, ose janë duke pritur interpretim nga ana e KRPP-së, nëse janë të obliguar të bëjnë rishikim të planifikimit pasi është hera e parë që kërkohet rishikimi i planifikimit të prokurimit. Komuna Vushtrri, Leposaviç dhe Gjilan kanë bërë ndryshime do të thotë kanë bërë rishikim të planifikimit të prokurimit.

3. Pasqyrë e përgjithshme e planeve të prokurimit 2020

INPO ka monitoruar planet e prokurimit në 20 komuna: Deçan, Dragash, Ferizaj, Glogoc, Gjakovë, Gjiilan, Kaçanik, Kamenicë, Klinë, Leposaviç, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Suharekë, Shtime, Viti dhe Vushtrri. Për vitin 2020, këto komuna kanë planifikuar të zhvillojnë gjithsej 1889 aktivitete të prokurimit, në vlerë totale prej 124,521,799.64€. Nga këto planifikime vërejmë se kategoria me më së shumti projekte të planifikuara është ajo e punëve, pasuar nga kategoria furnizim, shërbime dhe konkurs projektimi.

Tabela 1: Planifikimi i prokurimit për vitin 2020 për 20 komuna

Lloji i kontratës	Numri i kontratave	Vlera totale
Furnizim	551	20,850,375.23 €
Shërbime	415	22,670,757.27 €
Punë	905	79,970,769.14 €
Konkurs projektimi	18	1,029,898.00 €

Burimi: Planifikimi i prokurimit, e-prokurim

3.1 Kontratat e planifikuara për punë dhe buxheti në 20 Komuna

INPO ka monitoruar pesë (5) kontrata për punë në secilën komunë. Monitorimi dhe analiza është fokusuar në atë se sa përputhet vlera e parashikuar e kontratës në plan të prokurimit me njoftim për kontratë të publikuar në e-prokurim. Si rezultat i kësaj analize, kemi 90 kontrata të monitoruara në secilën komunë ku vërejmë se në 41 raste është tejkaluar vlera e parashikuar në plan të prokurimit, 15 raste procedurat janë inicuar me më pak mjete se sa kanë qenë të planifikuara me plan të prokurimit dhe vetëm në 34 raste procedurat janë inicuar me vlerë e parashikuar në plan të prokurimit. Sipas Ligjit për Prokurimin Publik dhe legjislacioni sekondar në fuqi, vlera e parashikuar e kontratave duhet të shprehet në totalin e vlerës së kontratës, ndërkajshëm gjetet tregojnë se komunat në planifikimin e tyre nuk e përfillin këtë rregull në të gjitha rastet dhe nuk paraqesin të dhëna nëse kontratat janë shumë-veçare. Veprime të tilla lënë të nënkuptohet se projektet e caktuara janë projekte 1 vjeçare. Në disa komuna është gjetur se të gjitha kontratat e zgjedhura për monitorim, vlera e parashikuar e kontratave në planifikim të prokurimit është më e vogël se ndarjet buxhetore për ato projekte/kontrata, dhe në bazë të analizës vërejmë se ky tejkalim vjen si rezultat i mos specifikimit në plan të prokurimit se kontrata është “2 apo 3 vjeçare”. Sipas ligjit dhe interpretimit të KRPP-së, planifikimi duhet të përfshij vlerën totale të kontratës. Në ligjin mbi ndarjet buxhetore vërehet se në shumë projekte ka mjete të ndara edhe për vitet e ardhshme vetëm se komunat një gjë të tillë nuk e deklarojnë edhe në plan të prokurimit.

Në tabelën në vijim janë paraqitur të dhënat për komunat ku janë monitoruar mesatarisht nga pesë (5) kontrata dhe është analizuar se sa prej tyre kanë inicuar tenderë në përputhje me planifikimin e prokurimit.

Tabela 2: Numri i kontratave për punë të planifikuara dhe buxheti i Republikës së Kosovës për këtë kategori

Komuna	Numri i kontratave në planifikimi të prokurimit	Vlera e parashikuar në planifikim (1)	Buxheti 2020-2022 (2)	Diferenca (2-1)
Deçan	10	970,000.00 €	1,097,500.00 €	127,500.00 €
Dragash	83	2,400,656.00 €	7,443,100.00 €	5,042,444.00 €
Ferizaj	54	11,631,949.00 €	12,946,555.00 €	1,314,606.00 €
Glllogoc	73	4,191,930.00 €	11,926,986.00 €	7,735,056.00 €
Gjakovë	53	6,970,082.00 €	9,946,082.00 €	2,976,000.00 €
Gjilan	16	4,947,998.18 €	7,831,773.00 €	2,883,774.82 €
Kaçanik	57	1,630,000.00 €	4,697,551.00 €	3,067,551.00 €
Kamenicë	7	407,028.00 €	1,254,206.00 €	847,178.00 €
Klinë	25	1,935,000.00 €	1,250,000.00 €	-685,000.00 €
Leposaviç	16	1,827,583.05 €	5,391,667.00 €	3,564,083.95 €
Mitrovicë e Jugut	20	1,065,314.00 €	836,003.00 €	-229,311.00 €
Mitrovicë e Veriut	11	1,438,408.00 €	1,670,056.00 €	231,648.00 €
Pejë	74	5,042,536.90 €	14,650,000.00 €	9,607,463.10 €
Podujevë	65	4,081,593.00 €	8,667,291.00 €	4,585,698.00 €
Prishtinë	88	26,414,538.71 €	66,935,000.00 €	40,520,461.29 €
Prizren	82	8,523,807.00 €	26,747,569.00 €	18,223,762.00 €
Suharekë	91	4,036,609.00 €	9,116,933.00 €	5,080,324.00 €
Shtime	37	1,864,050.00 €	1,948,096.00 €	+84,046.00 €
Viti	14	1,620,150.00 €	4,940,442.00 €	3,320,292.00 €
Vushtrri	29	2,233,485.30 €	6,087,000.00 €	3,853,514.70 €

Burimi: Planifikimi i prokurimit e-prokurim, Ligji nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.

3.2 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë në 20 komuna

Komunave të fokusit u janë monitoruar pesë (5) kontrata për punë, përveç komunës: së Deçanit, Gjilanit, Kamenicës, Leposaviçit, Mitrovicë e Jugut, të cilave u janë monitoruar më pak se pesë (5), për arsye se në keto komuna ose nuk ka pasur më shumë aktivitete për punë të inicuar ose nuk ka qenë i mundur identifikimi i aktivitetit të prokurimit me titullin e njejtë apo përafert si në plan të prokurimit. Tek secila kontratë e planifikuar është monitoruar vlera e parashikuar në planifikim të prokurimit dhe vlera e parashikuar në njoftimin për kontratë të publikuar në e-prokurim. Në tabelën 3, janë paraqitur vlera e përgjithshme e të gjitha kontratave për punë të monitoruara për secilën komunë, ku mund të vërehet se planifikimin për këto kontrata më së miri e ka zhvilluar komuna e

Leposaviçit dhe Gjakovës, pasi ka një diferencë shumë të vogël në mes të planifikimit të prokurimit dhe vlerës së parashikuar në njoftimin për kontratë. Shembull jo i mirë i planifikimit, është ai i komunës së Prizrenit, Ferizajt, Vitisë, Dragashit ku ka dallime të mëdha në vlerat e parashikuara të kontratave në plan dhe në njoftim për kontratë. INPO, në kontratat e monitoruara vëren se shumica e komunave kanë dështuar që ta implementojë në përpikmëri nenin 8 të LPP-së, ku kërkohet që planifikimi të bëhet me të dhëna të detajuara lidhur me kontratat e caktuara.

Planifikimi i prokurimit kërkon që vlera e parashikuar të vendoset si total i tërë projektit e jo vetëm për atë vit kur planifikohet të inicohet procedura.

Tabela 3: Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë për vitin 2020

Komuna	Nr. i kontratave të monitoruara	Vlera në planifikim të prokurimit (1)	Vlera në njoftim për kontratë (2)	Diferenca +/- (2-1)
Deçan	1	40,000.00 €	8,555.00 €	-31,445.00€
Dragash	5	322,156.00 €	810,206.00 €	+488,050.00€
Ferizaj	5	1,045,000.00 €	1,825,000.00 €	+780,000.00€
Glllogoc	5	710,000.00 €	779,500.00 €	+69,500.00 €
Gjakovë	5	1,660,532.00 €	1,660,228.12 €	-303.88€
Gjilan	4	855,865.50 €	736,606.50 €	-119,259.00 €
Kaçanik	5	250,000.00 €	305,000.00 €	+55,000.00 €
Kamenicë	3	244,000.00 €	124,000.00 €	-120,000.00 €
Klinë	5	210,000.00 €	320,000.00 €	+110,000.00 €
Leposaviç	4	325,700.00 €	325,700.00 €	0 €
Mitrovicë e Jugut	3	497,734.00 €	370,000.00 €	-127,734.00 €
Mitrovicë e Veriut	5	336,183.00 €	356,183.00 €	+20,000.00 €
Pejë	5	385,000.00 €	424,356.36 €	+39,356.36 €
Podujevë	5	360,000.00 €	646,393.76 €	+286,393.76 €
Prishtinë	5	615,000.00 €	730,000.00 €	+115,000.00 €
Prizren	5	625,000.00 €	3,265,000.00 €	+2,640,000.00 €
Suharekë	5	356,844.00 €	558,670.00 €	+201,826.00 €
Shtime	5	293,000.00 €	410,000.00 €	+117,000.00 €
Viti	5	749,150.00 €	1,455,000.00 €	705,850.00 €
Vushtrri	5	195,000.00 €	172,578.81 €	-22,421.19 €

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet në e-prokurim

3.3 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim në 20 komuna

Siç u elaborua edhe më lart në planifikimet e prokurimit, komunat kanë planifikuar të zhvillojnë 1551 aktivitete për kategorinë furnizim. Ngjajshëm me kontratat për punë edhe për këtë lloj të aktiviteteve të prokurimit përzgjedhja e kontratave për monitorim është bërë përmes platformës së e-prokurimit, ku janë përzgjedhur pesë (5) kontrata për furnizim dhe është bërë krahasimi i të dhënave të paraqitura në njoftimin për kontratë dhe përshkrimin e çmimeve me të dhënat e paraqitura në plan të prokurimit. INPO ka gjetur se planifikimi i prokurimit nga ana e komunave për aktivitetet e furnizimeve nuk përmbushë kërkesat ligjore, të cilat udhëzojnë AK-të që: “në rastin e kontratave të ardhshme për furnizim, të planifikojnë vlerën e përgjithshme të llogaritur të prokurimit sipas lëmisë së secilit produkt, të cilin autoriteti kontraktues planifikon që ta prokurojë gjatë vitit fiskal”. Gjetjet tregojnë se komunat dështojnë të planifikojë në mënyrë korrekte të gjithë artikujt, të shprehur në sasi dhe njësi të sakta apo të përafërta. Shumë komuna nuk i plotësojnë fare këto kërkesa në plan të prokurimit, ndërkaq ka edhe komuna që planifikimet e furnizimeve nuk i ka të sakta apo reale, pasi gjatë procesit të tenderimit gjejmë dallime të konsiderueshme në raport me atë se çfarë është planifikuar. Për shembull, komuna e Prizrenit ka planifikuar në plan të prokurimit të furnizohet me tri (3) autoambulanca ndërsa, ka iniciuar procedurat në e-prokurim për dy (2) automabulanca, gjithashtu ka planifikuar të furnizohet me 200 mekanizma bujqesor ndërsa, proceduart i ka inicuar për 150 të tillë. Po ashtu, e njëjta komunë në të pesë (5) kontratat e monitoruar ka tejkaluar vlerën e parashikuar për 1,689,501.00€ duke inicuar këto kontratat më vlera shumë me të larta se sa parashikimi në plan të prokurimit. Rast tjetër është ai i komunave Deçan dhe Klinë, ku këto i kanë vlerat e parashikuara identike por, kanë dallime të konsiderueshme në përcaktimin e njësisë dhe sasive të artikujve të parashikuar dhe atyre të tenderuar.

Komuna e Gjilanit gjejmë se për të gjitha kontratat e planifikuara njësitë e artikujve i ka të shprehura me “komplet”, ndërsa, të sasitë e përafërta vjetore i ka të shprehura me “1”. Ndërsa, për kontratat e njëjta, gjatë fazës së tenderimit, në dokumentin “përshkrimi i çmimeve” njësitë dhe sasitë i ka të shprehura me “paushall”(shih tabelën 29).

Komuna e Suharekës dhe Leposaviçit i kanë shprehur sasitë “1” dhe njësitë “komplet”, në plan të prokurimit. Ndërsa, komuna Viti i ka të caktuara njësitë por sasitë i ka të shprehura me “1”, ndërsa në procesin e tenderimit këto sasi janë krejtësisht të ndryshme.

Komuna e Gjakovës i ka të plotësuar sasitë dhe njësitë në planin e prokurimit, ndërkaq për të pesë (5) kontratat e monitoruara nga INPO, vërejmë se në proces të tenderimit janë parashikuar sasi më të mëdha në krahasim me parashikimin në plan të prokurimit.

Për më tepër, komunat kanë përdorur edhe “njësi matëse” si: sprej, komplet, roll, pako, kuti, paushall, kanta, etj. Në këto raste komunat nuk kanë respektuar legjislacionin në fuqi gjatë planifikimit të kontratave për furnizim, pasi nuk kanë bërë specifikimin e saktë të sasive të planifikuara për furnizim ose në disa raste edhe nuk kanë specifikuar sasitë fare. Rrjedhimisht, komunat kanë vepruar në kundërshtim me nenin 8 të LPP-së.

Përveç, këtyre rasteve kemi edhe tejkalim të vlerës së parashikuar në tabelën në vijim janë paraqitur numri i kontratave që nuk janë inicuar konform parashikimi do të thotë është paraqitur numri se sa kontrata janë më vlerë më të lartë ose më të ulët se sa parashikimi në plan të prokurimit. Mesatarisht janë monitoruar nga pesë (5) kontrata, përjashtim bëjnë komunat: Dragash, Ferizaj, Kaçanik, Leposaviç, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, për arsye se në këto komuna ose nuk ka pasur më shumë aktivitete të inicuar ose nuk ka qenë i mundur identifikimi me titullin e njejtë apo të përafert sikur ai në plan të prokurimit.

Tabela 4: Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim

Komuna	Nr. kontratave të monitoruara	Planifikimi i prokurimit (1)	Njoftimi për kontratë (2)	Diferenca (2-1)
Deçan	5	121,900.00 €	121,900.00 €	0 €
Dragash	2	20,000.00 €	20,000.00 €	0 €
Ferizaj	3	150,000.00 €	178,500.00 €	+28,500.00 €
Glllogoc	5	148,430.00 €	131,325.00 €	-17,105.00 €
Gjakovë	5	230,800.00 €	226,011.00 €	-4,789.00 €
Gjilan	5	165,074.80 €	164,999.99 €	-74.81€
Kaçanik	0			
Kamenicë	5	299,921.00 €	248,321.00 €	-51,600.00 €
Klinë	5	92,300.00 €	137,000.00 €	+44,700.00 €
Leposaviç	4	79,340.00 €	79,340.00 €	0 €
Mitrovicë e Jugut	3	24,600.00 €	35,480.00 €	+10,880.00 €
Mitrovicë e Veriut	0			
Pejë	5	370,000.50 €	201,880.00 €	-168,120.50 €
Podujevë	5	186,350.00 €	297,232.64 €	+110,882.64 €
Prishtinë	5	347,000.00 €	367,000.00 €	+20,000.00 €
Prizren	5	709,999.99 €	2,399,500.00 €	+1,689,500.01 €
Suharekë	5	134,500.00 €	170,500.00 €	+36,000.00 €
Shtime	5	186,815.00 €	78,082.23 €	-108,732.77 €
Viti	5	282,413.00 €	301,199.00 €	+18,786.00 €
Vushtrri	5	226,000.00 €	263,998.50 €	+37,998.50 €

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet në e-prokurim

Simboli “/” nënkupton që komunat nuk kanë ofuar të dhënat për fushën përkatëse, dhe 0- nënkupton që në këto dy komuna nuk kemi mundur të identifikojmë kontrata të planifikuara me plan të prokurimit dhe që janë inicuar në e-prokurim me emrin e njejtë.

PASQYRË INDIVIDUALE E KOMUNAVE

4. DEÇAN

Komuna Deçan sipas Planit të Prokurimit për vitin fiskal 2020 ka planifikuar të zhvillojë 30 aktivitete të prokurimit. Kontratat për punë përmbëjnë shpenzimin më të madh të planifikuar përmes prokurimit, në vlerë prej 970,000.00€.

Tabela 5. Planifikimi i prokurimit për vitin 2020, Komuna Deçan

Lloji i kontratave	Numri i kontratave	Vlera totale
Furnizim	11	296,599.00 €
Shërbime	8	461,800.00 €
Punë	10	970,000.00 €
Konkurse të Projektimit	1	50,000.00 €

Burimi: Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit 2020 për Komunën e Deçanit, e-prokurim

4.1 Kontratat e planifikuara për punë dhe buxheti

Gjatë analizës së përpueshmërisë së vlerës së parashikuar të kontratave në plan të prokurimit me buxhet, INPO ka vërejtur se ekziston një dallim i konsiderueshëm në këto dy dokumente. Në planin e prokurimit vlera totale e parashikuar e kontratave për punë është 970,000.00€, ndërsa vlera e parashikuar në buxhet e këtyre kontratave për një periudhë 3 vjeçare (2020-2022) është 1,097,500.00€. Në përgjithësi, komuna nuk identifikon kontratat shumë-vjeçare në plan të prokurimit.³

Tabela 6. Numri i Kontratave të Planifikuara sipas Planit të Prokurimit dhe Buxhetit të Republikës së Kosovës

Numri total i kontratave për punë	Vlera e parashikuar me Plan të Prokurimit (totale) (1)	Buxheti 2020-2022 (2)	Diferenca vlera e parashikuar në Plan të Prokurimit dhe Buxhet 2020 +/- (2-1)
10	970,000.00 €	1,097,500.00 €	+127,500.00 €

Burimi: Plani i Prokurimit për vitin 2020 për KK Deçan, Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.

³ INPO ka identifikuar që në Ligjin mbi ndarjet buxhetore 2020 ka mjete të planifikuara edhe për vitet e ardhshme për këto aktivitete/projekte, por që në planifikim mungon përshkrimi se cilat aktivitete/projekte janë shumë-vjeçare.

4.2 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë

INPO ka analizuar zbatueshmërinë e planifikimit të prokurimit për kontratat për punë, duke krahasuar vlerën e paraqitur në planifikim të prokurimit dhe vlerën e paraqitur në njoftimin për kontratë gjatë fazës së tenderimit.

INPO ka vërejtur se Komuna e Deçanit deri me 14.10.2020 ka shpallur gjithsej 10 aktivitete të prokurimit⁴ për vitin 2020, ku vetëm një prej tyre është i përfshirë në planifikimin përfundimtar të prokurimit për këtë vit (shih tabelën 7). Për këtë aktivitet/projekt, Komuna ka planifikuar 31 mijë e 445 euro më pak sipas njoftimit për kontratë krahasuar me vlerën e parashikuar sipas Planit të Prokurimit. Më konkretisht, Komuna ka planifikuar 40 mijë euro me Plan të Prokurimit ndërkohë që në Njoftimin për Kontratë, vlera e parashikuar është 8,555.00€.

Tabela 7. Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë

Nr.	Kontrata	Vlera e parashikuar në plan të prokurimit(1)	Vlera e parashikuar në njoftimin për kontratë (2)	Diferenca +/- (2-1)
1.	“Rekonstruimi i objektit të shërbimeve rezidenciale”	40,000.00 €	8,555.00 €	-31,445.00 €

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim, Komuna e Deçanit Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim

4.3 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim

Nga gjithsej dhjetë (10) kontrata për furnizime të planifikuara, INPO ka monitoruar pesë (5) prej tyre. Gjetjet tregojnë se vlera e parashikuar e kontratave për furnizim është identike si në planifikim të prokurimit po ashtu edhe në njoftimin për kontratë. Mirëpo, INPO ka evidentuar se ekzistojnë ndryshime të konsiderueshme sa i përket aspektit të përcaktimit të njësive/sasive të artikujve të planifikuar dhe të tenderuar.

⁴ Prej këtyre 10 aktiviteteve, 4 janë me Procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë

Tabela 8. Zbatueshmëria e Planifikimit të Kontratave për Furnizime për Vitin 2020

Planifikimi				Tenderimi		
Kontrata	Njësia	Sasia	Vlera totale	Njësi	Sasia	Vlera totale
“Furnizim me kurora dhe lule për manifestime.”	Copë	1000	5,000.00 €	Copë	880	5,000.00 €
“Furnizim me material zyrtarë për institucionet publike të Komunës së Deçanit.”	Copë	200	60,000.00 €	Copë	297185	60,000.00 €
				Bllok	5400	
				Pako	4150	
				Set	500	
				Risa	350	
				Rollne	350	
				m ²	310	
				Faqe	100	
“Furnizim me veshmbathje dhe material tjetër tekstili për shtëpinë e komunitetit”	Copë	25	9,900.00 €	Palë	1364	9,900.00 €
				Copë	687	
				m	175	
“Furnizim me Material Stomatologjik dhe Shpënzues për QKMF-Deçan”	Copë	64	40,000.00 €	Pako	963	40,000.00 €
				Copë	4147	
				Scatul	245	
				Kg	100	
				Lit	1,110	
“Furnizim me medikamente për shtëpinë e komuniteteve në Deçan”	Copë	104	7,000.00 €	Sc	2054	7,000.00 €

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim (përshkrimi i çmimeve), Komuna e Deçanit

4.4 Projeketet/aktivitetet që nuk janë të përfshira në buxhetin e republikës së Kosovës

INPO ka monitoruar nëse të gjitha kontratat për punë që janë të përfshira në planin e prokurimit janë të përfshira edhe në buxhet. Rezultatet e monitorimit tregojnë se komuna ka planifikuar tri (3) kontrata për punë të cilat nuk gjenden në buxhetin 2020.

Tabela 9. Aktivitet/projektet që nuk janë të përfshira në Buxhetin e Republikës së Kosovës

Titulli i projektit	Vlera e parashikuar në PP
“Renovimi i shkollave në Deçan”	50,000.00 €
“Rrenimi i Objekteve ndërtimore”	50,000.00 €
“Renovimi i objekteve kulturo historike”	20,000.00 €

Burimi: Plani i Prokurimit për vitin 2020 për Komunën e Deçanit

Një prej problemeve të identifikuara është edhe mospërputhja në përshkrimin ose emërtimin e kontratave, më konkretisht dallimi në përshkrimin e tyre në Plan të Prokurimit dhe në Ligjin për Buxhet, si në rastin e kontratës “Ndërtimi i kanaleve të ujitjes”, e cila në buxhet gjindet me titullin “Kanale të ujitjes - participim me ministrinë e bujqësisë”⁵.

5. DRAGASH

5.1 Pasqyrë e planifikimit të prokurimit 2020

Komuna e Dragashit në planin e prokurimit për vitin fiskal 2020 ka planifikuar 116 projekte/ aktivitete me vlerë të parashikuar 3,315,153.00€. Nga këto projekte/ aktivitete 19 prej tyre janë planifikuar për kategorinë e furnizimeve ku vlera e parashikuar është 666,073.00€, 14 projekte/ aktivitete janë planifikuar për kategorinë e shërbimeve ku vlera e parashikuar është 248,424.00€ dhe 83 projekte/ aktivitete janë planifikuar për kategorinë më të madhe atë të punëve ku vlera e parashikuar është 2,400,656.00 € dhe sipas planit të prokurimit nuk ka ndonjë planifikim për konkurse të projektimit.

Plani i prokurimit është i publikuar me datën 03.02.2020 në e-prokurim, ndërsa nuk është i publikuar në ëeb-faqen e Komunës.

Tabela 10. Planifikimi i prokurimit për vitin 2020, Komuna e Dragashit

PASQYRË E PLANIFIKIMIT 2020		
Lloji i kontratës	Numri i kontratave	Vlera e kontratës
Furnizime	19	666,073.00 €
Shërbime	14	248,424.00 €
Punë	83	2,400,656.00 €
Konkurs projektimi	/	/

Burimi: Planifikimi i prokurimit e-prokurim, Komuna e Dragashit

5.2 Kontratat e planifikuara për punë dhe buxheti

Komuna e Dragashit sipas planit të prokurimit për vitin fiskal 2020 ka planifikuar 83 projekte/aktivitete me vlerë të parashikuar prej 2,400,656.00€, ndërsa për këto kontrata në buxhetin 2020-2022 janë planifikuar 7,443,100.00€. INPO ka gjatur se në komunën e Dragashit, shumica e

⁵ Ky projekt, sipas Ligjit të Buxhetit ka të planifikuara gjithsej 19,500 € për vitin 2020 të cilat bëjnë pjesë në të Hyrat Vetanake të Komunës. Ndërsa, sipas Planit të Prokurimit vlera e planifikuar është 30,000 € për këtë vit.

projektve kapitale sipas buxhetit janë shumë-vjeçare ndërkaq në planifikimin e prokurimit këto kontrata nuk janë të paraqitura si kontrata shumë vjeçare, madje edhe vlera e parashikuar e këtyre kontratave në plan të prokurimit është e paraqitur vetëm për vitin fiskal 2020. Kjo mund të vërehet edhe në tabelën 12, ku komuna në fazën e tenderimit paraqet vlerën e parashikuar të kontratës sipas planifikimit buxhetor.

Tabela 11. Numri i Kontratave të Planifikuara në Plan të Prokurimit dhe Buxhet të Republikës së Kosovës

NUMRI I KONTRATAVE TË PLANIFIKUARA PËR PUNË DHE BUXHETI			
Numri i kontratave në planifikim të prokurimit	Vlera e parashikuar në planifikim (1)	Buxheti 2020-2022 (2)	Diferenca +/- (Vlera e parashikuar në planifikim dhe Buxheti 2020) (2-1)
83	2,400,656.00 €	7,443,100.00 €	+ 5,042,444.00 €

Burimi: Planifikimi i prokurimit e-prokurim, Ligji Nr. 07L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2020.

5.3 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë

Nga 83 kontrata për punë të planifikuara nga komuna e Dragashit, INPO ka monitoruar pesë (5) kontrata. Në katër (4) kontrata INPO ka gjetur se komuna ka rritur vlerën e parashikuar të kontratave gjatë fazës së tenderimit për 488,000.00€ (shih tabelën 12). Po ashtu, komuna në planifikimin e prokurimit ka vendosur vlerën e parashikuar të projekteve në kundërshtim me planifikimet buxhetore, sikurse në rastin e projektit “Kubëzimi i rrugëve, montimi i kubzave të vjetra dhe infrastrukturës përcjellëse në fshatin Bresanë” vlera e parashikuar e kontratës në planifikimin e prokurimit dhe në njoftimin për kontratë ishin identike në vlerë prej 168,656.00€, ndërsa me Ligji Nr.07L-001 mbi ndarjet për buxhetin e për vitin 2020-2022 janë planifikuar 368,656.00€ për këtë projekt.

Ndërkaq, në katër kontrata të tjera vlera e parashikuar e kontratave nuk përputhet me buxhetin e planifikuar të komunës, si në rastin e kontratës “Asfaltimi i rruges Restelic -Strazimi (projekt tre vjeçar)”, ku në buxhetin 2020-2022 komuna ka të planifikuara 77,000.00€, ndërsa gjatë fazës së tenderimit vlera e parashikuar e kontratës është paraqitur në vlerë totale prej 495,050.00€.

Tabela 12. Kontratat për punë të analizuara

ZBATUESHMËRIA E PLANIFIKIMIT TË KONTRATAVE PËR PUNË				
Nr.	Emri i kontratës	Vlera në Planifikim të prokurimit (1)	Vlera në njoftim për kontratë (2)	Diferenca +/- (2-1)
1.	“Kubëzimi i rrugëve, montimi i kubzave të vjetra dhe infrastrukturës përcjellëse në fshatin Bresanë”	168,656.00€	168,656.00€	0
2.	“Kubëzimi i rrugëve dhe rregullimi i ujësjetës në fshatin Baçkë (projekt dyvjeçar)”	13,500.00€	38,500.00€	+25,000.00€
3.	“Renvimi i pusateve të ujit në fshatin Brod”	22,500.00€	37,500.00€	+15,000.00€
4.	“Asfaltimi i rrugës Restelic - Strazimi (projekt tre vjeçar)”	77,000.00€	495,050.00€	+418,050.00€
5.	“Regulimi i rrugës në dy hyrjet e rrugëve në fshatin Brod”	40,500.00€	70,500.00€	+30,000.00€

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim Komuna Dragash

5.4 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim

Nga të gjitha kontratat për furnizime INPO ka mundur me i monitoruar vetëm se dy (2) kontrata në Komunën e Dragashit, pasi kontratat e tenderuara nuk ishin të emërtuara njëjtë në njoftimin për kontratë dhe në planin e prokurimit, apo edhe nuk kanë qenë të planifikuara fare.

Në përgjithësi komuna gjatë planifikimit të kontratave për furnizim nuk ka plotësuar të gjitha të dhënat e kërkuara sipas ligjit dhe planifikimi si i tillë nuk pasqyron transparencë të plotë siç kërkohet me parimet bazë të legjislacionit për prokurim. Gjetjet tregojnë se komuna gjatë planifikimit të furnizimeve nuk ka parashikuar fare të sasisë, njësitet dhe çmimet për njësi për artikujt apo furnizimet e nevojshme.

Tabela 13. Zbatueshmëria e Planifikimit të Kontratave për Furnizime për Vitin 2020

#	ZBATUESHMËRIA E PLANIFIKIMIT TË KONTRATAVE PËR FURNIZIM						
#	#	Planifikim i prokurimit			Tenderim		
Nr.	Emri i kontratës	Njësia	Sasia	Vlera totale	Njësia	Sasia	Vlera totale
1.	“Furnizimi me paisje medicinale (marëveshje me Ambasadën e Bullgarisë)”	-	-	15,000.00 €	Copë	5	15,000.00€
2.	“Furnizimi dhe montimi i kaldajës në shkollën fillore në fshatin Zgatar”	-	-	5,000.00 €	Komplet	4 Komplet	5,000.00 €
					Litër		
					Copë	7 Copë	
						480 Litër	

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim (përshkrimi i çmimeve), Komuna Dragash.

6. FERIZAJ

6.1 Pasqyrë e planifikimit të prokurimit 2020

Komuna e Ferizajt renditet në mesin e komunave më të mëdha të Republikës së Kosovës, kështu që edhe një buxhet të konsiderueshëm që pasqyrohet edhe në numrin e projekteve që realizohen përmes prokurimit.

Për vitin 2020, Ferizaj ka planikuar që përmes prokurimit të shpenzoj rreth 16,897,233.00€ në gjithsej 81 kontrata të llojeve të ndryshme.

Tabela 14: Planifikimi i prokurimit 2020, Komuna e Ferizajt.

PASQYRË E PLANIFIKIMIT 2020		
Lloji i kontratës	Numri i kontratave	Vlera e kontratës
Furnizime	30	1,072,231.00€
Shërbime	34	4,193,053.00€
Punë	54	11,631,949.00€
Konkurs projektimi	/	/

Burimi: Planifikimi i prokurimit e-prokurim

6.2 Kontratat e planifikuara për punë dhe buxheti

INPO ka analizuar edhe pjesën e planifikimeve për punë për vitin 2020 nëse i ka të bazuara në kapacitetet buxhetore, respektivisht nëse ka buxhet për zhvillimin e projekteve të planifikuara për vitin 2020. Krahasimet në mes të vlerës buxhetore të projekteve të planifikuara për punë dhe buxhetit të komunës i gjeni në tabelën numër 15.

Tabela 15: Numri i kontratave të planifikuara për punë dhe buxheti.

NUMRI I KONTRATAVE TË PLANIFIKUARA PËR PUNË DHE BUXHETI			
Numri i kontratave	Vlera e parashikuar në planifikim (1)	Buxheti 2020-2022 (2)	Diferenca +/- (2-1)
54	11,631.949.00 €	12,946,555.00 €	+1,314,606.00 €

Burimi: Planifikimi i prokurimit e-prokurim, Ligji Nr. 071-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2020.

Nga të dhënat në tabelë, vërejmë se planifikimi i prokurimit për vitin 2020 ka një vlerë buxhetore 11,631.949.00€, ndërsa kapacitetet buxhetore i ka 12,946,555.00€, ose 1,314,606.00€ më shumë se në planifikim. INPO ka hulumtuar secilin projektet për punë në buxhet dhe vëren se shkaktar kryesor i këtyre mospërputhjeve është ajo se shumica e projekteve për punë të planifikuara janë në kohëzgjatje më shumë se një vit, ndërsa komuna nuk i ka identifikuar si të tillë gjatë planifikimit.

6.3 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë

Një shumë e madhe e buxhetit të Komunës së Ferizajt për çdo vit shkon në investime kapitale/ kontrata për punë. Për të vlerësuar efikasitetin e planifikimeve të kontratave për punë, INPO ka analizuar nëse komuna i pëmbahet vlerave të parashikuara të kontratave në planifikim edhe në momentin kur fillojnë procedurat e tenderimit lidhur me projektin e caktuar. Nga 5 kontratat e monitoruara INPO ka gjetur se komuna në asnjë prej tyre nuk iu është përbajtur vlerës së parashikuar në planifikimin e prokurimit.

Tabela 16: Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë.

ZBATUESHMËRIA E PLANIFIKIMIT TË KONTRATAVE PËR PUNË				
Nr.	Emri i kontratës	Vlera në plan të prokurimit	Vlera njoftim	Diferenca +/-
1.	“Ndërtimi i stacionit të ri të autobusëve - projekt trevjeçar”	460,000.00 €	510,000.00 €	+50,000.00 €
2.	“Asfaltimi dhe zgjerimi i rruges Agim Ramadani në zonën rekreative sportive- projekt tre vjeçarë”	460,000.00 €	510,000.00 €	+50,000.00 €
3.	“Ndërtimi i objektit të QMF-se në fsh Softaj”	35,000.00 €	135,000.00 €	+100,000.00 €
4	“Ndërtimi i shkollës së re në Fshatin Neredime”	40,000.00 €	480,000.00 €	+440,000.00 €
5.	“Ndërtimi i sallës sportive në Fshatin e Vjetër- Bibaj”	50,000.00 €	190,000.00 €	+140,000.00 €

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim Komuna Ferizaj

Më 23.09.2020, INPO ka zhvilluar intervistë përmes telefonit me zyrtarin përgjegjës të prokurimit të komunës së Ferizajt, i cili është pyetur rreth diferencës në mes të vlerës së parashikuar në planifikim dhe vlerës së parashikuar në njoftimin për kontratë dhe i njëjti është përgjigjur se “Plani i Prokurimit është për këtë vit dhe në 2020 janë ato mjete, pra disa kontrata janë më shumë vjeçare dhe për atë mund të ndryshojnë këto vlera”.

6.4 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim

Nga tridhjetë (30) kontratat e planifikuara për furnizime në komunën e Ferizajt, INPO gjatë periudhës së monitorimit⁶ ka arritur të identifikojë vetëm tri (3) kontrata të tenderuara të cilat kanë qenë në planifikimin përfundimtarë të prokurimit. Komuna kishte tenderuar një numër të konsiderueshëm të kontratave për furnizime mirëpo të njëjtat INPO nuk ka arritur t'i identifikoj në planin e prokurimit. Arsyetimi i komunës rreth kësaj problematike është se për shkak të pandemisë nuk kanë mundur të shikojnë nëse kontratat e tenderuara janë në plan të prokurimit.⁷ Zyrtari i prokurimit në Ferizaj, thotë se ekziston mundësia që edhe njësitë e kërkesës shpesh i ndërrojnë titujt dhe vlerën e parashikuar të projekteve gjatë fazës së inicimit të aktivitetit të prokurimit.⁸

Tutje, në dy (2) nga tri (3) kontratat e planifikuara, INPO ka gjetur se është tejkaluar vlera e parashikuar në planifikim. Përveç, këtyre tejkalimeve INPO vëren se në dy (2) nga 30 kontrata për furnizime në planifikim nuk janë caktuar fare njësia matëse, ndërsa sasia e përafërt dhe çmimi i përafërt mungon në 29 kontrata.⁹

Tabela 17: Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim.

ZBATUESHMËRIA E PLANIFIKIMIT TË KONTRATAVE PËR FURNIZIM						
Titulli i kontratës	Planifikim			Tenderim		
	Njësia	Sasia	Vlera totale	Njësia	Sasia	Vlera totale
“Furnizimi i fermerëve me lopë të racës simental”	Copë	/	90,000.00 €	Krerë	75	112,500.00 €
“Furnizimi i fermerëve me koshere të bletëve (sanduk)”	Copë	/	30,000.00 €	Copë	400	36,000.00 €
“Subvencionimi i fermerëve për ngritjen e pemishteve me arra”	Copë	/	30,000.00 €	Copë	16,704	30,000.00 €
				Metër	Copë	
					45,360 Metër	

Burimi: plani i prokurimit, e-prokurimi (përshkrimi i çmimeve).

6.5 Projektet/aktivitetet që nuk janë identifikuar në buxhet

INPO ka gjetur se pesë (5) kontrata për punë të planifikuara në planin e prokurimit nuk mund të identifikohen në buxhetin e komunës me emertim të njejtë, respektivisht nuk kanë mbulueshmëri financiare.

⁶ Shënim: Monitorimi në komunën e Ferizajt ka përfunduar më 23 shtator 2020.

⁷ Intervistë përmes telefonit me zyrtarin përgjegjës të prokurimit, Komuna Ferizaj, më 23.09.2020.

⁸ Po aty.

⁹ Planifikimi përfundimtarë i Prokurimit për vitin 2020.

Tabela 18: Projektet që nuk janë identifikuar në buxhet.

Titulli i projektit	Vlera e parashikuar në Plan të Prokurimit
“Rregullimi dhe mirëmbajtja e objekteve me konstruksion metal, dru, alumin dhe beton”	160,000.00 €
“Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave”	100,000.00 €
“Vendosja e shenjave të komunikacionit”	250,000.00 €
“Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit dimëror”	750,000.00 €
“Mbikqyrja e projektit Pallati i Kulturës-Qendra Multifunkionale”	40,000.00 €

Burimi: plani i prokurimit, e-prokurimi

7. GLLOGOC

7.1 Pasqyrë e planifikimit të prokurimit 2020

Komuna e Gllogocit në planifikimin e saj për vitin fiskal 2020 ka planifikuar të zhvilloj 121 aktivitete të prokurimit, prej tyre më se shumti ka planifikuar të zhvilloj për kategorinë punë 73, pastaj të tjerat për kategoritë furnizim dhe shërbime, ndërsa për kategorin konkurs projektimi nuk ka planifikuar asnjë aktivitet/projekt. Vlera totale e të gjitha aktiviteteve/projekteve të planifikuara është 5,598,746.40€.

Tabela 20. Planifikimi i prokurimit për vitin 2020, Komuna Gllogoc

PASQYRË E PLANIFIKIMIT 2020		
Lloji i kontratës	Numri i kontratave	Vlera e kontratës
Furnizim	25	453,130.00€
Shërbime	23	953,686.40€
Punë	73	4,191,930.00€
Konkurs projektimi	/	/

Burimi: Planifikimi i prokurimit e-prokurim, Komuna Gllogoc

7.2 Kontratat e planifikuara për punë dhe buxheti

Sipas planifikimit përfundimtar të prokurimit Komuna e Gllogocit ka planifikuar të prokurojë 73 kontrata për punë në vlerë totale 4,191,930.00€. Vlera e planifikuar me buxhetin 2020-2022 për këto 73 kontrata është me e lartë për 7,735,056.00€.¹⁰

INPO nuk ka arritur të identifikojë në buxhetin e komunës projektin “Rrenimi i QMF-se se vjeter ne Komoran” me vlerë të parashikuar të kontratë 10,000.00€ i cili është i përfshirë në planifikimin e prokurimit.

¹⁰ INPO, ka identifikuar që në planifikim mungon përshkrimi se cilat kontrata janë dy apo tri vjeçare.

Tabela 21. Numri I Kontratave të Planifikuara në Plan të Prokurimit dhe Buxhet

NUMRI I KONTRATAVE TË PLANIFIKUARA PËR PUNË DHE BUXHETI			
Numri i kontratave	Vlera e parashikuar në planifikim (1)	Buxheti 2020-2022 (2)	Diferenca +/- (Vlera e parashikuar në planifikim dhe Buxheti 2020-2022) (2-1)
73	4,191,930.00 €	11,926,986.00 €	+7,735,056.00 €

Burimi: Planifikimi i prokurimit nga e-prokurimi, Ligji Nr. 071-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2020.

7.3 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë

Nga 73 kontrata/projekte sa ka të planifikuar Komuna e Glllogocit, INPO ka monitoruar pesë (5) kontrata, ku vërejmë se vetëm një kontratë ka vlerë identike me planifikimin e prokurimit dhe njoftimin për kontratë. Tutje, përveç aktivitetit “Ndertimi i kolektoreve për grumbullimin e ujrave te zeza”, i cili është tenderuar në vlerë prej 79,000.00€ më të lartë se në planifikimin e prokurimit, kontratat e tjera kanë vlerë më të ulët të parashikuar në njoftimin për kontratë.

Tabela 22. Zbatueshmëria e Planifikimit të Kontratave për Punë për vitin 2020

ZBATUESHMËRIA E PLANIFIKIMIT TË KONTRATAVE PËR PUNË				
Nr.	Emri i kontratës	Vlera në Planifikim të prokurimit (1)	Vlera në njoftim për kontratë (2)	Diferenca +/- (2-1)
1.	“Rregullimi dhe rrethimi i varrezave ne Komunen e Drenasit”	30,000.00 €	28,500.00 €	-1,500.00 €
2.	“Ndertimi i urave Tombinave dhe mureve mbrojtjse”	100,000.00 €	95,000.00 €	-5,000.00 €
3.	“Rregullimi i shtratit te lumit Drenica dhe Verbica”	100,000.00 €	100,000.00 €	0.00 €
4.	“Ndertimi i kolektoreve për grumbullimin e ujrave te zeza”	420,000.00 €	499,000.00 €	79,000.00 €
5.	“Renovimi i objekteve shkollore (kulm, dysheme dhe ndrrimi i dyrve dhe drita)”	60,000.00 €	57,000.00 €	-3,000.00 €

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim Komuna Glllogoc

7.4 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim

Nga gjithsej 24 kontrata të planifikuara për furnizime, INPO ka monitoruar pesë (5) prej tyre. Gjetjet tregojnë se komuna vetëm në dy (2) raste, ka respektuar në plotni planifikimin e prokurimit. Në dy (2) raste të tjera kemi gjetur se në fazën e tenderimit komuna ka rritur sasinë apo vlerën e parashikuar të kontratave nga ajo cfarë është planifikuar. Ndërkaq, në një (1) kontratë kemi gjetur komuna ka

prokuruar aktivitetin më vlerë më të ulët të kontratës krahasuar me planifikimin, po ashtu ka rritur ose ndryshuar sasi të.

Tabela 23. Zbatueshmëria e Planifikimit të Kontratave për Furnizime për Vitin 2020

#	ZBATUESHMËRIA E PLANIFIKIMIT TË KONTRATAVE PËR FURNIZIM						
#	#	Planifikim i prokurimit			Tenderim		
Nr.	Emri i kontratës	Njësia	Sasia	Vlera totale	Njësia	Sasia	Vlera totale
1.	“Mikser per ushqim te kafsheve - blegtori”	copë	14	60,000.00€	copë	14	41,300.00€
2.	“Centrifuge mekanike-bletari”	copë	79	13,430.00€	copë	79	13,430.00€
3.	“Mirembajtja e sistemit te adresave vendosja e tabelave dhe numrave ne teren”	copë	125	5,000.00€	m3	24-m ³	15,000.00€
					copë	1540-copë	
4.	“Furnizim me pelet per institucionet e komunes se Drenasit”	ton	200	40,000.00€	Ton	229	46,200.00€
5.	“Inventarizimi i shkollave ne Drenas”	copë	30	30,000.00€	copë	Copë - 557	15,395.00€
					m	m- 80	

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim (përshkrimi i çmimeve), Komuna Glllogoc

8. GJAKOVË

8.1 Pasqyrë e planifikimit të prokurimit 2020

Komuna Gjakovë ka planifikuar që për vitin 2020 të realizojë gjithsej 122 kontrata, vlera totale e të cilave është 10,085,314.48€, respektivisht kontrata për punë janë 53, kontratat për furnizim 42 dhe kontratat për shërbime 27. Vlen të theksohet se bazuar në planifikimin e prokurimit, Komuna e Gjakovës nuk ka planifikuar të realizojë asnjë kontratë me konkurs të projektimit për vitin 2020.

Tabela 24: Planifikimi i prokurimit për vitin 2020, Komuna e Gjakovës

Lloji i kontratës	Numri i kontratave	Vlera totale
Furnizime	42	1,346,806.00 €
Shërbime	27	1,768,426.48 €
Punë	53	6,970,082.00 €
Konkurs projektimi	/	0.00 €

Burimi: Planifikimi përfundimtar i prokurimit 2020 për komunën e Gjakovës, i publikuar në e-prokurimi

8.2 Kontratat e planifikuara për punë dhe buxheti

Numri total i kontratave për punë që Komuna Gjakovë ka planifikuar të realizojë gjatë vitit 2020 është 53 kontrata, vlera e të cilave arrin në 6,970,082.00€.

Tabela 25: Pasqyrë e kontratave për punë të planifikuara për vitin 2020, Komuna e Gjakovës

Gjithsej kontrata për punë	Gjithsej vlera e parashikuar me PP	Buxheti 2020-2022	Diferenca +/-
53	6,970,082.00 €	9,946,082.00 €	2,976,000.00 €

Burimi: Plani i prokurimit për vitin 2020 për Komunën e Gjakovës dhe Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020

Gjatë analizës së kontratave të përfshira në planifikim të prokurimit dhe atyre në buxhet, INPO ka gjetur se ekziston një dallim i konsiderueshëm në këto dy dokumente sa i përket vlerës së parashikuar për kontratat për punë. Përderisa me Buxhetin e Kosovës, mjete të ndara për të gjitha kontratat e planifikuara për 2020-2022 janë 9,946,082.00€, vlera e parashikuar me Planifikim të Prokurimit është 6,970,082.00€. Rrjedhimisht, komuna rreth 3 milion euro më shumë i ka të planifikuara në buxhet, sesa që ka planifikuar të shpenzojë përmes prokurimit. Një prej arsyeve kryesore e cila mund të rezultojë në këtë diferencë është se kontratat mund të jenë kontrata shumë-vjeçare dhe të ndara në faza, ku për këtë arsye edhe mund të rezultojë që vlera e parashikuar e kontratave më e ulët se planifikimi buxhetor. Megjithatë, komuna duhet që të ofrojë detaje në planin e prokurimit, se cilat kontrata janë kontrata shumë-vjeçare dhe cilat janë të ndara në faza, duke respektuar në plotëni interpretimin Nr. 133/2017 të KRPP-së, të datës 30.03.2017.

8.3 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë

Në pesë (5) kontratat e monitoruara për punë, INPO ka gjetur se komuna në përgjithësi i është përmbajtur planifikimit të prokurimit, duke inicuar pothuajse të gjitha aktivitetet prokurimit për kontratat për punë, me vlerë të parashikuar të kontratës sipas planifikimit.

Tabela 26: Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë për vitin 2020, Komuna e Gjakovës

Nr.	Kontrata	Vlera në planifikim të prokurimit (1)	Vlera në njoftim për kontratë (2)	Diferenca +/- (2-1)
1.	“Rregullimi i shtratit të lumit Krena-Pjesa e tretë”	800,000.00 €	799,696.35 €	-303.65 €
2.	“Ndërtimi dhe sanimi i ujërave të zeza dhe atmosferik”	200,000.00 €	200,000.00 €	0.00 €
3.	“Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në zonat rurale”	300,000.00 €	300,000.00 €	0.00 €
4.	“Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatin Pnish-Lagjja ‘Ramadan Hiseni’”	160,532.00 €	160,531.77 €	-0.23 €
5.	“Sanimi dhe ndërtimi i parqeve”	200,000.00 €	200,000.00 €	0.00 €

Burimi: Platforma e-prokurimi, Komuna e Gjakovës

8.4 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim

Bazuar në të dhënat nga tabela e mësipërme, INPO ka evidentuar disa gjetje në këtë proces duke përfshirë këtu mungesën e përcaktimit të njësive për artikujt e planifikuar, sasistë e tyre si dhe mos përputhjen e vlerës së parashikuar të kontratave gjatë procesit të tenderimit.

Në kontratën “Furnizim-ndërtimi i serrave”, komuna kishte planifikuar që të bëjë furnizimin me serra për një sipërfaqe totale prej 35 ari, në vlerë të parashikuar 80,500.00€. Ndërkaq, gjatë fazës së tenderimit, komuna ka kërkuar që furnizimi të bëhet për 75 copë serra, me një sipërfaqe totale prej 9150m². Respektivisht, në fazën e tenderimit komuna ka rritur sasitë e planifikuara për këtë lloj furnizimi për trefish, duke rritur vetëm për 650.00€, vlerën e parashikuar të kontratës.

Po ashtu, edhe në katër (4) rastet e tjera INPO vëren, se komuna nuk ka planifikuar në detaje sasitë dhe njësitë e furnizimeve të nevojshme apo edhe nuk i ka deklaruar fare ato.

Tabela 27: Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim

#	Planifikimi			Tenderimi		
Kontrata	Njësia	Sasia	Vlera totale	Njësi	Sasia	Vlera Totale
“Furnizim-Ndërtimi i serrave”	Ari	35	€ 80,500.00	Tip i serrës tunel me dim: 10x5x3.2	30 copë 50 m ²	€ 81,150.00
				Tip i serrës tunel me dim: 25x6x3.4	35 copë 150 m ²	
				Tip i serrës tunel me dim: 30x8x4.2	10 copë 240 m ²	
“Furnizim me dru bungu për ngrohje”	Metër	/	€ 66,300.00	m ²	1233	€ 62,833.00
“Furnizim me pelet për ngrohje në shkollë”	/	/	€ 44,000.00	Ton	176	€ 44,000.00

“Furnizim me automjet për vizita shtëpiake dhe vaksinim”	Copë	1	€ 25,000.00	Copë	1	€ 25,000.00
“Furnizim me pajisje për bletari”	Copë	30	€ 15,000.00	Copë	42	€ 12,978.00

Burimi: Platforma e-prokurimi, komuna Gjakovë

9. GJILAN

9.1 Pasqyrë e planifikimit të prokurimit 2020

Komuna e Gjilanit sipas planit të prokurimit për vitin fiskal 2020 ka planifikuar gjithsej 58 aktivitete të prokurimit. Prej këtyre aktiviteteve të prokurimit planifikohen që të realizohen 29 kontrata për furnizime, projekte të cilat janë planifikuar të kenë vlerë 967,630.55 €, 12 kontrata për shërbime të cilat janë parashikuar të kenë vlerë 1,297,943.20 €, 16 kontrata për punë të cilat janë planifikuar të kenë vlerë 4,947,998.18 €, 1 kontratë për konkurs projektimi me vlerë të parashikuar 62,157.00€.

Tabela 28. Planifikimi i prokurimit për vitin 2020, Komuna Gjilan

PASQYRË E PLANIFIKIMIT 2020		
Lloji i kontratës	Numri i kontratave	Vlera e kontratës
Furnizime	29	967,639.55 €
Shërbime	12	1,297,943.20 €
Punë	16	4,947,998.18 €
Konkurs projektimi	1	62,157.00 €

Burimi: Planifikimi i prokurimit, e-prokurim, Komuna e Gjilanit

9.2 Kontratat e planifikuara për punë dhe buxheti

Komuna e Gjilanit sipas planit të prokurimit për vitin fiskal 2020 ka planifikuar 16 projekte/aktivitete me vlerë të parashikuar prej 4,947,988.00€, ndërsa për këto kontrata buxhet të ndarë për vitin 2020-2022 janë 7,831,773.00€.

Vetëm shtatë (7) kontrata të planifikuara me plan të prokurimit, INPO ka arritur t'i identifikoj në bazë të titullit të projektit dhe vlerës së parashikuar në buxhet. Ndërkaq, 9 projekte/kontrata të tjera të planifikuara në plan të prokurimit nuk mund të identifikohen në buxhetin e komunës sipas titullit apo vlerës së parashikuar të kontratës. INPO ka gjetur se këto kontrata financohen nga kode të ndryshme buxhetore të cilat nuk janë të specifikuara sipas titullit të projektit. Shmëbull: Kontratat “Rregullimi i varrezave të reja- rrethoja dhe pjesët tjera përcjellëse infrastrukturore”, “Rregullimi i pjesës finale të kodra e Dëshmorëve”, “Rregullimi i parkut Banja”, “Rregullimi i parkut të Pajtitimit” financohen nga projekti “Sanimi i rrugëve, trotuareve dhe parqeve në qytet” kodi i projektit: 41443, ku për vitet 2020-2022 në buxhet janë paraparë 1,086,541.00€, ndërkaq vlera e parashikuar e të gjitha këtyre kontratave në plan të prokurimit është 1,432,132.68€, apo më e madhe për 345,591.68€.

Tabela 29. Numri i Kontratave të Planifikuara në Plan të Prokurimit dhe Buxhet

NUMERI I KONTRATAVE TË PLANIFIKUARA PËR PUNË DHE BUXHETI			
Numri i kontratave në planifikim të prokurimit	Vlera e parashikuar në planifikim (1)	Buxheti 2020-2022 (2)	Diferenca +/- (2-1)
16	4,947,998.18 €	7,831,773.00 €	+2,883,774.82 €

Burimi: Planifikimi i prokurimit e-prokurim, Ligji Nr. 071-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2020.

9.3 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë

Nga 16 kontrata të planifikuara për punë, INPO në Komunën e Gjilanit ka monitoruar vetëm katër (4) projekte, kjo për arsye se nuk kemi mundur ti identifikojmë me tituj të njëjtë kontratat/projektet në buxhet.

Vetëm dy (2) nga katër (4) kontratat e monitorura Komuna e Gjilanit i ka inicuar sipas planifikimit të prokurimit. Në dy raste të tjera nuk i është përmbajtur planifikimit. Projekti “Ndertimi i aneksit në shkollën Thimi Mitko” është tenderuar me vlerë të parashikuar të kontratës më të lartë sesa planifikimi, gjegjësisht 27,000.00€ më shumë. Sipas zyrtarit të prokurimit, rritja e vlerës së parashikuar në njoftimin për kontratë ka nodhur për arsye se gjatë planifikimit të prokurimit, njësia kërkuese ka besuar që ky projekt mund të kryhet me 40,000.00€ mirëpo pasi janë bërë projektet dhe planet e tjera të nevojshme për fillimin e këtij projekti, në koordinim me arkitektët dhe inxhinierët kemi vendosur të rrisim vlerën në njoftimin për kontratë në mënyrë që të përfundohen punët e kërkuara”.¹¹

Po ashtu, kontrata e planifikuar “Rregullimi i infrastruktuës nëntoksore-Lot Vaka dhe Metush Krasniqi, Cernice, Ponesh (shaljant)” me vlerë të parashikuar 200,000,00€, ka pësuar ndryshim në iniciimin e proceduarave të prokurimit. Komuna në këtë kontratë nuk kishte përfshirë rregullimin e infrastrukturës nëntokësore për fshatin Cernicë dhe Ponesh (Shaljant). Kështu, komuna ka bërë ndryshime të rrënjësishme nga planifikimi i prokurimit, me ç’rast tenderit i ishte ndryshuar titulli në “Ndërtimi I kanalizimit fekal Kanalizimi fekal në rrugën Metush Krasniqi L=910,00m, dhe Kanalizimi Atmosferik rruga Lot Vaka L=152,00m” me si dhe i është ndryshuar vlera e parashikuar e kontratës në 53,741.00€.

¹¹ Intervistë përmes telefonit me zyrtarin e prokurimit z.Izet Kurteshi, më 11.11.2020, realizuar nga Diell Haxhimusa.

Tabela 30. Kontratat për punë të analizuara

ZBATUESHMËRIA E PLANIFIKIMIT TË KONTRATAVE PËR PUNË				
Nr.	Emri i kontratës	Vlera në Planifikim të prokurimit (1)	Vlera në njoftim për kontratë (2)	Diferenca +/- (2-1)
1.	“Rregullimi i infrastruktures nentoksore-Lot Vaka dhe Metush Krasniqi, Cernice, Ponesh (shaljant)”	200,000.00€	53,741.00€	-146,259.00€
2.	“Ndertimi i aneksit në shkollën Thimi Mitko”	40,000.00€	67,000.00€	+27,000.00€
3.	“Punë Publike - projekte të vogla në infrastrukturë”	570,000.00€	570,000.00€	/
4	“Intervenimi me masa inovative të Eficiencës së Energjisë në shkollën Vesel Muja në fshatin Mibir”	45,865.50 €	45,865.50 €	/

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim, Komuna e Gjilanit

9.4 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim

Nga 29 kontratat e planifikuara për furnizime, në pesë (5) kontratat e monitoruara nga INPO, gjetjet tregojnë se komuna në përgjithësi i është përmbajtur vlerës së parashikuar të kontratave, mirëpo INPO ka gjetur se, gjatë planifikimit të prokurimit, komuna nuk ka planifikuar artikujt, sasi të dhe njësitë e furnizimeve për këto kontrata. Mirëpo, gjatë inicimit të prokurimit në këto kontrata janë vendosur sasi të e caktuara, në përgjithësi duke përdorur njësitë “paushall” dhe “copë”.

Tabela 31. Zbatueshmëria e Planifikimit të Kontratave për Furnizime për Vitin 2020

#	ZBATUESHMËRIA E PLANIFIKIMIT TË KONTRATAVE PËR FURNIZIM						
#	#	Planifikim i prokurimit			Tenderim		
Nr.	Emri i kontratës	Njësia	Sasia	Vlera totale	Njësia	Sasia	Vlera totale
1.	“Furnizim me Ditar”	Komplet	1	10,100.00€	copë	1009	9,999.99€
2.	“Furnizim me fare Gruri”	Komplet	1	45,000.00€	copë paushall	140 kg	45,000.00€
3.	“Furnizimi me shujtë ditore për nxënsit e shkollave fillore për klasët 1-5 dhe klasetë parashkollore në kuader të shkollave”	Komplet	1	39,974.80€	/	109520	40,000.00€
4.	“Furnizim dhe mbjellja e drunjëve dekorativ”	Komplet	1	20,000.00€	copë	2600	20,000.00€
					Paushall	copë, 1 Paushall	
5.	“Furnizim me serra të zinguar”	Komplet	1	50,000.00€	copë	30 copë	50,000.00€

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim (përshkrimi i çmimeve), Gjilan.

10. KOMUNA KAÇANIK

10.1 Pasqyrë e planifikimit të prokurimit 2020

Komuna e Kaçanikut për vitin 2020 ka planifikuar 11 aktivitete për furnizime me vlerë 185,837.00€, 12 aktivitete për shërbime me vlerë 411,427.00€, 57 aktivitete për punë në vlerë 1,630.000,00€ dhe 2 aktivitete për konkurs projektimi në vlerë 40,000.00€. Vlera totale e planifikimit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2020 është 2,267,264.00€.

Tabela 32: Planifikimi i prokurimit 2020, Komuna e Kaçanikut.

PASQYRË E PLANIFIKIMIT 2020		
Lloji i kontratës	Numri i kontratave	Vlera e kontratës
Furnizime	11	185,837.00€
Shërbime	12	411,427.00€
Punë	57	1,630.000,00€
Konkurs projektimi	2	40,000.00€

Burimi: Planifikimi i prokurimit e-prokurim, Komuna Kaçanik

10.2 Kontratat e planifikuara për punë dhe buxheti

Komuna e Kaçanikut për kontratat për punë ka planifikuar të shpenzojë 1,630,000.00€, ndërsa buxhetin 2020-2022 për këto kontrata e ka të planifikuar në vlerë prej ka 4,697,551.00€. Shumica e projekteve të planifikuara në prokurim sipas buxhetit janë kontrata më të gjata se një vit, ndërsa komuna nuk ka arritur që në planifikim t'i identifikoj si të tilla. INPO ka gjetur se komuna në disa kontrata për punë tek data e planifikuar e fillimit të punimeve e ka shënuar fjalinë “Në momentin e sigurimit të fondeve”. Këtë gjetje zyrtari përgjigjesës i prokurimit e ka arsyetuar me faktin se këto projekte zhvillohen në bashkëpunim me ministritë dhe nuk janë të sigurtë nëse projektet relaizohen pasi varet direkt nga ndarja e fondeve nga ministritë përkatëse.¹²

Tabela 33: Numri i kontratave të planifikuara për punë dhe buxheti.

NUMRI I KONTRATAVE TË PLANIFIKUARA PËR PUNË DHE BUXHETI			
Numri i kontratave	Vlera e parashikuar në planifikim (1)	Buxheti 2020 -2022 (2)	Diferenca +/- (2-1)
57	1,630,000.00€	4,697,551.00€	+3,067,551.00€

Burimi: Planifikimi i prokurimit e-prokurim, Ligji Nr. 07I-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2020

10.3 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë

Në pesë (5) kontratat për punë të monitoruara INPO ka gjetur se komuna nuk ka respektuar planifikimin e prokurimit, respektivisht në të gjitha këto projekte gjatë fazës së tenderimit kemi rritje të vlerës së parashikuar për kontratë. Lidhur me këtë çështje zyrtari i prokurimit në intervistën e datës 05.10.2020 ka deklaruar se “Kemi raste kur është parashikuar më pak, mirëpo pastaj me mjete të bartura iu është rritur vlera e parashikuar sepse kur e kemi bërë planifikimin nuk e kemi pasur të definuar çështjen e mjeteve të bartura”. Pra kjo argumenton që komuna ka dështuar të

¹² Intervistë përmes telefonit me zyrtarin e prokurimit, z. Shefket Koxha më 05.10.2020, realizuar nga Qëndrim Arifi.

përpiloj një raport përfundimtar dhe në mënyrë të detajuar sepse nëse prokurimi do të ishte përpiluar 15 ditë pas miratimit të buxhetit të Republikës së Kosovës, ashtu siç kërkohet me LPP nuk do të krijohej situata që komuna të mos të dijë vlerën e buxhetit që do të bartet në vitin tjetër. Veprime të tilla, ofrojnë dëshmi të mjaftueshme se komuna nuk ka bërë planifikimin e prokurimit sipas kërkesave ligjore.¹³

Tabela 34: Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë.

ZBATUESHMËRIA E PLANIFIKIMIT TË KONTRATAVE PËR PUNË				
Nr.	Emri i kontratës	Vlera në Plan të Prokurimit (1)	Vlera njoftim për kontratë (2)	Diferenca +/- (2-1)
1.	“Rregullimi i trotuarit në lagjen Topalli-Soponicë”	15,000.00 €	30,000.00 €	+15,000.00 €
2.	“Rregullimi i ndriqimit Publik”	45,000.00 €	50,000.00 €	+5,000.00 €
3.	“Rregullimi i trotuarit në rrugën Bob-Doganaj”	50,000.00 €	60,000.00 €	+10,000.00 €
4.	“Ndërtimi i rrugëve në fshatin Kaçanik i vjetër”	60,000.00 €	65,000.00 €	+5,000.00 €
5.	“Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike”	80,000.00 €	100,000.00 €	+20,000.00 €

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim Komuna e Ferizaj

10.4 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim

INPO ka monitoruara edhe kontratat për furnizim të cilat Komuna e Kaçanikut ka planifikuar t'i zhvilloj gjatë vitit 2020, respektivisht zbatimin e planifikimit lidhur me kontratat për furnizim. Janë monitoruara të gjitha aktivitetet për furnizim që ka zhvilluar komuna deri në më 05.10.2020, dhe vërejmë që asnjë kontratë e tenderuar nuk përputhet me planifikimet e komunës, as për nga titulli i kontratës dhe as për nga vlerat dhe sasisht. Gjatë intervistës së datës 05.10.2020, zyrtari i prokurimit është pyetur edhe për këtë gjë dhe i njëjti ka thënë se “ka raste kur njësitë kërkuuese kanë dalë jashtë planifikimit sepse në fillim nuk i kanë identifikuar saktë se çka ju duhet”. Kështu, kontratat për furnizime të tenderuara nga komuna deri në tetor 2020, nuk mund të konsiderohen të planifikuara.

¹³ Shih, neni 8, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 04/I-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Tabela 35: Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim

#	ZBATUESHMËRIA E PLANIFIKIMIT TË KONTRATAVE PËR FURNIZIM						
#	#	Planifikim i prokurimit			Tenderim		
Nr.	Emri i kontratës	Njësia	Sasia	Vlera totale	Njësia	Sasia	Vlera totale
1.	Furnizim me material për laborator ¹⁴	Kuti	20	28,000.00€	Copë	142034	13,500.00€
					Kuti	474	
					Litër	115	
2.	“Furnizimi dhe montimi i serrave per fermer”	/	/	/	Copë	171	68,400.00€
3.	“Furnizim me autoambulancë me paisje përcjellëse.”	/	/	/	/	/	55,00.00€
4.	“Furnizim me material për mirmbajtjen e objekteve”	/	/	/	Të ndryshme	5528	9,950.00€
5.	“Furnizim me paisje sportive per salla te edukates Fizike”.	/	/	/	Copë	200	17,500.00€
					Komplet	2	
					Set	3	
					Palë	2	

Burimi: Planfikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim (përshkrimi i çmimeve), Komuna e Ferizajt

¹⁴ Shënim: Kjo kontratë në planin e prokurimit është e përshkruar “Furnizim me material stomatologjik dhe laboratorik”. Gjatë fazës së tenderimit komuna nuk ka bërë kërkesën për furnizim edhe me material stomatologjik. Kontrata për furnizime me artikuj të stomatologjisë është tenderuar si e veçantë, me vlerë të parashikuar 18,000.00€.

11. KAMENICË

11.1 Pasqyrë e planifikimit të prokurimit 2020

Komuna Kamenicë ka planifikuar aktivitete/ projekte të prokurimit ku vlera minimale e tyre sipas planifikimit të prokurimit është 2,500.00€, ndërsa maksimale është 174,000.00€, këto projekte janë planifikuar të inicohen prej 27.03.2020 deri me 13.10.2020. Planifikimit i Prokurimit përmban 11 kontrata për furnizime, 10 kontrata për shërbime, shtatë (7) kontrata për punë dhe asnjë kontratë për konkurse të projektimit.

Tabela 37: Planifikimi i prokurimit për vitin 2020, Komuna Kamenicë

Lloji i kontratës	Numri i kontratave	Vlera totale
Furnizime	11	352,034.00 €
Shërbime	10	270,232.00 €
Punë	7	407,028.00 €
Konkurs projektimi	/	0.00 €

Burimi: Planifikimi i prokurimit e-prokurim, Komuna e Kamenicës

11.2 Kontratat e planifikuara për punë dhe buxheti

INPO, ka vërejtur që Komuna e Kamenicës ka vepruar në kundërshtim të dispozitave të prokurimit publik duke mos e caktuar vlerën e parashikuar të kontratës në planifikimin e prokurimit dhe duke mos vepruar konform Ligjit për Prokurimin Publik me Nr.04/L-042 më saktësisht nenit 8, pika 1: “Jo më pak se tridhjetë (30) ditë para fillimit të çdo viti fiskal, secili autoritet kontraktues duhet të përgatisë, planifikimin paraprak të prokurimit, dhe në rast të një autoriteti publik apo një ndërmarrje publike duhet të dorëzoj me shkrim te Zyrtari Kryesor Administrativ i Autoritetit Kontraktues, në të cilat identifikohen me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët, që autoriteti kontraktues parasheh t’i prokurojë gjatë vitit fiskal në fjalë, dhe pika 1.3 e cila thotë: “në rastin e kontratave për punë, karakteristikat thelbësore të çdo kontrate të punës, që autoriteti kontraktues planifikon ta japë gjatë vitit fiskal”. Ndërsa, në Kontratën e punës të titulluar “Ujësjiellësi në qytet dhe fshatra” e planifikuar të inicohet me datën 10.04.2020 i mungon vlera e parashikuar e kontratës në planin e prokurimit.

Tabela 36: Pasqyrë e kontratave për punë të planifikuara për vitin 2020, Komuna e Kamenicës

Numri total i kontratave për punë	Vlera e parashikuar me plan të prokurimit (gjithsej)	Buxheti 2020-2022	Diferenca mes vlerës së parashikuar në PP dhe Buxhet 2020-2022 +/-
7	€ 407,028.00	€ 1, 254,206.00	€ +847,178.00

Burimi: Plani i prokurimit për vitin 2020 për komunën e Kamenicës dhe Ligji mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020

11.3 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë

Në planifikimin e prokurimit për vitin 2020 janë të planifikuara shtatë (7) kontrata të punës, ndërkaq INPO ka monitoruar tri (3).

Projekti “Ndërtimi i rrugëve me asfalt, mbushja e gropave dhe shtrirja e rrugëve me zhavorë” INPO ka vërejtur që në planifikimin e prokurimit nuk ka qenë i planifikuar mirë pasi ka ndryshime të vlerave të parashikuar nga planifikimi i prokurimit prej asaj të publikuar në njoftimin për kontratë. Në buxhetin e Republikës së Kosovës për këtë projekt janë ndarë në total 525,122.00€, për vitet 2020-

2022, mirëpo në njoftimin për kontratë nuk është vlerë e njëjtë (shih tabelën 37) edhe pse kontrata në fjalë sipas njoftimit për kontratë duhet të përfundojë pas katër (4) muajve, aty ka mjete të ndara edhe për vitet e ardhshme.

Për kontratën e emërtuar “Ndërtimi i aneksit të objektit të shtëpia e Komunitetit” INPO ka hasur në ndryshim të emërimit prej planifikimit të prokurimit në njoftimin për kontratë. Po ashtu, vlera e planifikuar në planifikim të prokurimit nuk është e planifikuar mirë pasi nga buxheti i Republikës së Kosovës për këtë projekt janë ndarë 60,000.00€ për vitet 2020-2022, mirëpo në vlerën e parashikuar të planifikimit të prokurimit dhe në njoftimin për kontratë është vlerë tjetër (shih tabelën 36).

Për të parë më detajisht si planifikon komuna të financoj këto projekte INPO, me 08.09.2020 ka zhvilluar intervistë përmes telefonit me zyrtarin kryesor për financa z. Naser Hashani, i njëjti theksoi “Sipas deklaratave të personit përgjegjës të shtëpisë rezidenciale mund të nevojiten më shumë të mjete për përfundimin e këtij projekti dhe për këtë arsye kanë ndarë mjete edhe për vitin 2021 dhe 2022”.

INPO, gjatë hulumtimit ka hasur edhe në inicim të procedurave tenderuese për projekte të cilat nuk figurojnë në planifikimin e prokurimit e për të cilat nuk ka mjete të ndara nga buxheti i Kosovës, kontratat në fjalë janë: “Zhvillimi socio-ekonomik në Komunën e Kamenicës përmes ndërtimit të kolektorit të ujërave të zeza në fshatin Koretin” vlera e parashikuar në njoftimin për kontratë është 127,690.75€, “Renovimi i hapësirave për adaptimin e programit Bonevet” vlera e parashikuar në njoftimin për kontratë është 7,900.00€, “Punimi i drenazhës në shtëpinë e kulturës” vlera e parashikuar në njoftimin për kontratë është 9,000.00€.

Gjithashtu, INPO ka zhvilluar intervistë me 08.09.2020 me menaxherin e prokurimit z. Urim Thaqi dhe e ka pyetur se nga do të i sigurojnë mjetet për financim dhe i njëjti ndër të tjerash theksoi “80,000.00€ do të barten nga mjetet e ndara për projektin e planifikuar në plan të prokurimit të titulluar “Participimi me Donatorë” për projektin e titulluar “Zhvillimi socio ekonomik në Komunën e Kamenicës përmes ndërtimit të kolektorit të ujërave të zeza në fshatin Koretin”, 18,000.00€ do të ndahen nga të ardhurat vetanake të komunës ndërsa mjetet e tjera të mbetura do të ndahen në vitin e ardhshëm fiskal nga të ardhurat e komunës ngase ky është projekt dy-vjeçar. Gjithashtu, edhe projektet e tjera të titulluara “Renovimi i hapësirave për adaptimin e programit Bonevet”, “Punimi i drenazhës në shtëpinë e kulturës” do të financohen nga shuma e ndarë për projektin “Participimi me Donatorë”, INPO konsideron se Komuna Kamenicë ka vepruar në kundërshtim me nenin 9 të LPP-së.¹⁵

Tabela 37: Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë për vitin 2020, Komuna e Kamenicës

Nr.	Kontrata	Vlera në planifikim të prokurimit (1)	Vlera në njoftim për kontratë (2)	Diferenca +/- (2-1)
1.	“Ndërtimi i rrugëve me asfalt, mbushja e gropave dhe shtrirja e rrugëve me zhavorr”	174,000.00 €	44,000.00 €	130,000.00 €
2.	“Ndërtimi i aneksit të objektit të shtëpia e komunitetit”	20,000.00 €	20,000.00 €	0.00 €
3.	“Renovimi i shkollave”	50,000.00 €	60,000.00 €	-10,000.00 €

Burimi: Planifikimi i prokurimit Komuna Kamenicë, i publikuar në platformën e-prokurimi

¹⁵ Për më shumë shih, Neni 9 Ligjit nr. 04/I-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

11.4 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim

Komuna e Kamenicës në planifikimin e prokurimit për vitin 2020 ka planifikuar 11 Kontrata për furnizim ku vlera totale është 352,034.00€. INPO, ka bërë analizimin e disa kontratave të furnizimit ku kemi vërejtur që në planifikimin e prokurimit kanë munguar të dhëna shumë të rëndësishme si “njësia dhe sasia e produktit”. Po ashtu, edhe në paramasat (përshkrimet e çmimeve) të publikuara në e-prokurim kemi hasur në njësi “matëse” si: Sprej, Sol, rollë, kutia, paushall, etj.

Tabela 38: Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim, Komuna e Kamenicës

#	Planifikimi			Tenderimi		
Kontrata	Njësia	Sasia	Vlera Totale	Njësia	Sasia	Vlera Totale
“Furnizimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave”	/	/	40,000.00 €	Copë, M	236	40,000.00 €
“Furnizime me barna dhe material shpenzues medicinal, laboratorik dhe stomatologji”	/	/	63,621.00 €	Kuti	958	63,621.00 €
				Copë	476,411	
				komplet	116	
				Litër	1575	
				Amp	34,860	
				Rollë	170	
				sprej	15	
				Sol	60	
				kanta	10	
“Furnizim me lëndë djegëse-dru për institucionet e komunës”	/	/	113,300.00 €	m ²	2317	104,700.00 €
“Furnizim i shkollave me pajisje laboratorike”	/	/	20,000.00 €	Copë, kg, litër, kutia	3236	20,000.00 €
“Furnizim me kalda dhe renovimi i kaldave”	/	/	63,000.00 €	Copë,	24	20,000.00 €
				metër,	161	
				litër,	200	
				paushall,	1	
				ÇA	2	

Burimi: Planifikimi i prokurimit, “përshkrimi i çmimeve” platforma e-prokurimi

12. KLINË

12.1 Pasqyrë e planifikimit të prokurimit 2020

Komuna e Klinë sipas Planit të Prokurimit për vitin fiskal 2020 ka planifikuar të zhvillojë 59 aktivitete të prokurimit. Komuna ka planifikuar që gjatë këtij viti të realizojë më së shumti kontrata për punë 25, pasuar me kontratat për shërbime 20 dhe kontratat për furnizim 14. Rrjedhimisht, vlera më e madhe e mjeteve që Komuna planifikon të shpenzojë gjatë këtij viti është për kontratat për punë me mbi 1,9 milionë euro, pastaj për kontratat për shërbime me mbi 550 mijë euro si dhe mbi 456 mijë euro Komuna ka planifikuar t'i shpenzojë për kontratat për furnizim. Vlen të theksohet se bazuar në Planin e Prokurimit, Komuna Klinë nuk ka planifikuar të realizojë asnjë kontratë me konkurs të projektimit për vitin 2020.

Tabela 39. Planifikimi i prokurimit për vitin 2020, Komuna e Klinës

Lloji i kontratave	Numri i kontratave	Vlera totale
Furnizim	14	456,984.50 €
Shërbime	20	551,840.00 €
Punë	25	1,935,000.00 €
Konkurse të Projektimit	/	/

Burimi: Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit 2020 për Komunën e Klinës, e-prokurimi

12.2 Kontratat e planifikuara për punë dhe buxheti

Numri total i kontratave për punë që Komuna e Klinës ka planifikuar të realizojë gjatë vitit 2020 është 25 kontrata. Ky numër praktikisht është më i lartë pasi komuna ka shpallur kontrata të ndara në lot-e në plan të prokurimi. Për shembull është planifikuar kontrata “Asfaltimi i rrugëve” dhe në kuadër të saj hyjnë disa lot-e “Asfaltim i rrugeve lot 1- Rruget lokale ne Gremnik lot 2- Rruget lokale ne Kpuz lot 3- rruget lokale ne Drenoc”, të cilat më pastaj mund të rezultojnë si kontrata të veçanta për secilin lot dhe kjo e rritë numrin e përgjithshëm të kontratave të planifikuara. Një fuzionim i tillë dhe me detaje të arsyeshme në plan të prokurimit konsiderohet si planifikim i mirë pasi që kursen kohën dhe rritë konkurrencën ndërmjet opertorëve ekonomik.

Tabela 40. Numri i Kontratave të Planifikuara sipas Planit të Prokurimit dhe Buxhetit të Republikës së Kosovës

Numri total i kontratave për punë	Vlera e parashikuar me Plan të Prokurimit (1)	Buxheti 2020-2022 (2)	Diferenca +/- (2-1)
25	1,935,000.00 €	1,250,000.00 €	-820,000.00 €

Burimi: Plani i Prokurimit për vitin 2020 për Komunën e Klinës, Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020

Gjatë analizës së kontratave të përfshira në plan të prokurimit dhe atyre në Buxhetin e Kosovës, INPO ka vërejtur se ekziston një dallim i konsiderueshëm në këto dy dokumente sa i përket vlerës së parashikuar të mjeteve të planifikuara për kontratat për punë për vitin 2020. Përderisa sipas planit të prokurimit, vlera e parashikuar e kontratave për punë është 1,935,000.00€, vlera e parashikuar sipas Buxhetit të Republikës së Kosovës është 1,250,000.00€. Megjithatë, janë edhe 11 projekte për punë në vlerë 309 mijë euro, të cilat nuk ka qenë i mundur identifikimi i tyre në në buxhet me titullin e njëjtë. (shih tabelën 43, për projektet që nuk idenetifikohen në buxhet).

12.3 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë

Gjatë monitorimit të planifikimit të prokurimit për Komunën e Klinës, INPO ka analizuar edhe zbatueshmërinë e planifikimit të prokurimit të pesë (5) kontratave për punë, përzgjedhja e të cilave është bërë përmes mostrës së rastësishme dhe duke bërë krahasimin e vlerës së paraqitur në planifikim të prokurimit me vlerën e paraqitur në njoftimin për kontratë, të publikuar në e-prokurim.

Tabela 41. Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë

Nr.	Kontrata	Vlera e parashikuar në plan të prokurimit (1)	Vlera e parashikuar në njoftimin për kontratë (2)	Diferenca +/- (2-1)
1	“Zgjerimi I Rrjetit Te Ndriqimit Publik ne Fshatra , Lagje te Qytetit dhe Lokalitete te Banuara nga Komunitetet ne Komunen e Klines”	55,000.00€	90,000.00€	+35,000.00€
2	“Rregullimi i Vorrezave te Deshmoreve , Veterenave dhe Vorresave Publike”	35,000.00€	35,000.00€	0€
3	“Ndërtimi i Fushës Ndhmëse te Futbollit -Faza e Dytë”	50,000.00€	130,000.00€	+80,000€
4	“Ndertimi i Ambulantes dhe Zyres se Vendit ne Ujmir”	55,000.00€	50,000.00€	-5,000€
5	“Ndertimi i Memorialit te Viktimave ne Kralan”	15,000.00€	15,000.00€	0€

Burimi: Planfikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim, Komuna e Klinës

INPO ka vërejtur se nga pesë (5) kontratat/projektet e përzgjedhura, dy prej tyre: “Rregullimi i vorresave te deshmoreve, veterenave dhe vorresave publike” dhe “Ndertimi i memorialit te viktimave ne kralan”, vlerën e mjeteve të parashikuara e kanë identike si në plan të prokurimit ashtu edhe në njoftimin për kontratë. Për dy kontratat/projekte tjera: “Zgjerimi i rrjetit te ndriqimit publik ne fshatra, lagje te qytetit dhe lokalitete te banuara nga komunitetet ne komunen e Klines” dhe “Ndërtimi I fushës ndihmëse te futbollit -Faza e dytë” është tejkaluar vlera e parashikuar e mjeteve në njoftimin për kontratë për 35 mijë euro dhe 80 mijë euro. Ndërsa, për kontratën/projektin: “Ndertimi i ambulantes dhe zyres se vendit ne Ujmir” janë parashikuar 5 mijë euro më pak sipas njoftimit për kontratë krahasuar me planin e prokurimit.

12.4 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim

INPO ka monitoruar pesë (5) kontrata për furnizim, duke bërë krahasimin e vlerës së paraqitur në planifikim të prokurimit me vlerën e paraqitur në njoftimin për kontratë të publikuar në e-prokurim. INPO ka evidentuar se ekzistojnë ndryshime të konsiderueshme sa i përket aspektit të përcaktimit të njërive/sasive të artikujve të planifikuar si dhe vlerës së parashikuar të mjeteve për këto kontrata/projekte.

Tabela 42. Zbatueshmëria e Planifikimit të Kontratave për Furnizime për Vitin 2020

Planifikimi			Vlera totale	Tenderimi		
Kontrata	Njësia	Sasia		Njësi	Sasia	Vlera totale
“Furnizim me montim me xhama”	“xhama i thjeshte 0.4 mm”	500 m ²	8,300.00€	Furnizim dhe montim me xhame te thjeshte 0.4mm dhe me dy xhama	200 m ²	10,000.00€
	“xhama te thjeshte 0.6 mm”	30 m ²		Furnizim me montim dhe me xhame te thjeshte 0.6mm	70 m ²	
	“xhama ornament 0.4 mm”	20 m ²				
	“xhama termopan 16 20 24”	30 m ²		montim me xham trmopan 16 20 40	20.00 m ²	
	“xhama armiruar 0.4 mm”	20 m ²		Furnizim me montim me xhama te armiruar 0.4mm	20.00 m ²	
	“xhama griz 0.4 mm”	50 m ²		Furnizim me montim me griz 0.4mm	10.00 m ²	
	“mekanizem per dritare pvc - me montim”	50 copë		Furnizim dhe montim me mekanizem per dritare PVC	20 Copë	
	“mekanizem per dyer pvc- me montim”	50 copë		Furnizim me montim me mekanizem per dyer PVC	20 Copë	
	“korniza per foto dhe shpallje - me montim”	100 m ²		Furnizim me kornize per fotografi A1 dim. 84X59 cm	50 Copë	
“Furnizim me materjal hixhenik per mirembajtje	Total	1	15,000.00€	Copë	23,285.00	35 000,00€
				Litër	7,200.00	

te objekteve shkollore administrates dhe objekteve tjera”				Kg		
					250.00	
				Palë		
					100.00	
“Furnzim me uniforma dhe veshje lot 1- veshje -uniforma pune per zjarrefikes lot 2- uniforma pune per inspektor dhe punetor te sigurimit te komunes”	Komplete	45	15,000.00€	Komplete	32	12,000.00€
				Palë	118	
	Palë	45		Copë	434	
	Copë	300				
“Furnzim me Filma Dixhital per Radiologji”	Total	1	30,000.00€	Filma Medical Dry Film - Di - HL 20x25 (Paketimi 1x150)	11700 Pako	30,000.00€
				Filma Medical Dry Film - Di - HL 35x43 (Paketimi 1x150)	6000 Pako	
“Furnzim me Automjete Zyrtare”	Copë	2	€ 24,000.00	Automjeti Sipas Specifikacionit te Obliguar Teknik nga Aneksi per Variantin 1	4 Copë	50,000.00€

				Automjeti sipas Specifikacionit te Obliguar Teknik nga Aneksi per Variantin 1	4 Copë	
--	--	--	--	---	--------	--

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim (përshkrimi i çmimeve), Komuna e Klinës

Sa i përket vlerës së mjeteve të parashikuara, mund të vërehet se për kontratën/projektin “FURNIZIM ME MONTIM ME XHAMA” është tejkaluar vlera e parashikuar në Njoftimin për kontratë krahasuar me Planin e Prokurimit, ndërsa numri i artikujve të planifikuar për furnizim është më i vogël. Gjithashtu vërehen dallime të konsiderueshme në sasi të planifikuara, pra në disa raste është rritur apo zvogëluar sasia e planifikuar për furnizim. Për kontratën/projektin “Furnizim me materjal hixhenik per mirembajtje te objekteve shkollore administrates dhe objekteve tjera” vërehet dallim i madh sa i përket emërtimit të projektit në planin e prokurimit dhe publikimit në e-prokurim. Po ashtu, është tejkaluar vlera e parashikuar, si dhe vërehet ndryshim i madh në njësitë dhe sasi të planifikuara. Ndërsa për projektin tjetër “Furnizim me uniforma dhe veshje lot 1- veshje -uniforma pune per zjarrefikes lot 2- uniforma pune per inspektor dhe punetor te sigurimit te komunes” vlera e parashikuar sipas njoftimit për kontratë është më e vogël se ajo në plan të prokurimit, përderisa vërehen ndryshime në sasi të planifikuara për furnizim. Edhe për projektin “Furnizim me filma dixhital per radiologji” (emërtimi sipas publikimit në e-prokurim) vërehet dallim në emërtim krahasuar me planifikimin e prokurimit, në të cilin projekti është i emërtuar si “Filma per Rengen”. Në planifikim ky projekt është i paraqitur si artikull në kuadër të projektit “Furnizim me Paisje Mjeksores”. Vlera e mjeteve të parashikuara nuk dallon sipas procedurës së tenderimit krahasuar me planifikimin, mirëpo vërehet dallim i madh në njësitë dhe sasi të planifikuara.

Për projektin “Furnizim me Automjete Zyrtare” (emërtimi sipas publikimit në e-prokurim) vërehet po ashtu dallim në emërtim krahasuar me planifikimin e prokurimit, në të cilin projekti është i emërtuar si “Furnizim me Automjete”. Në planifikim ky projekt është i paraqitur si artikull në kuadër të projektit “Blerje e Veturave”. Vlera e mjeteve të parashikuara për këtë projekt sipas procesit të tenderimit e tejkalon vlerën e parashikuara sipas planifikimit të prokurimit, gjithashtu vërehet dallim i madh në sasi të planifikuara.

12.5 Projektet/aktivitetet që nuk janë të përfshira në buxhet

INPO ka analizuar nëse të gjitha aktivitetet/projektet e përfshira në Planin e Prokurimit janë të identifikuar edhe në Buxhetin e Kosovës dhe ka gjetur se për Komunën e Klinës janë gjithsej 11 aktivitete/projekte që nuk mund të identifikohen në Buxhet të Kosovës. Në tabelën 43 janë listuar këto projekte së bashku me vlerën e parashikuar, ku vlera totale e parashikuar për këto pesë projekte sipas Planit të Prokurimit është 309 mijë euro.

Tabela 43. Aktivitet/projektet që nuk janë të identifikuar në Buxhetin e Republikës së Kosovës

Titulli i projektit	Vlera e parashikuar në Plan të Prokurimit
“Ndertimi i zyres se vendit ujmir”	55,000.00€
“Renovimi i salles se kuvendit”	10,000.00€
“Renovimi i qmf-ve dhe amf”	25,000.00€
“Renovimi i salles se trajnimeve dhe bifese ne QKMF”	5,000.00€
“Rregullimi i parkut te qkmf dhe montimi i rampes hyrese”	4,000.00€
“Ndertimi i fushave te sportit ne shkolla”	70,000.00€
“Rregullimi i toaleteve fushore ne shkolla”	10,000.00€
“Ndertimi i depove per lende djegese ,ndertimi i rrethojave rregullimi i hyrjeve ne shkolla”	5,000.00€
“Riparimi dysHEMEVE , laminatit ne qedhe , kaldajes ne qerdhe”	5,000.00€
“Ndrimi i dyerve dhe dritareve ne shkollen ujmir”	20,000.00€
“Renovime te brendeshme te objekteve shkollore”	100,000.00€

Burimi: Plani i Prokurimit për vitin 2020 për Komunën e Klinës

Një prej problemeve të identifikuar është edhe mospërputhja në përshkrimin ose emërtimin e aktiviteteve/projekteve, më konkretisht dallimi në përshkrimin e tyre në Plan të Prokurimit dhe në Buxhetin e Kosovës, ku për Komunën e Klinës INPO ka gjetur se ekzistojnë tri (3) aktivitete/projekte, emërtimi i të cilave dallon në Plan të Prokurimit krahasuar me Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Tabela 44. Ndryshimi në emërtimin e projekteve sipas Planit të Prokurimit krahasuar me emërtimin sipas Buxhetit të Republikës së Kosovës

PLANIFIKIMI I PROKURIMIT	LIGJI PËR BUXHET
“Ndertimi i memorialit ne Kralan”	“Ndertimi i Lapidarit për të pagjeturit”
“Ndertimi i ujesjelleve”	“Ndertimi i ujësijellës në komunën e Klinës”
“Mirembajtja verore e rrugëve - sanim i gropave ne rruget me asfalt”	“Sanimi i gropave të rrugëve me asfalt”

Burimi: Plani i Prokurimit për vitin 2020 për KK Klinë, Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020

13. LEPOSAVIQ

13.1 Pasqyrë e planifikimit të prokurimit 2020

Komuna e Leposaviqit në planifikimin e saj për vitin fiskal 2020 kishte planifikuar të zhvilloj 38 aktivitete të prokurimit, prej tyre më se shumti kishte planifikuar të zhvilloj për kategorinë punë dhe furnizim nga 16, pastaj të tjerat për kategorinë shërbime, ndërsa për kategorinë konkurs projektimi nuk kish planifikuar asnjë aktivitet/projekt. Vlera totale e të gjitha aktiviteteve/ projekteve të planifikuara është 2,214,413.05€. Ky planifikim është publikuar në e-prokurim me 31.03.2020 dhe ka pasur rishikim me 24.09.2020, ndërsa në ueb-faqe të komunës nuk është publikuar.

Tabela 44. Planifikimi i prokurimit për vitin 2020, Komuna Leposaviç

Lloji i kontratave	Numri i kontratave	Vlera totale
Furnizim	16	266,030.00€
Shërbime	6	120,800.00€
Punë	16	1,827,583.05€
Konkurs Projektimi	/	/

Burimi: Planifikimi i prokurimit e-prokurim, Komuna Leposaviç

13.2 Kontratat e planifikuara për punë dhe buxheti

Bazuar në planifikimin e prokurimit Komuna e Leposaviqit siç edhe e elaboruam edhe më lartë ka planifikuar më së shumti kontrata/ projekte për kategorinë punë në vlerë totale prej 1,827,583.05€, kjo kategori nuk është plotësuar sipas kërkesave ligjore pasi, në planifikimi të prokurimit të publikuar nga komuna janë të plotësuar vetëm përshkrimi i kontratës (titulli i kontratës), data e parashikuar e fillimit të prokurimit dhe vlera e parashikuara. Për më tepër, për këtë kategori do të thotë për projektet punë/ investime kapitale të parapara në planifikim dhe projektet e njejta krahasur me ligjin mbi ndarjet buxhetore 2020-2022 të miratuar në mars 2020 kemi një diferencë prej +3,564,083.95€, INPO ka vërejtur se disa kontrata janë dy vjeçare por si të tilla nuk janë planifiku. Gjithashtu, janë edhe pesë (5) projekte që janë të planifikuara për punë por, tek buxheti nuk figurojnë, INPO ka pyetur zyrën e prokurimit dhe ata kanë dekluar se ato projekte financohen nga kategoria mallra dhe shërbime.

Tabela 45. Numri i Kontratave të Planifikuara në Plan të Prokurimit dhe Buxhet të Republikës së Kosovës

Numri total i kontratave për punë	Vlera e parashikuar me Plan të Prokurimit (1)	Buxheti 2020-2022 (2)	Diferenca +/- (2-1)
16	1,827,583.05€	5,391,667.00 €	+3,564,083.95€

Burimi: Planifikimi i prokurimit e-prokurim, Ligji Nr. 07I-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2020.

13.3 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë

Nga 38 aktivitete/ projekte sa i ka komuna të planifikuara INPO ka zgjedhur katër (4) projekte¹⁶ dhe ka krahasuar vlerën e paraqitur në planifikim të prokurimit dhe vlerën e paraqitur në njoftimin për kontratë të publikuar në e-prokurim, vërejmë se katër (4) projekte kanë vlerë identike.

Tabela 46. Zbatueshmëria e Planifikimit të Kontratave për Punë për vitin 2020

Nr.	Kontrata	Vlera e parashikuar në plan të prokurimit (1)	Vlera e parashikuar në njoftimin për kontratë (2)	Diferenca +/- (2-1)
1	“Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit-Belo Brdo deri në Zemanica, L=11km”	65,000.00€	65,000.00€	/
2	“Ndërtimi, rindërtimi dhe shtrimi i rrugëve në komunën e Leposavic”	208,900.00€	208,900.00€	/
3	“Mirëmbajtja dhe rehabilitimi i objekteve”	20,000.00€	20,000.00€	/
4	“Rehabilitimi i kolektorit kryesor të ujërave të zeza në MZ Socanica”	31,800.00€	31,800.00€	/

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim Komuna Leposaviç

13.4 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim

Nga gjithsej 16 projekte për kategorinë furnizim sa ka të planifikuara komuna. INPO, përmes mostrës së rastësishme ka përzgjedhur katër (4) kontrata për furnizim, ashtu siç kemi vepruar edhe me kontratat/ projektet për punë.

Në katër (4) kontratat komuna ka vepruar saktësisht siç ka planifikuar në plan të prokurimit të njëtat vlera i ka edhe në e-prokurim. Por, që komuna nuk ka vepruar sipas ligjit për prokurim publik respektivisht, nenit 8. Aktivitetet të cilat i kemi monitoruara në e-prokurim se si janë plotësuar pjesa e “përshkrimit të çmimit” dhe kemi vërejtur se Komuna e Leposaviqit për dallim nga planifikimi i prokurimit këtu në të katër (4) kontratat për furnizime i ka të specifikuar njësit dhe sasi të.

¹⁶ Vështirësi në identifikim të kontratave (përkthimi shqip-serbisht).

Tabela 47. Zbatueshmëria e Planifikimit të Kontratave për Furnizime për Vitin 2020

#	ZBATUESHMËRIA E PLANIFIKIMIT TË KONTRATAVE PËR FURNIZIM						
#	#	Planifikim i prokurimit			Tenderim		
Nr.	Emri i kontratës	Njësia	Sasia	Vlera totale	Njësia	Sasia	Vlera totale
1.	“Pajisja e një ambulance”	Komp	1	15,340.00€	Komp	1	15,340.00€
2.	“Furnizimi me pajisje mbrojtëse higjieno (maska mbrojtëse, dezinfektues, etj.)”	Komp	1	32,000.00€	Komp	2360 Komp	32,000.00€
					Kutij	1000 Kutija	
					Litra	900 Litra	
3.	“Prokurimi i materrialeve të ngrohjes”	/	1	26,000.00€	Metër kub m ³	610	26,000.00€
4.	“Pajisja e ndërtesës së komunitetit lokal Bistrica me inventar”	/	/	6,000.00€	Copë	84-copë	6,000.00€
					m	261-m	
					m2	104-m2	
					paushal l		

Burimi: Planfikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim (përshkrimi i çmimeve), Komuna e Leposaviqit

13.5 Aktivitetet/ projektet qe nuk janë identifikuar në buxhet

INPO, ka hulumtur për të parë nëse janë përfshir të gjitha aktivitet e planifikuara nga ana e komunës në ligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin 2020, dhe këtu nuk kemi arritur të identifikojmë pesë (5) projekte, do të thotë rreth 131,197.05€ nuk janë të përfshira në ligjin mbi ndarjet buxhetore 2020, shih tabelën 48.¹⁷

Tabela 48. Aktivitetet/ Projektet qe nuk janë identifikuar në Buxhet të Republikës së Kosovës

TITULLI I AKTIVITETIT/ PROJEKTIT	VLERA E PARASHIKUARA NË PLANIFIKIM TË PROKURIMIT
“Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve kulturore dhe sportive”	50,497.05€
“Pastrimi dhe funksionimi i shtratit të lumit Ibër me material rrethor.	50,000.00€
Mirëmbajtja e rrugës në kushtet e dimrit”	9,000.00€
“Rindërtimi i rrjetit elektrik dhe të furnizimit me ujë në kishëzën në Soçanica”	1,700.00€
“Mirëmbajtja dhe rehabilitimi i ambienteve”	20,000.00€

Burimi: Planifikimi i prokurimit, e-prokurim. Komuna e Leposaviqit

14. MITROVICË E JUGUT

14.1 Pasqyrë e planifikimit të prokurimit 2020

Komuna e Mitrovicës së Jugut sipas Planit të Prokurimit për vitin fiskal 2020 ka planifikuar të zhvillojë 80 aktivitete të prokurimit. Komuna ka planifikuar që gjatë këtij viti të realizojë më së shumti kontrata për furnizim 45, pasuar me kontratat për punë 20 dhe kontratat për shërbime 15. Vlera më e madhe e mjeteve që Komuna planifikon të shpenzojë gjatë këtij viti është për kontratat për punë me 1,065,314.00€, pastaj për kontratat për furnizim me 904,652.68€ si dhe 524,884.00€. Komuna ka planifikuar t'i shpenzojë për kontratat për shërbime. Vlen të theksohet se bazuar në Planin e Prokurimit, Komuna e Mitrovicës së Jugut nuk ka planifikuar të realizojë asnjë kontratë me konkurs të projektimit për vitin 2020.

Tabela 49. Planifikimi i prokurimit për vitin 2020, Komuna Mitrovicës së Jugut

Lloji i kontratave	Numri i kontratave	Vlera totale
Furnizim	45	904,652.68€
Shërbime	15	524,884.00€
Punë	20	1,065,314.00€
Konkurse të Projektimit	/	/

Burimi: Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit 2020 për Komunën e Mitrovicës së Jugut, e-prokurimi

¹⁷ Komuna deklaron se projektet e tabelës 48, financohen nga kategoria mallra dhe shërbime.

14.2 Kontratat e planifikuara për punë dhe buxheti

Siç edhe u elaborua më lart, numri total i kontratave për punë që Komuna e Mitrovicës së Jugut ka planifikuar të realizojë gjatë vitit 2020 është 20, vlera e të cilave arrinë në €1,065,314.00.¹⁸ Bazuar në planin e prokurimit të publikuar nga komuna, për shumicën e kontratave/projekteve kjo kategori nuk është planifikuar sipas kërkesave ligjore, respektivisht nenit 8 të LPP-së.

Tabela 50. Numri i Kontratave të Planifikuara sipas Planit të Prokurimit dhe Buxhetit të Republikës së Kosovës

Numri total i kontratave për punë	Vlera e parashikuar me Plan të Prokurimit (1)	Buxheti 2020-2022 (2)	Diferenca +/- (2-1)
20	1,065,314.00 €	836,003.00 €	-229,311.00 €

Burimi: Plani i Prokurimit për vitin 2020 për KK Mitrovicë e Jugut dhe Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020

14.3 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë

INPO ka vërejtur se Komuna e Mitrovicës së Jugut deri më 16.10.2020 ka shpallur gjithsej 8 kontrata të prokurimit për vitin 2020 për kategorinë punë, ku vetëm tri (3) prej tyre mund të identifikohen në planifikimin përfundimtar të prokurimit për këtë vit.

Tabela 51. Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë

Nr.	Kontrata	Vlera e parashikuar në plan të prokurimit (1)	Vlera e parashikuar në njoftimin për kontratë (2)	Diferenca +/- (2-1)
1	“Ndertimi i Lapidarit te Martirve'Lagja e Kovaqve'-Mitrovicë”	20,000.00€	20,000.00	0€
2	“Ndërtimi i Qerdhes së fëmijve [P+0] në Shipol-Mitrovicë.”	350,000.00€	350,000.00€	0€
3	“Ndertimi dhe rregullimi i fushave të vogla Sportive.”	127,734.00€	120 000,00€	-7,734€

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim, Komuna e Mitrovicës së Jugut

INPO ka vërejtur se nga tri (3) kontratat e përzgjedhura, dy prej tyre: “Ndertimi i LAPIDARIT te Martirve'Lagja e Kovaqve'-Mitrovicë” dhe “Ndërtimi i Qerdhes së fëmijve [P+0] në Shipol-Mitrovicë” vlerën e mjeteve të parashikuara e kanë identike si në plan të prokurimit ashtu edhe në njoftimin për kontratë. Ndërsa, për kontratën “Ndertimi dhe rregullimi i fushave të vogla Sportive” vërehet dallim i madh sa i përket emërtimit të projektit në planin e prokurimit dhe publikimit në e-prokurim dhe për këtë projekt janë parashikuar mbi 7 mijë euro më pak sipas njoftimit për kontratë krahasuar me planin e prokurimit.

¹⁸ Prej ketyre 20 kontratave për punë, INPO nuk ka arritur t'i identifikojë 13 kontrata të planifikuara ku vlera totale e të cilave 535,260€.

14.4 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim

INPO ka vërejtur se Komuna Mitrovicë e Jugut deri më 16.10.2020 ka shpallur gjithsej 21 kontrata të prokurimit për vitin 2020 për kategorinë furnizime, ku vetëm tri (3) prej tyre mund të identifikohen në planifikimin përfundimtar të prokurimit për këtë vit. INPO ka evidentuar se ekzistojnë ndryshime të konsiderueshme sa i përket aspektit të përcaktimit të njësive/sasive të artikujve të planifikuar si dhe vlerës së parashikuar të mjeteve për këto kontrata/projekte.

Tabela 52. Zbatueshmëria e Planifikimit të Kontratave për Furnizime për Vitin 2020

Planifikimi				Tenderimi		
Kontrata	Njësia	Sasia	Vlera totale	Njësi	Sasia	Vlera totale
“Furnizimi dhe montimi i Serrave te tipit Tunell 50m2 komplet me montim (10X5) -50 copë”	/	/	22,763.00€	Copë	50	27 315,00€
“Furnizim me Bombola me Oksigjen”	Copë	219	3,499.62€	Bombola për oksigjen O2 99 cope X 8.5	841.5 Litër	3,500.00€
				Bombola për oksigjen O2 120 cope për oksigjen 120cope X 3.5 Liter	420 Litër	
“Furnizim me paisje për subvencionimin e fermëve me mekanizëm bujqësorë.”	/	/	24,600.00€	Copë	45	31 980,00€

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim (përshkrimi i çmimeve), Komuna e Mitrovicës së Jugut

Sa i përket vlerës së mjeteve të parashikuara, mund të vërehet se për të tri kontratat/projektet e përzgjedhura vlera e parashikuar në njoftimin për kontratë e tejkalon vlerën e parashikuar me plan të prokurimit, sidomos në rastet e “Furnizimi dhe montimi i Serrave te tipit Tunell 50m2 komplet me montim (10X5) -50 copë” dhe “Furnizim me paisje për subvencionimin e fermëve me mekanizëm bujqësorë” diferenca është mjaft e madhe e gjithashtu për të dyja këto aktivitete Komuna nuk ka bërë planifikim të njësive dhe sasive në Plan të Prokurimit. Për aktivitetin/projektin “Furnizim me Bombola me Oksigjen” vërehet dallim i madh në njësinë e planifikuar pasi me plan të prokurimit njësia e planifikuar është “copë” ndërsa në njoftimin për kontratë njësia e përdorur është “litër” si dhe sasia e planifikuar në njoftimin për kontratë tejkalon sasinë e planifikuar me plan të prokurimit.

14.5 Projektet/aktivitetet që nuk janë të përfshira në buxhet

INPO ka monitoruar nëse të gjitha aktivitetet/projektet e përfshira në planin e prokurimit janë të përfshira edhe në Buxhetin e Kosovës dhe ka gjetur se për Komunën e Mitrovicës së Jugut janë gjithsej 13 aktivitete/projekte që INPO nuk ka mundur t’i identifikoj në Buxhet të Kosovës. Në tabelën 53 janë listuar këto projekte së bashku me vlerën e parashikuar, ku vlera totale e parashikuar për këto projekte sipas Planit të Prokurimit është 535,260 euro.

Tabela 53. Aktivitet/projektet që nuk janë të përfshira në Buxhetin e Republikës së Kosovës

TITULLI I PROJEKTIT	VLERA E PARASHIKUAR NË PLAN TË PROKURIMIT
“Ngritja e pikave grumbulluese për Qumësht -DB”	20,000.00€
“Ngritja e pikave grumbulluese për pemë dhe perime - DB”	8,000.00€
“Ngritja e pikave grumbulluese për bimë mjekësore dhe fruta mali.”	10,000.00€
“Ngritja e Lapidarit për Martirve të kombit-Lagja e Kovaqve”	20,000.00€
“Riparimi i LLaminatit ,zyreve,koridoreve dhe lysterja e tyre-QPS.”	2,500.00€
“Renovimi i banjove në Objektin e Komunës-D.AD”	20,000.00€
“Rregullimi i zyreve dhe vendosja e kamerave në Objektin e Komunës. -D.ADM”	15,000.00€
“Rregullimi i Zyreve dhe furnizimi me Inventar(Arka,Arka Financiare dhe Zyra e Tatimit në Pronë)-DBF”	28,750.00€
“Vendosja e shkallve emergjente nëpër objekte shkollore”	37,010.00€
“Rregullimi i Binës(8X10,6X6 dhe 4X6) dhe zërimi për aktivitete të ndryshme gjatë vitit.”	5,000.00€
“Rregullimi i banjove në objektin e DKRS dhe titucione tjera”	4,000.00€
“Dekorimi i Sheshit për festa të fundvitit”	15,000.00€
“Ndertimi i Objektit të Qerdhës së Femijve në Shipol.”	350,000.00€

Burimi: Plani i Prokurimit për vitin 2020 për Komunën e Mitrovicës së Jugut

Një prej problemeve të identifikuar është edhe mospërputhja në përshkrimin ose emërtimin e aktiviteteve/projekteve, më konkretisht dallimi në përshkrimin e tyre në Plan të Prokurimit dhe në Ligjin për Buxhet, ku për Komunën e Mitrovicës së Jugut INPO ka gjetur se ekzistojnë 3 aktivitete/projekte, emërtimi i të cilave dallon në Plan të Prokurimit krahasuar me Ligjin për Buxhet.

Tabela 54. Ndryshimi në emërtimin e projekteve sipas Planit të Prokurimit krahasuar me emërtimin sipas Ligjit për Buxhet

PLANIFIKIMI I PROKURIMIT	LIGJI PËR BUXHET
“Rregullimi i nyjeve sanitare sistemit të ujit nëpër shkollë-D.ARS”	“Rregullimi i nyjeve sanitare në shkollë fillore dhe të mesme”
“Renovimi i kuzhinave shkollore dhe furnizimi i tyre me pajisje adekuate-D.ARS”	“Pajisje për kuzhinë”
“Rregullimi i oborreve dhe fushave sportive nëpër shkollë”	“Rregullimi i oborreve dhe fushave sportive”

Burimi: Plani i Prokurimit për vitin 2020 për Komunën e Mitrovicës së Jugut, Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020

15. MITROVICË E VERIUT

15.1 Pasqyrë e planifikimit të prokurimit 2020

Komuna e Mitrovicës së Veriut ka planifikuar që në vitin 2020 të zhvilloj gjithsej 39 aktivitete/projekte për prokurim publik, ku 23 kontrata janë për furnizime me një vlerë totale prej 1,010,999.01€, pesë (5) kontrata për shërbime me vlerë 28,104.19€ dhe 11 kontrata për punë me vlerë 1,438,408.00€. Komuna ka planifikuar gjithsej 39 aktivitete me vlerë totale 2,477,511.20€.

Tabela 55: Planifikimi i prokurimit 2020, Komuna e Mitrovicës së Veriut.

Lloji i kontratës	Numri i kontratave	Vlera e kontratës
Furnizime	23	1,010,999.01€
Shërbime	5	28,104.19€
Punë	11	1,438,408.00€
Konkurs projektimi	/	/

Burimi: Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit 2020 për komunën e Mitrovicës së Veriut, e-prokurim

Komuna e Mitrovicës së Veriut ka dështuar që t'i përmbushë kërkesat e nenit 8 të LPP-së, respektivisht në AQP e ka dërguar planifikimin paraprak dhe jo atë përfundimtar, kjo argumentohet me atë se data kur planifikimi është dërguar në AQP është 20.01.2020, ndërsa Ligji për buxhetin ka hyr në fuqi më 19.03.2020.¹⁹ Gjithashtu, Komuna e Mitrovicës së Veriut në planifikim nuk ka saktësuar datën e parashikuar të fillimit të prokurimit, gjë që përveç mosrespektimit të kërkesave ligjore, kjo mangësi mund të rezultojë edhe me keq-menaxhim dhe pasoja tjera negative për autoritetin kontraktues.

15.2 Kontratat e planifikuara për punë dhe buxheti

Komuna e Mitrovicës së Veriut për vitin 2020 ka planifikuar gjithsej 11 kontrata për punë. Të bashkangjitura në tabelë janë të dhënat lidhur me vlerën e parashikuar të projekteve dhe kapacitetet buxhetore për zhvillimin e tyre.

Tabela 56: Numri i kontratave të planifikuara për punë dhe buxheti.

Numri i kontratave	Vlera e parashikuar në planifikim (1)	Buxheti 2020-2022 (2)	Diferenca +/- (2-1)
11	1,438,408.00€	1,670,056.00€	+231,648.00€

Burimi: Plani i Prokurimit për vitin 2020 për Komuna e Mitrovicës së Veriut dhe Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020

Nga të dhënat në tabelën më lartë, vërejmë se për zhvillimin e 11 projekteve të planifikuara Komuna e Mitrovicës së Veriut ka planifikuar 1,438,408.00€. INPO ka hulumtuar edhe kapacitetet buxhetore të komunës për vitin 2020-2022 dhe rezulton që komuna ka 1,670,056.00€. Në shikim të parë mund të konceptohet që komuna ka bërë një planifikim të mirë meqë vlerat e parashikuara dhe kapacitetet buxhetore janë identike, në fakt komuna në këtë planifikim ka bërë vetëm një lëshim. Projekti “Rindertimi i infrastruktures rrugore te rrugës Kralja Petra I nga rrethrotullimi deri ne Zvečan - rindertimi i trotoreve, pjese e rrjetit sekondar te furnizimit me uje, rrjeti i kanalizimeve, ndriqimi publik” është projekt dy vjeçar ndërsa në planifikim nuk është identifikuar si i tillë, mirëpo në buxhet figuron si projekt dy-vjeçar dhe komuna nuk ka vendosur në planifikim vlerën totale të projektit që është 931,873.00€, por vetëm shumën që do të paguhet nga buxheti i vitit 2020, respektivisht 700,225.00€. Pra, Komuna e Mitrovicës së Veriut ka dështuar që tek kontratat për punë në një rast

¹⁹ Për më shumë shih, neni 8 paragraf 2 i Ligjit nr. 04/I-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

të mos zbatoj kërkesat e planifikimit, respektivisht, në vend të që planifikohet vlera totale e projektit është parashikuar vetëm vlera për vitin 2020, në rastet tjera kapacitetet buxhetore janë identike me parashikimet e komunës.

15.3 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë

INPO ka analizuar edhe respektimin e planifikimit të prokurimit nga ana e Komunës së Mitrovicës së Veriut, respektivisht ka monitoruar vlerën e parashikuar të projektit në planifikim të prokurimit dhe vlerën e parashikuar në njoftimin për kontratë.

Tabela 57: Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë.

Nr.	Emri i kontratës	Vlera në Plan të Prokurimit (1)	Vlera njoftim për kontratë (2)	Diferenca +/- (2-1)
1.	“Rinovimi i tualeteve në Shkollën e Mesme Teknike Mihajlo Petrović Alas në Mitrovicën Veri”	50,000.00€	50,000.00€	0€
2.	“Rinovimi i çatisë dhe rinovimi i dyshemesë së gjimnazit në Shkollën Fillore Branko Radicevic në Mitrovicën e Veriut”	60,000.00€	80,000.00€	+20,000.00€
3.	“Rindërtimi i rrjetit të ngrohjes me elementë ngrohës në shkollën fillore Branko Radicevic”	50,000.00€	50,000.00€	0€
4	“Rinovimi i mureve dhe tavaneve të korridorit në shkollën e mesme teknike të mesme Mihailo Petrović në Mitrovicën e Veriut”	90,000.00€	90,000.00€	0€
5.	“Rinovimi i terreneve sportive dhe peizazhit në Shkollën Fillore Branko Radicevic në Mitrovicën e Veriut”	86,183.00€	86,183.00€	0€

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim, Komuna e Mitrovicës së Veriut

Nga të dhënat në tabelë, vërejmë se nga pesë (5) aktivitete të testuara, vetëm një (1) ka kaluar vlerën e parashikuar, respektivisht në planifikim të prokurimit vlera e parashikuar ka qenë 60,000.00€, ndërsa në njoftimin për kontratë 80,000.00€, do të thotë 20,000.00€ më shumë. Pas komenteve të dhëna nga Komuna e Mitrovicës së Veriut, lidhur me këtë çështje të njëjtit janë sqaruar se bëhet fjalë për bashkim të dy projekteve: “Rinovimi i qatise së gjimnazit në shkollën fillore Branko Radicevic” 60,000.00€ dhe “Rinovimi i dyshemesë së palestres në shkollën fillore Branko Radičević” 20,000.00€.

15.4 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim

Planifikimet për furnizime që ka bërë Komuna e Mitrovicës së Veriut për vitin 2020 marrin një buxhet të konsiderueshëm prej 1,010,999.01€. INPO ka analizuar atë se sa po respektohet planifikimi i prokurimit për furnizime, respektivisht gjatë njoftimit për kontratë për furnizim komuna a po i qëndron prapa planifikimit. Të gjeturat dëshmojnë që asnjë kontratë e prokurimit për furnizime që ka iniciuar komuna në këtë vit, nuk mund të identifikohet në planifikim²⁰. Komuna ka zhvilluar me

²⁰ Shënim: Monitorimi përshtet periudhën deri më 15 tetor 2020.

dhjetra aktivitete për furnizim dhe asnjëra nuk përshtatet me planifikimin gjë që dëshmon për dobësi të thekuar në planifikim dhe që mund të rezultoj me pasoja për Autoritetin Kontraktues²¹.

Gjithashtu, Komuna e Mitrovicës së Veriut në planifikimin e prokurimit të dorëzuar në AQP, tek kategoria e furnizimeve nuk ka plotësuar datën e parashikimit të fillimit të prokurimit, artikujt sasitë dhe çmimin për njësi, gjë që është në kundërshtim me kërkesat ligjore të përmendura më lart lidhur me një planifikim profesional të prokurimit publik.

16. PEJË

16.1 Pasqyrë e planifikimit të prokurimit 2020

Komuna e Pejës sipas planit të prokurimit për vitin fiskal 2020 ka planifikuar të zhvillojë 115 aktivitete të prokurimit. Komuna ka planifikuar që gjatë këtij viti të realizojë më së shumti kontrata për punë 74, pasuar me kontratat për furnizim 26 dhe kontratat për shërbime 13. Rrjedhimisht, vlera më e madhe e mjeteve që Komuna planifikon të shpenzojë gjatë këtij viti është për kontratat për punë me 5,042,536.90€, pastaj për kontratat për furnizim me 996,000.50€ si dhe 277,000.00€ komuna ka planifikuar t'i shpenzojë për kontratat për shërbime. Sipas Planit të Prokurimit, Komuna e Pejës ka planifikuar që gjatë vitit 2020 të realizojë edhe dy (2) kontrata për konkurs të projektimit, vlera e të cilave arrinë në 65,000.00€.

Tabela 58. Planifikimi i prokurimit për vitin 2020, Komuna e Pejës

Lloji i kontratave	Numri i kontratave	Vlera totale
Furnizim	26	996,000.50€
Shërbime	13	277,000.00€
Punë	74	5,042,536.90€
Konkurse të Projektimit	2	65,000.00€

Burimi: Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit 2020 për Komuna e Pejës i publikuar në platformën e-prokurimi

16.2 Kontratat e planifikuara për punë dhe buxheti

Numri total i kontratave për punë që Komuna e Pejës ka planifikuar të realizojë gjatë vitit 2020 është 74. 49 projekte INPO nuk ka arritur ti identifikoj në buxhetin e Kosovës kështu që janë kërkuar sqarime nga zyra e financave në Pejë, dhe të njëjtit sqarojnë se projektet e tilla janë të fuzionuara/bashkuara siç janë projektet: “Participim me projektin DEMOS”, “Riogazinim i zyreve”, “Ndërtimi i rrugve të reja në Qytet”, etj., duke na i derguar kodet të cilat me pastaj identifikohen se aty ka mjete të ndara edhe për ato projekte.

Rrjedhimisht, numri i projekteve të planifikuara (74), praktikisht është më i lartë pasi komuna ka shpallur kontrata të ndara në lot-e për artikuj të paraqitur në plan të prokurimi si për shembull, është planifikuar kontrata “Renovime të Shkollave” dhe në kuadër të saj hyjnë disa lot-e “Renovimi dhe ndërtimi i shkollave në Komunën e Pejës LOT 1 - Renovimi i shkollave “ Lidhja e Prizrenit ”, “ Dardani ” dhe “ Xhemaj Kada” LOT 2 - Ndërtimi i aneksit të shkollës “ Smajl Hajdari ” LOT 3 - Renovimi i shkollës “ 7 Shtatori”, në fshatin Vitomeric LOT 4 - Renovimi i shkollave “ Rilindja ”, “ Ali Kelmendi ” ,dhe “ 28 Nëntori” si dhe rregullimi i oborit të SH.F.M.U “Rilindja” në fshatin Lutogllav dhe në shkollën në fshatin Leshanë LOT 5 - Renovimi i shkollave “Skender Çeku ”, “ 2 Koriku ” ,dhe “ 8 Marsi”, të cilat më pastaj mund të rezultojnë si kontrata të veçanta për secilin lot dhe kjo e rritë

²¹ Neni 8, paragrafi 1 lidhur me nënparagrafin 1 të Ligjit nr. 04/l-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, gjithashtu shih dhe neni 5, paragrafi 4 i RrUOPP-it.

numrin e përgjithshëm të kontratave të planifikuara, ndarjet e tilla mundësojnë që edhe operatorët ekonomik me kapacitet më të vogla të konkurojnë. Megjithatë, plani i prokurimit, te kjo kategori nuk është plotësuar sipas kërkesave ligjore të cilat parashohin që planifikimi duhet të përmbajë edhe detajet e nevojshme për kontratat që parashihen të prokurohen. Sipas Planit të Prokurimit të publikuar nga komuna janë të plotësuar vetëm përshkrimi i kontratës (titulli i kontratës), data e parashikuar e fillimit të prokurimit dhe vlera e parashikuar.

Tabela 59. Numri i Kontratave të Planifikuara sipas Planit të Prokurimit dhe Buxhetit të Republikës së Kosovës

Numri total i kontratave për punë	Vlera e parashikuar me Plan të Prokurimit (1)	Buxheti 2020-2022 (2)	Diferenca +/- (2-1)
74	€ 5,042,536.90	€ 14,650,000.00	€ +9,607,463.10

Burimi: Plani i Prokurimit për vitin 2020 për KK Pejë, Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020

Gjatë monitorimit të kontratave të përfshira në plan të prokurimit dhe atyre në Buxhetin e Kosovës, INPO ka vërejtur se ekziston një dallim i konsiderueshëm në këto dy dokumente sa i përket vlerës së parashikuar të mjeteve të planifikuara për kontratat për punë për vitin 2020. Ndërsa, në total për tri (3) vite INPO ka identifikuar 14,650,000.00€. Po ashtu, edhe te Komuna e Pejës mungon përshkrimi nëse kontratat janë shumë-vjeçare.

16.3 ZBATUESHMËRIA E PLANIFIKIMIT TË KONTRATAVE PËR PUNË

Gjatë monitorimit të planifikimit të prokurimit për Komunën e Pejës, INPO ka monitoruar zbatueshmërinë e planifikimit të prokurimit të pesë (5) kontratave për punë.

Tabela 60. Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë

Nr.	Kontrata	Vlera e parashikuar në plan të prokurimit (1)	Vlera e parashikuar në njoftimin për kontratë (2)	Diferenca +/- (2-1)
1	“Ndërtimi i katër urave mbi shtratin e lumit ‘ Lumbardh në Pejë ‘”	150,000.00€	150,000.00€	0€
2	“Ndërtimi i shkollës së Artit Faza Finale”	80,000.00€	102,967.00€	+22,967.00€
3	“Ndërtimi i murreve mbrojtëse në Bogë pjesa e dytë”	35,000.00€	30,003.00€	-4,997.00€
4	“Ndërtimi i praxheve në rrjedhjen e Lumbardhit”	60,000.00€	60,182.80€	+182.80€
5	“Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në fshatrat të Komunës së Pejës Pjesa II”	60,000.00€	81,203.56€	+21,203.56€

Burimi: Plani i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim, Komuna e Pejës

INPO ka vërejtur se nga pesë (5) kontratat/projektet e përzgjedhura vetëm për njërin prej tyre (“Ndërtimi i katër urave mbi shtratin e lumit ‘ Lumbardh në Pejë ‘”) vlera e parashikuar në njoftimin për kontratë është e njëjtë me vlerën e parashikuar sipas planit të prokurimit. Për kontratën: “Ndërtimi i shkollës së Artit Faza Finale”, “Ndërtimi i praxheve në rrjedhjen e Lumbardhit” dhe “Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në fshatrat të Komunës së Pejës Pjesa II” vlera e parashikuar sipas

njoftimit për kontratë e tejkalon vlerën e parashikuar me plan të prokurimit. Ndërsa, për kontratën “Ndërtimi i murreve mbrojtëse në Bogë pjesa e dytë” vlera e parashikuar në njoftimin për kontratë është më e vogël krahasuar me vlerën e parashikuar sipas planit të prokurimit.

16.4 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim

INPO ka monitoruar edhe pesë (5) kontrata për furnizim, duke bërë krahasimin e vlerës së paraqitur në planifikim të prokurimit me vlerën e paraqitur në njoftimin për kontratë të publikuar në e-prokurim.

Tabela 61. Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim

Planifikimi				Tenderimi		
Kontrata	Njësia	Sasia	Vlera totale	Njësi	Sasia	Vlera totale
“Furnizim me lënd djegëse - dru për ngrohjen e institucioneve arsimore”	/	/	€ 180,000.00	m²	3829.8	€180 000,00
“Blerja e paisjeve sportive për Sallat e Sportit në Shkollat e Komunës së Pejës”	/	/	€ 40,000.00	Copë	288	€ 37,440.00
“Blerja dhe montimi i ashensorit në QKMF”	/	/	€ 30,000.00	ASHENSOR PËR PERSONA Punimet e	1 Copë	€ 38,000.00
				vrazhda, Bartja, vendosja dhe montimi i ashensorit me standarde përkatëse.	1 M’	
“Furnizim me aparat dhe paisje mjeksore LOT 1 - Furnizimi me paisje mjeksore LOT 2 - Furnizim me paisje mjeksore Autoklav për QKMF- në Pejë”	/	/	€ 20,000.00	LOT 1 - Furnizimi me paisje mjeksore	315 copë	€ 26,440.00
				LOT 2 - Furnizim me paisje mjeksore Autoklav për QKMF- në Pejë	1 copë	
“Furnizim me artikuj ushqimor	/	/	€ 100,000.50	Litër kg	11700 89700	€ 100,000.00

të domosdoshem për familjet me nevoj mer rastin e shfaqjes së pandemis COVID -1”				Copë	3900	
--	--	--	--	------	------	--

Burimi: Plani i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim, Komuna e Pejës

INPO ka vërejtur se nga 5 kontratat e monitoruara, për dy (2) prej tyre “Furnizim me lënd djegëse - dru për ngrohjen e institucioneve arsimore” dhe “Furnizim me artikuj ushqimor të domosdoshem për familjet me nevoj mer rastin e shfaqjes së pandemis COVID -1”) vlera e parashikuar në njoftimin për kontratë është e njëjtë me vlerën e parashikuar sipas planit të prokurimit. Për kontratën: “Blerja dhe montimi i ashensorit në QKMF” dhe “Furnizim me aparat dhe paisje mjeksore LOT 1 - Furnizimi me paisje mjeksore LOT 2 - Furnizim me paisje mjeksore Autoklav për QKMF- në Pejë” vlera e parashikuar sipas njoftimit për kontratë e tejkalon vlerën e parashikuar me plan të prokurimit. Ndërsa, për kontratën “Blerja e paisjeve sportive për Sallat e Sportit në Shkollat e Komunës së Pejës” vlera e parashikuar në njoftimin për kontratë është më e vogël krahasuar me vlerën e parashikuar sipas planit të Prokurimit. INPO ka evidentuar se për asnjërën nga kontratat e monitoruara nuk është bërë planifikimi i njësive dhe sasive të artikujve të planifikuar për furnizim në planin e prokurimit.

16.5 Projektet/ kontratat që nuk janë të identifikuara në buxhet

INPO ka analizuar nëse të gjitha kontratat/projektet e përfshira në planin e prokurimit janë të përfshira edhe në Buxhetin e Kosovës dhe ka gjetur se për Komunën e Pejës është vetëm një projekt që nuk identifikohet në buxhet me emrin e njëjtë.

Tabela 62. Aktivitet/projektet që nuk janë identifikuara në Buxhetin e Republikës së Kosovës

TITULLI I PROJEKTIT	VLERA E PARASHIKUAR NË PLAN TË PROKURIMIT
“Toaletet ne Drejtoratin e Arsimit”	15,000.00€
“Rregullimi i Varrezave të martirëve pjesa e dytë”	5,000.00€

Burimi: Plani i Prokurimit për vitin 2020 për Komunën e Pejës

Një prej problemeve të identifikuara është edhe mospërputhja në përshkrimin ose emërtimin e kontratave/projekteve, më konkretisht dallimi në përshkrimin e tyre në plan të prokurimit dhe në Ligjin për Buxhet, ku për Komunën e Pejës INPO ka gjetur se janë 6 kontrata/projekte, emërtimi i të cilave dallon në Plan të Prokurimit krahasuar me Buxhetin e Republikës së Kosovës (shih tabelën 6).

Tabela 63. Ndryshimi në emërtimin e aktiviteteve/projekteve sipas Planit të Prokurimit krahasuar me emërtimin sipas Ligjit për Buxhet

PLANIFIKIMI I PROKURIMIT	LIGJI PËR BUXHET
“Ndertimi i Pendës ne Dardanine 3 me kanale”	“Ndertimi i pendave”
“Renovimi i Teatrit në Komunën e Pejës”	“Renovimi i Muzeut dhe Teatrit”
“Ndertimi i Shkolles se Artit faza FINALE”	“Ndërtimi i i shkollës së Artit faza e dytë”
“Ndertimi i kanale te ujitjes ne Fshatrat e Komunes se Pejes I”	“Punimi i kanaleve te ujitjes”
“Ndertimi i kanale te ujitjes ne Fshatrat e Komunes se Pejes II”	“Punimi i Kanaleve të Ujitjes”
“Gjelbrimi ne Hyrjen e Qytetit”	“Gjelbrimi i qytetit”

Burimi: Plani i Prokurimit për vitin 2020 për Komuna e Pejës, Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020

Përveç këtyre, ekziston edhe një dallim tjetër tek kontratat/projektet në mes të Planit të Prokurimit dhe Buxhetit të Kosovës, ku në rastin e Pejës janë disa projekte të cilat në planin e prokurimit figurojnë si të ndara (në faza), por që në Ligjin për Buxhet janë përmbledhur si një projekt i vetëm.

Tabela 64. Ndarja e aktiviteteve/projekteve në faza

PLANIFIKIMI I PROKURIMIT	LIGJI PËR BUXHET
“Ndertimi i Kanalizimit ne Qytet dhe Fshatra I”	“Kanalizime në qytet dhe fshatra”
“Ndertimi i Kanalizimit ne Qytet dhe Fshatra II”	
“Ndertimi i Kanalizimit ne Qytet dhe Fshatra III”	
“Ndertimi i mureve mbrojtese në lagjen Kapeshnicë”	“Ndërtimi i mureve mbrojtëse ”
“Ndertimi i mureve mbrojtese në fshatin Boge”	
“Rregullimi i ures në fshatin Ruhot”	“Ndërtimi i urave”
“Rregullimi i urave në fshatrat Berliq,Rosuj”	
“Rregullimi i urave në Fidanisht dhe Katundi Ri”	

Burimi: Plani i Prokurimit për vitin 2020 për Komunën e Pejës, Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020

17. PODUJEVË

17.1 Pasqyrë e planifikimit të prokurimit 2020

Komuna e Podujevës në planifikimin e saj për vitin fiskal 2020 ka planifikuar të zhvilloj 145 aktivitete të prokurimit, prej tyre më së shumti ka planifikuar të zhvilloj për kategorinë punë 65, pastaj të tjerat për kategoritë furnizim dhe shërbime, ndërsa për kategorin konkurs projektimi nuk ka planifikuar asnjë aktivitet/projekt. Vlera totale e të gjitha aktiviteteve/projekteve të planifikuara është 6,118,589.00€. Ky planifikim është publikuar në ueb-faqe të komunës me 14.04.2020 dhe në e-prokurim me 02.04.2020.

Tabela 65. Planifikimi i prokurimit për vitin 2020, Komuna e Podujevës

Lloji i kontratave	Numri i kontratave	Vlera totale
Furnizim	46	1,262,850.00€
Shërbime	34	774,146.00€
Punë	65	4,081,593.00€
Konkurse të Projektimit	/	/

Burimi: Planifikimi i prokurimit e-prokurim, Komuna e Podujevës

17.2 Kontratat e planifikuara për punë dhe buxheti

Bazuar në planifikimin e prokurimit Komuna e Podujevës siç edhe e elaboruam edhe më lartë ka planifikuar më së shumti kontrata/projekte për kategorinë punë 65 dhe në vlerë totale 4,081,593.00€, kjo kategori nuk është plotësuar sipas kërkesave ligjore. Për më tepër, për këtë kategori do të thotë për projektet punë/investimve kapitale të parapara në planifikim dhe projektet e njëjta krahasur me ligjin mbi ndarjet buxhetore të miratuar në mars 2020, kemi një diferencë prej

+4,585,698.00€²². Te ky krahasim nuk kemi arritur te gjejmë pesë (5) projekte të cilat janë në planifikim por, nuk mund të gjindet në buxhet më të njëjtin emer, për më tepër *shih tabelën 69*.

Tabela 66. Numri I Kontratave të Planifikuara në Plan të Prokurimit dhe Buxhet të Republikës së Kosovës

Numri total i kontratave për punë	Vlera e parashikuar me Plan të Prokurimit (1)	Buxheti 2020-2022 (2)	Diferenca +/- (2-1)
65	4,081,593.00€	8,667,291.00€	+4,585,698.00€

Burimi: Planifikimi i prokurimit e-prokurim, Ligji Nr. 071-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2020.

17.3 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë

Nga 65 kontrata/ projekte sa i ka komuna të planifikuara, INPO ka zgjedhur pesë (5) projekte dhe ka krahasuar vlerën e paraqitur në planifikim të prokurimit dhe vlerën e paraqitur në njoftimin për kontratë të publikuar në e-prokurim, nga të pesë (5) kontrata/ projektet vërejmë se vetëm njëra (“Ndërtimi i fushave sportive në disa shkolla”) ka vlerë identike. Të katër (4) kontratat tjera kanë vlerë më të lartë në njoftimin për kontratë krahasuar më parashikim në planifikim të prokurimit. Për më tepër kontrata/ projekti “Meremetimi i rrugëve me zhavor”, ka një diferencë prej 210,655.46€ me shumë në njoftimin për kontratë.

Tabela 67. Zbatueshmëria e Planifikimit të Kontratave për Punë për vitin 2020

Nr.	Kontrata	Vlera e parashikuar në plan të prokurimit (1)	Vlera e parashikuar në njoftimin për kontratë (2)	Diferenca +/- (2-1)
1	“Rregullimi i infrastrukturës së varrezave”	90,000.00€	94,274.00€	+4,274€
2	“Meremetimi i rrugëve me zhavor” ²³	115,000.00€	325,655.46€	+210,655.46€
3	“Ndërtimi i fushave sportive në disa shkolla”	30,000.00€	30,000.00€	0€
4	“Ndërtimi i urës në Lupç i Poshtëm (lagjja Pireva)” ²⁴	75,000.00€	140,313.00€	+65,313€
5	“Asfaltimi i rrugëve në fshatin Majac”	50,000.00€	56,151.30€	+6,151.3€

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim Komuna e Podujevës

²² INPO, ka identifikuar që në Ligjin mbi ndarjet buxhetore ka mjete të ndara edhe për vitet e ardhshme, por që në planifikim mungon përshkrimi se cilat kontrata janë dy apo më shumë vjeçare.

²³ Komuna deklaron: se kjo kontratë është dy-vjeçare dhe për këtë vit janë të planifikuara 115,000€, ndersa pjesë tjetër do të shpenzohen vitin e ardhshëm, megjithatë një gjë e tillë nuk është e paraqitur në plan të prokurimit.

²⁴ Edhe te kjo kontratë komuna deklaron se 75,000€ janë nga komuna, ndersa 40,000€ do të jenë nga MZHR, por që as kjo nuk identifikohet në plan të prokurimit.

17.4 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim

Nga gjithsej 46 kontrata për kategorinë furnizim sa ka të planifikuara komuna. INPO, ka përzgjedhur pesë (5) kontrata për furnizim, ashtu siç kemi vepruar edhe në rastet tjera. Në dy (2) tendere komuna ka vepruar saktësishtë siç ka planifikuar në plan të prokurimit të njëtat vlera i ka edhe në përshkrimi të çmimeve në e-prokurim. Për tenderin “Blerja e makinave per pastrim dysHEMEJE dhe makina per prerje bari”, komuna nga 10,000.00€ të planifikuara në plan të prokurimit, në iniciimin në e-prokurim ka rritur vlerën në 26,883.00€, por këtu për dallim nga plani I prokurimit I ka të specifikuara edhe sasi të dhe njësit. Ngjajshem ka vepruar edhe me dy tenderat e tjera “Furnizim me pelet” dhe “Furnizim me sistem të ujitjes pikë - pikë dhe pajisje tjera për kultivimin e mjedres dhe specit”.

Tabela 68. Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim

Planifikimi				Tenderimi		
Kontrata	Njësia	Sasia	Vlera totale	Njësi	Sasia	Vlera totale
“Pajisje për nxemje nga energjia solare”	/	/	50,000.00€	LS	4	50,000.00€
				Pc	251	
				m	2100	
“Blerja e makinave per pastrim dysHEMEJE dhe makina per prerje bari”	/	/	10,000.00€	Makina profesionale për pastrim të dyshemesë	7 copë	26,883.00€
				Kositëse të barit për lëndina-oborre ²⁵	6 copë	
“Furnizim me një autoambulancë me pajisje reanimimi për nevoja të QKMF-së” ²⁶	/	/	60,000.00€	/	/	60,000.00€
“Furnizim me pelet”	/	/	30,000.00€	Ton	622	120,940.00€
“Furnizim me sistem të ujitjes pikë - pikë dhe pajisje tjera për kultivimin e mjedres dhe specit”	/	/	36,350.00€	Copë	7272	39,409.64€
				m	198000	

²⁵ Komuna deklaron se për shkak të kërkesës së madhe e ka rritur vlerën dhe sasin si dhe kanë pasur mjete në dispozicion për një gjë të tillë.

²⁶ Kontratë dy-vjeçare.

17.5 Kontratat që nuk janë të përfshira në buxhet

INPO, ka hulumtur për të parë nëse janë përfshirë të gjitha aktivitetet e planifikuara nga ana e komunës në ligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin 2020, dhe këtu nuk kemi arritur të identifikojmë pesë (5) projekte në buxhet të Kosovës.

Tabela 69. Lista e projekteve që nuk janë të përfshira në Buxhetin e Kosovës 2020

TITULLI I PROJEKTIT	VLERA E PARASHIKUAR NË PLAN TË PROKURIMIT
“Ndërtimi, shtimi, rritja dhe mirëmbajtja (në pronën publike të qytetit) e parqeve, hapësirave të reja të gjelbëruara, kopshteve të hapura me lodra për fëmijë etj”	40,000.00€
“Ndërtimi i trotuareve (qytet, Gllamnik - vazhdimi, Sfeqël - vazhdimi, Gërdofc, Llugë - vazhdimi, rruga regjionale POdujevë Shajkofc - vazhdimi, Shakovcë, Bellopojë, Bajqinë, Letanc- vazhdimi, Konushefc, Katunishtë” ²⁷	155,000.00€
“Rregullimi i infrastrukturës përcjellëse - ambientit të AMF, QMF dhe QKMF” ²⁸	30,000.00€
“Mirëmbajtja e objekteve shëndetësore” ²⁹	35,000.00€
“Ndërtimi i një objekti shkollor në Balofc” ³⁰	150,000.00€

Tabela 70. Ndryshimi në emërtimin e projekteve sipas Planit të Prokurimit krahasuar me emërtimin sipas Ligjit për Buxhet

PLANIFIKIMI I PROKURIMIT	LIGJI PËR BUXHET
“Ndërtimi i ndricimit publik (qytet, Letanc, Peran, Bajqinë, Surkish, Dumnicë, Obranqë, Sfeqël, Shakovicë etj)”	“Ndërtimi, rindërtimi i ndriçimit publik”
“Ndërtimi i urës në Lupç i Poshtëm - lagjja Pireva”	“Ndërtimi i urave në Siboc (l .Rrahmani) dhe Lupq”
“Ndërtimi i fushave të hapura sportive”	“Ndërtimi i fushave të hapura sportive nëpër fshatra”

²⁷ Sipas zyrës së prokurimi është projekt i nga viti i kaluar, kjo vlerë përfshin planifikimin 2019 dhe 2020.

²⁸ Komuna deklaron se ky projekt financohet nga kategoria mallra dhe shërbime.

²⁹ Po ashtu, edhe për këtë kontratë deklaron se financohet nga kategoria mallra dhe shërbime.

³⁰ Nga te hyrat vetanake.

18. PRISHTINË

18.1 Pasqyrë e planifikimit të prokurimit 2020

Komuna e Prishtinës në planifikimin e prokurimit për vitin 2020 ka planifikuar, të zhvilloj gjithsej 205 aktivitete të prokurimit për vitin fiskal 2020, ky planifikim u publikua në e-prokurim me 02.04.2020 dhe i njëjti është i publikuar edhe ueb-faqe të komunës. Prej këtyre aktiviteteve komuna planifikon të realizoj 88 aktivitete për punë për vitin 2020, ku vlera e përgjithshme e tyre arrin 26,414,538.71€, kategoria e dytë me më së shumti projekte/aktivitete është kategoria furnizim, ku sipas planit të prokurimit janë të parapara 66 aktivitete/ projekte të cilat janë parashikuar të kenë vlerë 5,651,733.00€. Pjesa tjetër e planifikimit është për kategorin e shërbimeve ku janë parashikuara 43 aktivitete/projekte dhe vlera e të cilave arrin parashikimin prej 4,360,150.00€. Ndërsa, për kategorin konkurse projektimi komuna ka parashikuar tetë (8) aktivitete/projekte për vitin fiskal 2020.

Tabela 71. Planifikimi i prokurimit për vitin 2020, Komuna e Prishtinës

PASQYRË E PLANIFIKIMIT 2020		
Lloji i kontratës	Numri i kontratave	Vlera e kontratës
Furnizime	66	5,651,733.00€
Shërbime	43	4,360,150.00€
Punë	88	26,414,538.71€
Konkurs projektimi	8	590,000.00€

Burimi: Planifikimi i prokurimit e-prokurim, Komuna e Prishtinës

18.2 Kontratat e planifikuara për punë dhe buxheti

Komuna e Prishtinës në planifikimin e saj të prokurimit ka paraparë të zhvilloj 88 kontrata/projekte për kategorin punë, në bazë të planifikimit të prokurimit vlerësohet si kategoria më me së shumti kontrata/projekte që do të zhvillohen, bazuar në planifikim kjo kategori nuk është plotësuar sipas kërkesave.

Për më tepër, për këtë kategori për projektet punë/investimve kapitale të parapara në planifikim dhe projektet e njëjta krahasur me ligjin mbi ndarjet buxhetor 2020 të miratuar në mars 2020, INPO ka kërkuar sqarime pasi që një pjesë e konsiderushme rreth 25 projekte janë të vendosura në dy kode dhe si të tilla ka qënë vështirë të identifikohen se sa mjete janë ndarë për secilin projekt dhe pas sqarimeve nga zyra e prokurimit, kemi katër (4) projekte të cilat nuk identifikohen në buxhet (shih tabelën 75) dhe katër (4) projektet (“Rregullimi I rrugeve dhe infrastruktures ne ruget te trafoja”, “Rregullimi I varrezave te deshmoreve ne Viti te Marecit”, “Ndertimi I rruges nga Flotacioni, lagja Vakoc” dhe “Rigjenerimi i rrugës Mehmet Kaçurri (Rruga Model) - Prishtinë”) projektet të bartura nga viti paraprak/2019.

Tabela 72. Numri i Kontratave të Planifikuara në Plan të Prokurimit dhe Buxhet të Republikës së Kosovës

NUMRI I KONTRATAVE TË PLANIFIKUARA PËR PUNË DHE BUXHETI			
Numri i kontratave në planifikim të prokurimit	Vlera e parashikuar në planifikim (1)	Buxheti 2020-2022 (2)	Diferenca +/- (2-1)
88	26,414,538.71€	66,935,000.00€	+40,520,461.29€

Burimi: Planifikimi i prokurimit e-prokurim, Ligji Nr. 071-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2020.

18.3 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë

Nga 88 kontrata sa i ka planifikuar Komuna e Prishtinës për planifikim INPO ka monitoruar pesë (5) kontrata të planifikuara me prokurim. Nga ky monitorim vërejmë se Komuna në katër (4) kontrata kishte vepruar saktësisht siç edhe kishte planifikuar paraprakisht, do të thotë kishte vlerë të njejtë edhe në planifikim të prokurimit edhe në njoftimin për kontratë të cilin e publikon në e-prokurim, në kontratën “Ndërtimi i lapidarit në Prapashticë për deshmoret e vitit 1921”, ka rritur vlerën e parashikur në njoftim për kontratë për 115,000.00€.

Tabela 73. Zbatueshmëria e Planifikimit të Kontratave për Punë për vitin 2020

ZBATUESHMËRIA E PLANIFIKIMIT TË KONTRATAVE PËR PUNË				
Nr.	Emri i kontratës	Vlera në Planifikim të prokurimit (1)	Vlera në njoftim për kontratë (2)	Diferenca +/- (2-1)
1.	“Ndërtimi i ashensorit në objektin e vjetër të Komunës”.	80,000.00€	80,000.00€	/
2.	“Ndërtimi i lapidarit në Prapashticë për deshmoret e vitit 1921”	60,000.00€	175,000,00€	115,000€
3.	“Toaletet publike në parkun Germia dhe parqe të tjera”	40,000.00€	40,000.00€	/
4.	“Emërtimi Ndërtimi i objektit të Bashkësisë Lokale dhe ofiqarisë në Marec”	50,000.00€	50,000.00€	/
5.	“Rikonstruimi i Rrugës Isa Kastrati”	385,000.00€	385 000,00€	/

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim Komuna e Prishtinës

18.4 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim

Në planifikimin e prokurimit Komuna e Prishtinës ka të planifikuar të zhvilloj 66 aktivitetet për kategorin furnizim. INPO ka monitoruar pesë (5) kontrata për furnizim nga 66 të planifikuara. Në përgjithsi planifikimi i prokurimit i publikuar nuk është plotësuar më të gjitha të dhënat e kërkuara dhe si i tillë nuk pasqyron transparencë të plotë siç kërkohet me parimet bazë të legjislacionit për prokurim, në planifikimin e prokurimit nuk janë të plotësuara fushat si njësia, sasia e përafërt vjetore dhe çmimi për njësi. Në kontratat të cilat i kemi përzgjedhur kemi monitoruar në e-prokurim se si janë plotësuar pjesa e “përshkrimit të çmimit” dhe kemi vërejtuar se Komuna Prishtinë për dallim nga planifikimi i prokurimit këtu në të pesë (5) aktivitetet për furnizime i ka të specifikuar njësit dhe sasi të.

Tabela 74. Zbatueshmëria e Planifikimit të Kontratave për Furnizime për Vitin 2020

#	ZBATUESHMËRIA E PLANIFIKIMIT TË KONTRATAVE PËR FURNIZIM						
#	#	Planifikim i prokurimit			Tenderim		
Nr.	Emri i kontratës	Njësia	Sasia	Vlera totale	Njësia	Sasia	Totali
1.	“Furnizim me drunje dekorativ”	/	/	20,000.00€	copë	280-copë	20,000.00€
						280*	
2.	“Furnizim me material didaktik (per artikujt qe nuk jane ne kontaten e AQP-se)”	/	/	65,000.00€	Kg	9332 -kg	65,000.00€
					Copë	43757-copë	
					Pako	517- pako	
					Komplet	14034-komplet	
					Meter	2590-m	
					risa	1150-Risa	
3.	“Furnizim me pajisje mjekësore për QKMF dhe QMU”	/	/	100,000.00€	copë	2182	120,000.00€
4.	“Furnizim me inventar”	/	/	150,000.00€	copë	5780	150,000.00€
5.	“Furnizim me pasije per kuzhine”	/	/	12,000.00€	copë	824	12,000.00€

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim (përshkrimi i çmimeve), Komuna Prishtinë.

***mungon njësia vetëm sasia 280 për “Hapja e gropave dhe mbjellja e fidaneve të parapara në përshkrim”.**

18.5 Projeketet/aktivitetet që nuk janë të përfshira në buxheti

Tabela 75. Aktivitetet/ Projektet që nuk identifikohen në Buxhet të Republikës së Kosovës

TITULLI I AKTIVITETIT/ PROJEKTIT	VLERA E PARASHIKUARA NË PLANIFIKIM TË PROKURIMIT
Ndërtimi i parkut tek 'Ruga B'	300,000.00 €
Ndërtimi i parkut në Prugoc	220,000.00 €
Ndërtimi i parkut të qenve në Taslixhe	80,000.00 €
Inventarizimi i hapësirave publike	280,000.00 €
Ndërtimi i QMF- Prishtina e Re Zona Perendim	400,000.00€

Burimi: Planifikimi i prokurimit, e-prokurim. Komuna e Prishtinës

19. PRIZREN

19.1 Pasqyrë e planifikimit të prokurimit 2020

Komuna e Prizrenit sipas planit të prokurimit për vitin fiskal 2020 ka planifikuar gjithsej 136 aktivitete të prokurimit. Prej këtyre aktiviteteve të prokurimit planifikohen që të realizohen 22 kontrata për furnizime, projekte të cilat janë planifikuar të kenë vlerë 2,045,000.39€, 28 kontrata për shërbime të cilat janë parashikuar të kenë vlerë 2,830,652.00€, 82 kontrata për punë të cilat janë planifikuar të kenë vlerë 8,523,807.00 €, katër (4) kontrata për konkurse projektimi të cilat janë planifikuar të kenë vlerë 222,741.00 €. Plani i prokurimit i Kuvendit Komunal të Prizrenit është publikuar me datën 27.03.2020 në e-prokurim dhe me 15.04.2020 në ueb-faqen e Komunes.

Tabela 76. Planifikimi i prokurimit për vitin 2020, Komuna Prizren

PASQYRË E PLANIFIKIMIT 2020		
Lloji i kontratës	Numri i kontratave	Vlera e kontratës
Furnizime	22	2,045,000.39 €
Shërbime	28	2,830,652.00 €
Punë	82	8,523,807.00 €
Konkurs projektimi	4	222,741.00 €

Burimi: Planifikimi i prokurimit e-prokurim, Komuna Prizren

19.2 Kontratat e planifikuara për punë dhe buxheti

Komuna e Prizrenit sipas planit të prokurimit për vitin fiskal 2020 ka planifikuar 82 kontrata me vlerë të parashikuar prej 8,523,807.00€, ndërsa për këto kontrata të planifikuara në buxhet për vitin 2020-2022 janë planifikuar 26,747,569.00€.

INPO ka vërejtur që bazuar në planifikim kjo kategori nuk është plotësuar sipas kërkesave ligjore. Ndërsa, në planifikimin e prokurimit të komunës janë të plotësuar vetëm përshkrimi i kontratës (titulli i kontratës), data e parashikuar e fillimit të prokurimit dhe vlera e parashikuar. Nga buxheti vërejmë se shumica e projekteve kanë buxhet edhe për vitet në vijim por, një gjë e tillë nuk identifikohet në plan të prokurimit.

Tabela 77. Numri i Kontratave të Planifikuara në Plan të Prokurimit dhe Buxhet të Republikës së Kosovës

NUMRI I KONTRATAVE TË PLANIFIKUARA PËR PUNË DHE BUXHETI			
Numri i kontratave në planifikim të prokurimit	Vlera e parashikuar në planifikim (1)	Buxheti 2020-2022 (2)	Diferenca +/- (2-1)
82	8,523,807.00€	26,747,569.00€	+18,223,762.00 €

Burimi: Planifikimi i prokurimit e-prokurim, Ligji Nr. 07L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2020.

19.3 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë

Nga 82 kontrata që ka planifikuar Komuna e Prizrenit në planin e prokurimit për vitin fiskal 2020, INPO ka bërë monitorimin e pesë (5) kontratave për punë. Nga ky monitorim kemi arritur të vërejmë se në pesë (5) projektet e përzgjedhura ka rritje të vlerës në njoftimin për kontratë nga vlera e planifikuar në plan të prokurimit. Për këto pesë (5) kontrata të monitoruara vlera në planifikimin e prokurimit është 625,000.00€ ndërsa vlera në njoftimin për kontratë është 4,690,000.00 €, pra ka një diferencë prej 4,040,000.00€. (Shih tabelën 78).

Komuna e Prizrenit për kontratë “Shtimi i kapacitetit të ujit të pijës në Tusus” në planin e prokurimit ka planifikuar 80,000.00€. Mirëpo, në njoftimin për kontratë të publikuar në e-prokurim vlera e parashikuar është caktuar 650,000.00€. Për të njëjtin aktivitet në buxhet për vitin 2020-2022 janë planifikuar 80,000.00€. Komuna e Prizrenit ka vepruar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik ngase nuk e ka cekur në planin e prokurimit që projekti në fjalë është projekt dy (2) vjeçar.

Komuna e Prizrenit për kontratën “Ndertimi i objektit të ri shkollor (9 klaseshe) në Gjonaj të Hasit” në planin e prokurimit ka planifikuar 125,000.00€. Mirëpo në njoftimin për kontratë të publikuar në e-prokurim vlera e parashikuar është caktuar 475,000.00€. Për të njëjtin projekt në buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020-2022 janë planifikuar 425,000.00€. Komuna e Prizrenit ka vepruar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik ngase për këtë projekt ka rritur për 350,000.00€ vlerën e parashikuar në njoftimin për kontratë nga vlera e parashikuar në planin e prokurimit. Njëherit, kjo vlerë e parashikuar në njoftimin për kontratë ka 50,000.00€ më shumë se shuma e planifikuar nga buxheti i Republikës së Kosovës për periudhën kohore 2020-2022. Vlen të ceket që projekti pritet të kryhet për 120 ditë ndërsa nga buxheti është planifikuar shuma e lartëcekur për tri (3) vite.

Komuna e Prizrenit për projektin “Ndërtimi i rrugës Sërbicë e Poshme-Sërbicë e Eperme” në planin e prokurimit janë planifikuar 70,000.00€. Mirëpo, në njoftimin për kontratë të publikuar në e-prokurim vlera e parashikuar është caktuar 715,000.00€. Për të njëjtin projekt në buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020-2022 janë planifikuar 70,000.00€. INPO ka vërejtur që Komuna e Prizrenit ka vepruar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik ngase nuk e ka cekur në planin e prokurimit që projekti në fjalë është projekt dy (2) vjeçar.

Komuna e Prizrenit për kontratën “Ndërtimi i banesave Kolektive për Banim Social me bashkëfinancim” në planin e prokurimit ka planifikuar 250,000.00 €, në platformën e-prokurimi vlera e parashikuar është 900,000.00€, mirëpo në njoftimin për kontratë të vlera e parashikuar është caktuar 1,300,000.00€. Për të njëjtin projekt nga Ligji Nr. 07L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020-2022 janë planifikuar 950,000.00€. INPO ka vërejtur që Komuna e Prizrenit nuk e ka cekur në planin e prokurimit që projekti në fjalë është projekt dy (2) vjeçar.

Tabela 78. Zbatueshmëria e Planifikimit të Kontratave për Punë për vitin 2020

ZBATUESHMËRIA E PLANIFIKIMIT TË KONTRATAVE PËR PUNË				
Nr.	Emri i kontratës	Vlera në Planifikim të prokurimit	Vlera në njoftim për kontratë	Diferenca +/-
1.	“Shtimi i kapacitetit të ujit të pijës në Tusus”	80,000.00€	650,000.00€	+570,070.00€
2.	“Ndertimi i objektit të ri shkollor (9 klaseshë) në Gjonaj të Hasit”	125,000.00€	600,000.00€	+475,000.00€
3.	“Ndërtimi i rrugës Sërbicë e Poshme-Sërbicë e Eperme”	70,000.00 €	715,000.00€	+645,000.00€
4	“Ndërtimi i banesave Kolektive për Banim Social me bashkëfinancim”	250,000.00 €	1,300,000.00€	+1,050,000.00€
5.	“Ndertimi i objektit të ri shkollor Pllanjanë në Pllanjan”	100,000.00€	800.000,00€	+700,000.00€

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim Komuna Prizren

19.4 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim

Komuna e Prizrenit në planin e prokurimit për kategorinë e furnizimeve ka planifikuar 22 kontrata për vitin fiskal 2020.

INPO ka monitoruar pesë (5) kontrata për furnizime nga 22 kontratat e planifikuara. Nga ky monitorim kemi vërejtur që në katër (4) prej tyre ka një rritje nga vlera e parashikuar në plan të prokurimit prej vlerës në njoftimin për kontratë. Në planin e prokurimit për këto aktivitete janë planifikuar të shpenzohen 709,999.00€, ndërsa vlera në njoftimin për kontratë është 2,399,500.00€. Komuna e Prizrenit për këto pesë (5) projekte ka inicuar procedurën të prokurimit me vlerë 1,689,501.00€ më shumë se vlera e planifikuar në plan të prokurimit.

Komuna e Prizrenit ka vepruar në kundërshtim me ligjin e prokurimit pasi në kontratën “Furnizim me Autoambulanca për QMF” në planin e prokurimit ka planifikuar që të blejë tri (3) autoambulanca me vlerë 100,000.00€, mirëpo në përshkrimin e çmimeve të publikuar në e-prokurim figuron që Komuna e Prizrenit ka inicuar procedurë të tenderimit vetëm për dy (2) autoambulanca me vlerë 100,000.00€.

INPO ka vërejtur që Komuna e Prizrenit në kontratë “Furnizimi me mekanizim bujqësor me participim” në planin e prokurimit ka planifikuar që të furnizohet me 200 mekanizma bujqësorë me vlerë 150,000.00€, mirëpo në parashikimin e çmimeve të publikuar në e-prokurim figuron që Komuna e Prizrenit ka inicuar procedurë të tenderimit vetëm për 150 mekanizma bujqësorë me vlerë 187,500.00€.

Për projektin “Furnizimi me material ndërtimor për raste sociale” në planin e prokurimit janë planifikuar 90,000.00€. Mirëpo, në njoftimin për kontratë të publikuar në e-prokurim vlera e parashikuar është caktuar 450,000.00€.

Në projektin “Furnizimi me zhavor për rrugët e paasfaltuara” në planin e prokurimit janë planifikuar 250,000.00€, mirëpo në njoftimin për kontratë të publikuar në e-prokurim vlera e parashikuar është caktuar 1,500,000.00€. Komuna nuk e ka çekur që ky projekt është projekt tre (3) vjeçar. INPO ka

vërejtur që vlera e parashikuar në njoftimin për kontratë është rritur për 1,250,000.00€ nga vlera e parashikuar në njoftimin për kontratë.

Në projektin “Furnizimi me meshqerra gravide (5-7 muaj) me participim” në planin e prokurimit janë planifikuar 120,000.00€. Ndërsa, në njoftimin për kontratë të publikuar në e-prokurim vlera e parashikuar është caktuar 162,000.00 €. Komuna e Prizrenit ka rritur vlerën e parashikuar për këtë kontratë të prokurimit për 42,000.00€ në njoftimin për kontratë.

Tabela 79. Zbatueshmëria e Planifikimit të Kontratave për Furnizime për vitin 2020

#	ZBATUESHMËRIA E PLANIFIKIMIT TË KONTRATAVE PËR FURNIZIM						
#	#	Planifikim i prokurimit			Tenderim		
Nr.	Emri i kontratës	Njësia	Sasia	Vlera totale	Njësia	Sasia	Vlera totale
1.	“Furnizimi me meshqerra gravide (5-7 muaj) me participim”	Copë	90	120,000.00€	Copë	90	162,000.00€
2.	“Furnizimi me material ndërtimore për raste sociale”	Copë,	N/A	90,000.00€	Kilogram (kg),	22,860 m ² ,	450,000.00€
		Kg				2571m,	
					Meter kub (m ³),	125,250 kg,	
					meter	6153 m ³	
					katror (m ²),		
					Meter m,		
3.	“Furnizimi me zhavor per rruget e paasfaltuara”	Metër kub (m ³)	20000	250,000.00€	Metër kub (m ³),	28 m ³ ,	1,500,000.00€
						1kg,	
					Orë (h),	13 m ² ,	
						2h.	
4.	“Furnizim me Autoambulanca për QMF”	Copë	3	99,999.99€	Copë	2	100,000.00€
5.	“Furnizimi me mekanizim bujqësor me participim”	Copë	200	150,000.00€	Copë	150	187,500.00€

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim (përshkrimi i çmimeve), Komuna Prizren.

20. SUHAREKË

20.1 Pasqyrë e planifikimit të prokurimit 2020

Komuna e Suharekës në planin e prokurimit për vitin fiskal 2020 ka planifikuar 141 kontratë me vlerë të parashikuar 5,663,511.00€. Nga këto kontrata/projekte 21 prej tyre janë planifikuar për kategorinë e furnizimeve ku vlera e parashikuar është 859,500.00€. 29 kontrata janë planifikuar për kategorinë e shërbimeve ku vlera e parashikuar është 767,402.00€ dhe 91 kontrata janë planifikuar për kategorinë më të madhe atë të punëve, ku vlera e parashikuar është 4,036,609.00 € dhe sipas planit të prokurimit nuk ka ndonjë planifikim për konkurse të projektimit.

Plani i prokurimit është i publikuar me datën 24.01.2020 në e-prokurim ndërsa me datën 06.02.2020 në ueb-faqën e Komunës.

Për shkak të gjendjes së krijuar nga Covid 19, Agjencioni Qendror i Prokurimit (AQP) ju ka ofruar Autoriteve Kontraktuese (AK) mundësinë që të bëjnë plotësim/ ndryshimet e planifikimit të prokurimit për vitin 2020 deri me datën 15 Korrik 2020, me mundësi të vazhdimit prej 15 ditësh në rast të plotësim/ndryshimit të Ligjit nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. INPO ka zhvilluar intervistë përmes telefonit me Menaxherin e Prokurimit z.Afrim Bytyqi dhe i njëjti ka pohuar se Komuna e Suharekës nuk e ka shfrytëzuar këtë mundësi, njëherit nuk ka bërë ndonjë ndryshim në planin e prokurimit.

Tabela 80. Planifikimi i prokurimit për vitin 2020, Komuna e Suharekës

PASQYRË E PLANIFIKIMIT 2020		
Lloji i kontratës	Numri i kontratave	Vlera e kontratës
Furnizime	21	859,500.00€
Shërbime	29	767,402.00€
Punë	91	4,036,609.00€
Konkurs projektimi	-	-

Burimi: Planifikimi i prokurimit e-prokurim, Komuna Suharekë

20.2 Kontratat e planifikuara për punë dhe buxheti

Komuna e Suharekës sipas planit të prokurimit për vitin fiskal 2020 ka planifikuar 91 kontrata për punë me vlerë të parashikuar prej 4,036,609.00€, ndërsa për këto kontrata të planifikuara në Ligji Nr.07L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020-2022 janë planifikuar €9,116,933.00. Për më tepër, për këtë kategori do të thotë, për projektet punë/ investimeve kapitale të parapara në planifikim dhe projektet e njëjta krahasuar me ligjin mbi ndarjet buxhetore 2020 të miratuar në mars 2020 kemi një difference prej 5,080,324.00€ që do të thotë Komuna e buxhetin e viti 2020 ka më shumë mjete në dispozicion në krahasim me planifikimin, komuna në fjalë nuk po paraqetë detaje të mjaftueshme nëse projektet i ka dy apo tri vjeçare, ndërsa në buxhet ka mjete të ndara edhe për vitet në vijim për disa kontrata.

Tabela 81. Numri I Kontratave të Planifikuara në Plan të Prokurimit dhe Buxhet të Republikës së Kosovës

NUMRI I KONTRATAVE TË PLANIFIKUARA PËR PUNË DHE BUXHETI			
Numri i kontratave në planifikim të prokurimit	Vlera e parashikuar në planifikim (1)	Buxheti 2020 (2)	Diferenca +/- (2-1)
91	4,036,609.00€	9,116,933.00 €	+5,080,324.00 €

Burimi: Planifikimi i prokurimit e-prokurim, Ligji Nr. 071-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2020.

20.3 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë

Nga 91 kontrata sa janë planifikuar, INPO në Komunën e Suharekës ka monitoruar pesë (5) projekte/kontrata. Komuna e Suharekës në tri (3) kontrata ka inicuar procedura të prokurimit saktësisht me vlerën e parashikuar në planifikim e prokurimit.

INPO ka vërejtur që Komuna e Suharekës ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik pasi në planin e prokurimit për disa kontrata që do të zgjasin më shumë se një vit fiskal nuk ka cekur që janë projekte më shumë se një vjeçare. Në tri (3) projekte komuna ka vepruar saktësisht siç ka planifikuar ndërsa, në dy (2) raste komuna ka rritur vlerën e parashikuar në njoftimin për kontratë.

Tabela 82. Kontratat për punë të analizuar

ZBATUESHMËRIA E PLANIFIKIMIT TË KONTRATAVE PËR PUNË				
Nr.	Emri i kontratës	Vlera në Planifikim të prokurimit (1)	Vlera në njoftim për kontratë (2)	Diferenca +/- (2-1)
1.	“Rregullimi dhe ndërtimi i shtallave për furnizim me material ndërtimor”	78,044.00€	78,044.00 €	0€
2.	“Ndërtimi dhe renovimi i fushave sportive (stadiumeve) në Savrovë, Shirokë dhe Komunë”	65,000.00€	65,000.00 €	0 €
3.	“Rregullimi i trotuarëve dhe parkingjeve në Topliqan-Leshan, Doberdelan, Breshanc, Semetisht dhe Komunë”	79,000.00€	229,000.00€	150,000.00€
4.	“Ndërtimi i urave në Komunë-Leshan (Rr. Shaban Kryeziu), Reshtan (Rr. Shpati), Studenqan-Tërrnje, Suharekë (Mulliri i Beqës)”	97,000.00€	148,826.00€	+51,826.00€
5.	“Sanimi dhe renovimi i QKMF-ve dhe AMF-ve”	37,800.00€	37,800.00€	0€

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim, Komuna e Suharekës.

20.4 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim

Në përgjithësi planifikimi i prokurimit i publikuar nuk është plotësuar më të gjitha të dhënat e kërkuara dhe si i tillë nuk pasqyron transparencë të plotë siç kërkohet me ligj, në planifikimin e prokurimit nuk janë paraqitur saktë fushat si njësia, sasia e përafërt vjetore, çmimi për njësi.

Në projektet të cilat i kemi përzgjedhur kemi monitoruar në e-prokurim se si janë plotësuar pjesa e “përshkrimit të çmimit” dhe kemi vërejtuar se Komuna e Suharekës për dallim nga planifikimi i prokurimit këtu në të katër (4) kontratat për furnizime i ka të specifikuar njësitë dhe sasitë, ndërsa në një (1) kontratë nuk ka specifikuar njësinë.

Tabela 83. Zbatueshmëria e Planifikimit të Kontratave për Furnizime për Vitin 2020

#	ZBATUESHMËRIA E PLANIFIKIMIT TË KONTRATAVE PËR FURNIZIM						
#	#	Planifikim i prokurimit			Tenderim		
Nr.	Emri i kontratës	Njësia	Sasia	Vlera totale	Njësia	Sasia	Vlera totale
1.	“Furnizim me Autoambulancë”	Komplet	1	40,000.00€	-	1	40,000.00€
2.	“Furnizim me paisje teknologjike (kompjuter, komplet fotokopje, laptop, kamera, printer, videoprojektor dhe paisje tjera”	Komplet	1	50,000.00€	Copë, Metër Komplet	2068 Copë 13626 Metër, 14 Komplet	30,000.00€
3.	“Furnizimi me koshere për bletari”	Komplet	1	10,000.00	Copë,	303 copë	10,000.00€
4.	“Blerja e softëerit”	Komplet	1	12,000.00	Copë, Faqe Komplet	4 Copë, 556,125 Faqe, 2 Komplet	68,000.00€
5.	“Furnizimi me material fidanor”	Komplet	1	22,500.00	Copë	4090 Copë	22,500.00€

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim (përshkrimi i çmimeve), Komuna Suharekë.

20.5 Kontatat/ projektet qe nuk janë në buxhet

INPO, ka hulumtuar për të parë nëse janë përfshirë të gjitha aktivitetet e planifikuara nga ana e komunës në ligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin 2020, dhe nuk kemi arritur të identifikojmë dy (2) projekte ("Renovimi dhe sanimi i tualetit në DSHMS" dhe "Rregullimi i nyjeve Sanitare ne QPS"), do të thotë rreth 3,200.00€ nuk janë të përfshira në ligjin mbi ndarjet buxhetore 2020.

21. SHTIME

21.1 Pasqyrë e planifikimit të prokurimit 2020

Komuna e Shtimes nuk ka bërë ndryshim të planifikimit të prokurimit si pasojë e rishikimit të buxhetit, kjo INPO-së i është vërtetuar nga intervista e datës 03.09.2020, e zhvilluar me zyrën e prokurimit të Komunës së Shtimes dhe arsyeja e mos ndryshimit është për faktin se nuk ka pasur ndryshime të mëdha në buxhetin e rishikuar.

Tabela 84: Planifikimi i prokurimit 2020, Komuna e Shtimes.

PASQYRË E PLANIFIKIMIT 2020		
Lloji i kontratës	Numri i kontratave	Vlera e kontratës
Furnizime	17	279,588.00€
Shërbime	27	306,993.00€
Punë	37	1,864,050.00€
Konkurs projektimi	/	/

Burimi: Planifikimi i prokurimit e-prokurim, Komuna e Shtimes

Pra, për vitin 2020 Komuna e Shtimes ka planifikuar 17 kontrata apo aktivitete për furnizime në vlerë 279,588.00€, 27 për shërbime në vlerë 306,993.00€ dhe 37 kontrata për punë në vlerë 1,864,050.00€. Numri total i kontratave apo aktiviteteve të planifikuara është 81 me një vlerë totale prej 2,450,631.00€.

21.2 Kontratat e planifikuara për punë dhe buxheti

Para inicimit të çdo projekti të prokurimit është e rëndësishme që autoriteti kontraktues të ketë në dispozicion buxhet të caktuar lidhur me zhvillimin e atij projekti. INPO ka monitoruar se sa përputhet vlera e parashikuar e projekteve të planifikuara për punë me buxhetin që ka në dispozicion komuna.

Tabela 85: Numri i kontratave të planifikuara për punë dhe buxheti.

Numri i kontratave të planifikuara për punë dhe buxheti			
Numri i kontratave	Vlera e parashikuar në planifikim (1)	Buxheti 2020-2022 (2)	Diferenca +/- (2-1)
37	1,864,050.00€	1,948,096.00€	+84,046.00€

Burimi: Planifikimi i prokurimit e-prokurim, Ligji Nr. 071-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2020.

Nga të dhënat e paraqitura në tabelë, vërehet që në planifikimin 2020 Komuna e Shtimes ka planifikuar 37 kontrata për punë me vlerë totale 1,864,050.00€, ndërsa buxhet për vitin 2020-2022 ka planifikuar 1,948,096.00€. Pra, komuna ka planifikuar 84,046.00€ më shumë se sa që ka në dispozicion. Monitorimi që ka bërë INPO dhe komentet e zyrës së prokurimit të Komunës së Shtimes tregojnë që problemi qëndron tek ajo se në planifikimin e prokurimit gjenden edhe projekte më shumë se një vjeçare të cilat nuk janë të theksuara në planifikim si projekte shumë vjeçare.

21.3 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë

INPO ka monitoruar pesë (5) kontrata për punë për të analizuar se sa vlera e tyre e parashikuar në planifikim të prokurimit përputhet me vlerën e parashikuar në njoftimin për kontratë. Rezultatet e analizës i gjeni të bashkangjitura në tabelën më poshtë.

Tabela 86: Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë.

ZBATUESHMËRIA E PLANIFIKIMIT TE KONTRATAVE PËR PUNË				
Nr.	Emri i kontratës	Vlera në Plan të Prokurimit (1)	Vlera njoftim për kontratë (2)	Diferenca +/- (2-1)
1.	“Renovimi Hapsirave të brendshme në Objektin e Qenderes Rinore”	40,000.00€	20,000.00€	-20,000.00€
2.	“Ndërtimi i objektit të QMF së në Pjetërshticë”	40,000.00€	50,000.00€	+10,000.00€
3.	“Asfaltimi i rrugëve dhe rregullimi i kanalizimit të ujërave të zeza, në fshatrat Gjurovc, Godanc, Lagja e Pajtimit dhe Davidoc”	60,000.00€	170,000.00€	+110,000.00€
4.	“Rregullimi i Infrastruktura në Zone Ekonomike II”	63,000.00€	50,000.00€	-13,000.00€
5.	“Asfaltimi i Rrugeve në fshatin Petrovë dhe lagja Luzhak dhe rregullimi i kanalizimit, dhe Ndërtimi i urave në fshatin Petrovë”	90,000.00€	120,000.00€	+30,000.00€

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim, Komuna e Shtimes

Të gjeturat vërtetojnë që në të gjitha kontratat e monitoruara, kanë tejkaluar planifikimin dhe atë në tri (3) raste ka vënë në dispozicion më shumë mjete se sa kishte planifikuar, ndërsa në dy (2) raste më pak. Këto të gjetura argumentojnë që Komuna e Shtimes ka dështuar të bëjë në planifikim në bazë të kërkesave ligjore. Gjithashtu, komuna nuk ka identifikuar në mënyrë të saktë se projektet e planifikuara janë njëvjeçare apo më shumë-vjeçare. INPO ka analizuar edhe buxhetin e komunës dhe rezulton që vetëm projekti “Renovimi Hapsirave të brendshme në Objektin e Qenderes Rinore” është projekt njëvjeçar, ndërsa në planifikim nuk tregohet askund që ndonjëri nga projektet e paraqitura në tabelë është më shumë se një vit.

Nga ajo që u tha më lartë, vërejmë që Komuna e Shtimes ka shfaqur dobësi në planifikim të prokurimit, respektivisht planifikimin nuk e ka hartuar konformë kërkesave ligjore që dalin nga neni 8 i LPP-së dhe udhëzimet që dalin nga Interpretimi i KRPP-së Nr.133/2017 lidhur me projektet shumë vjeçare dhe paraqitjes së tyre në planifikim.³¹ Për më tepër, INPO më 18.09.2020, ka zhvilluar intervistë telefonike me zyrtarin e prokurimit z.Mursel Salihu të cilin e ka pyetur edhe për këtë çështje dhe i njëjti është përgjigjur se “Njësitë kërkuese na dërgojnë projektet që ata i planifikojnë dhe ne vetëm i zhvillojmë po sigurisht që vlera e parashikuar vendoset pasi që njësitë kërkuese ta masin tregun”. Pra, sipas zyrës së prokurimit, problemi qëndron tek njësitë e kërkesës sepse ata i përgatisin projektet së bashku me vlerën e parashikuar dhe se zyra e prokurimit vetëm i zhvillon procedurat.

³¹ Për më shumë shih, neni 8 Ligjit nr. 04/I-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës dhe Interpretimi Nr.133/2017 i KRPP-së.

21.4 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim

INPO ka monitoruar edhe planifikimet për furnizim duke krahasuar planifikimin me dokumentet e inicimit të aktivitetit të prokurimit siç janë njoftimi për kontratë, duke parë nëse komuna ka respektuar vlerën e parashikuar për të parë se sa AK-të kanë qëndruar prapa njësive dhe sasisive të planifikuar në planifikim të prokurimit.

Tabela 87: Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim.

ZBATUESHMËRIA E PLANIFIKIMIT TË KONTRATAVE PËR FURNIZIM						
	Planifikim			Tenderim		
Titulli i kontratës	Njësia	Sasia	Vlera totale	Njësia	Sasia	Vlera totale
“Furnizimi me pelet- për institucionet e Komunës së Shtimes”	/	/	16,500.00€	Ton	61.5	11,645.00
“Furnizimi me kompjuter, llaptop, projektor dhe kamera për institucionet e Komunës së Shtimes”	/	/	18,532.00€	Copë	610 Copë	30,736.00€
				Metër		
				Komplet	2,700 Metër 21 Komplet	
“Furnizim për zyre për institucionet e Komunës së Shtimes”	/	/	27,877.00€	Copë	12,386 Copë	17,301.90€
				Ris		
					Ris 150	
				Komplet	1,028.00 Kg	
				Kg		
					Komplet 583	
				Blok	740 Blok	
“Furnizimi me material , dhe mirëmbajtja e ndërtesave për institucionet e	/	/	107,456.00€	Copë	4457 Copë	76,245,50.00€
				M2	293 m ²	

Komunës së Shtimes”				Metër		
				Komplet	774 Metër	
				Kuti		
					4 Komplet	
					5 Kuti	
“Furnizimi me Material Hixhenik për Institucionet e Komunës së Shtimes”	/	/	16,450.00€	Copë	12,292 Copë	18,399.33€
				Paketim		
					137 Paketim	
				Thes		
					59 Thes	
					658 Litër	
					533 Palë	
				Litër	2636	
				Palë	Kompleta	
				Kompleta		

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim (përshkrimi i çmimeve), Komuna e Shtimes

Nga pesë (5) kontratat e testuara, INPO vëren se në asnjërën nga to vlera e parashikuar e kontratës nuk është e njëjtë si në planifikim, madje në dy (2) raste ka tejkalim të vlerës së parashikuar. Gjithashtu, tek njësia matëse Komuna e Shtimes nuk ka paraqitur fare njësitë matëse por vetëm titullin e aktivitetit dhe vlerën e parashikuar. Përveç, kësaj INPO vërehet që AK-ja ka përdorur njësi matëse të paqëndrueshme siç janë: komplet, bllok, paketim, thes etj, të cilat nuk bëjnë pjesë fare në njësi matëse. Komuna e Shtimes ka dështuar që në planifikim t’i paraqes sasisë lidhur me furnizimet e planifikuara me çka Komuna e Vitisë ka dështuar që të zbatojë kërkesat që dalin nga neni 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 5.6 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, ku shprehimisht kërkohet që në rastin e kontratave të ardhshme për furnizim të llogaritet vlera e përgjithshme e prokurimit sipas lëmisë së secilit produkt, të cilin autoriteti kontraktues planifikon që ta prokurojë gjatë vitit fiskal.³²

³² Shih, Neni 8, paragraf 1, nënparagraf 1.1 Ligjit nr. 04/I-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, lidhur me nenin 5.6 të RrOUPP.

Në intervistën e datës 18.09.2020, INPO ka pyetur zyrtarin e prokurimit se përse mungojnë njësitë matëse për kontratat e furnizimit në planifikim të prokurimit dhe përgjigja ka qenë se “Ne asnjëherë nuk i vendosim këto sepse nuk mund ta dimë, por vetëm vlerën e parashikuar të kontratës”, në pyetjen se përse në disa kontrata për furnizim vlera e parashikuar në njoftim është më e lartë se në planifikim, përgjigja ishte se “Me siguri bëhet fjalë edhe për ndonjë punë tjetër lidhur me atë furnizim”.

21.5 Projektet/aktivitetet që nuk janë të identifikuar në buxhetin

INPO, gjithashtu ka hulumtuar edhe atë se projektet për punë të planifikuara nga ana e Komunës së Shtimes a identifikohen në buxhet. Nga monitorimi rezulton që në buxhet nuk mund të identifikohet projekti “Ndërtimi i laurës dhe rregullimi i ndriçimit publik në rrugën Industria dhe Parkun Teknologjik” me vlerë të planifikuar 17,000.00€. Ne kemi mundur të identifikojmë një projekt me titull “Ndërtimi i Laurës” me vlerë 5,000.00€. Lidhur me këtë gjë INPO ka pyetur komunën respektivisht, Drejtorin e Prokurimit dhe na është sqaruar që projekti që nuk kemi mundur ta identifikojmë është ndarë në dy (2) projekte dhe atë: “Ndërtimi i Laurës” me vlerë 5,000.00€ dhe “Rregullimi i ndriçimit publik në rrugën industriale dhe parkun teknologjik” me vlerë 12,000.00€, që së bashku bëjnë 17,000.00€. Pra, edhe pse parimisht një gjë e tillë nuk është e ndaluar, e njëjta tregon dobësi në planifikim të prokurimit. Këtu nuk përjashtohet edhe mosbashkëpunimi nga ana e njësisë të kërkesës me zyrën e prokurimit lidhur me projektet eaktuara.

22. VITI

22.1 Pasqyrë e planifikimit të prokurimit 2020

Komuna e Vitisë për vitin 2020 ka planifikuar gjithsej 84 projekte, prej të cilave 35 janë projekte për furnizim, 35 për shërbime dhe 14 projekte për punë. Vlera totale e këtyre projekteve në bazë të planifikimit është 3,420,625.70€.

Tabela 88: Planifikimi i prokurimit 2020, Komuna e Vitisë

Lloji i kontratës	Numri i kontratave	Vlera totale
Furnizime	35	758,696.70€
Shërbime	35	1,041,779.00€
Punë	14	1,620,150.00€
Konkurs projektimi	/	€0.00€

Burimi: Planifikimi i prokurimit, e-prokurimi, Komuna e Vitisë

Në planifikimin e prokurimit, vërejmë se Komuna e Vitisë ka dështuar t’i përmbushë kërkesat e nenit 8 të LPP-së, respektivisht ka dështuar që të pasqyroj në detaje të arsyeshme të gjitha kontratat që dëshiron t’i lidhë. Në planifikimin e prokurimit për vitin 2020, komuna për shumë projekte datën e fillimit të prokurimit e ka më të hershme se data e miratimit të buxhetit. Pra, Ligji për buxhetin 2020 ka hy në fuqi më 19.03.2020, ndërsa në planifikim të prokurimit ka projekte që datën e fillimit të prokurimeve e kanë në muajin janar.

22.2 Kontratat e planifikuara për punë dhe buxheti

Autoritetet Kontraktuese, përveç që obligohen që në planifikim të parashikojnë edhe datën e fillimit të punimeve, është shumë e rëndësishme që të përcaktohet edhe vlera e parashikuar për secilin projekt, mandje është shumë e rëndësishme që vlerat e parashikuara të projekteve të përputhen me kapacitetet buxhetore që ka AK-ja në fjalë.

Tabela 89: Numri i kontratave të planifikuara për punë dhe buxheti, Komuna e Vitisë

Numri total i kontratave për punë	Vlera e parashikuar me plan të prokurimit (1)	Buxheti 2020-2022 (2)	Diferenca +/- (2-1)
14	1,620,150.00€	4,940,442.00€	+3,320,292.00€

Burimi: Plani i prokurimit për vitin 2020 për komunën Viti dhe Ligji mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020

Pra, ashtu siç u theksua më lartë, Komuna e Vitisë ka planifikuar 14 kontrata të punës, respektivisht projekte kapitale me një vlerë totale 1,620,150.00€. Pra, komuna ka planifikuar projekte kapitale me vlerë 1,620,150.00€. Ndërsa, për tri vitet ka buxhet të ndarë €4,940,442.00. Por, që një gjë e tillë nuk konsiderohet planifikim i mirë pasi komuna në planifikimin e saj nuk e ka parashikuar totalin e kontratës por vetëm për një vit, ndërsa ligji për prokurim publik e obligon të planifikoj totalin e kontratës. Komuna ka kontrata të planifikuara të cilat kanë mjete të ndara në buxhet edhe për vitet në vijim, një gjë e tillë konfirmohet edhe nga vet zyra e prokurimit, si rezultat i kesaj kemi diferencë rreth +3,320,292.00€ më shumë në buxhet.

22.3 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë

INPO ka monitoruar zbatueshmërinë praktike të planifikimit të prokurimit, respektivisht ka monitoruar atë se AK, në rastin konkret Komuna e Vitisë nëse po qëndron prapa planifikimit të kontratave të prokurimit, posaçërisht në aspektin e vlerës së parashikuar të punëve. INPO ka monitoruar pesë (5) kontrata për punë, për të parë që a përputhen me parashikimet që ka bërë komuna në fillim vit. Krahasset bëhen në mes të vlerës së parashikuar në plan të prokurimit dhe vlerës së parashikuar në njoftimin për kontratë (shih tabelën 90).

Tabela 90: Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë për vitin 2020, Komuna e Vitisë

Nr.	Kontrata	Vlera në planifikim të prokurimit (1)	Vlera në njoftim për kontratë (2)	Diferenca +/- (2-1)
1	“Rregullimi i rrugëve bujqësore me zhavorr”	110,000.00€	450,000.00€	-340,000.00€
2	“Ndërtimi i fushës ndihmëse të futbollit në Pozheran-Ritender”	130,000.00€	250,000.00€	-120,000.00€
3	“Rregullimi i lumenjve (kanaleve) dhe prrockave”	35,000.00€	105,000.00€	-70,000.00€
4	“Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimit publik në komunën e Vitisë”	285,000.00€	350,000.00€	-65,000.00€
5	“Asfaltimi i rrugëve në fshatin Smirë, Kolishtë dhe Tërpezë”	189,150.00€	300,000.00€	-110,850.00€

Burimi: Planifikimi i prokurimit, njoftimi për kontratë e-prokurim, Komuna e Vitisë

Të gjeturat tregojnë që asnjëra nga kontratat për punë nuk ka vlerë të parashikuar të njëjtë me vlerën e parashikuar në njoftimin për kontratë. Pra, qysh në fillim vërehet anashkalim i planifikimit të prokurimit dhe nëse shihni tabelën më lartë, vëreni se në të gjitha rastet vlera në njoftimin për kontratë ka qenë shumë më e lartë sesa në planifikim të prokurimit. INPO, në kontratat e testuara vëren se Komuna e Vitisë ka dështuar që ta implementoj në përpikëri Nenin 8 të Ligjit për Prokurimin Publik, ku kërkohet që planifikimi të bëhet me të dhëna të detajuara lidhur me aktivitetin e caktuar.

Përveç, që asnjëri nga aktivitetet e testuara nuk përputhet me vlerën e parashikuar në planifikim, gjithashtu të gjitha këto projekte janë dy e më shumë vjeçare.

Nga ajo që u tha më lartë, Komuna e Vitisë ka shfaqur dobësi në planifikim të prokurimit, respektivisht planifikimin nuk e ka hartuar konform kërkesave ligjore që dalin nga neni 8 i LPP-së dhe udhëzimet që dalin na Interpretimi i KRPP-së Nr.133/2017 lidhur me projektet shumë vjeçare dhe paraqitjes së tyre në planifikim.³³

22.4 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim

Kontratat për furnizim marrin një shumë mjaftë të madhe të buxhetit të Autoriteteve Kontraktuese, INPO me qëllim të hulumtimit të zbatueshmërisë së planifikimit të prokurimit edhe tek kontratat për furnizim ka monitoruar pesë (5) kontrata për furnizim.

Tabela 91: Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim, Komuna e Vitisë

Kontrata	Planifikimi			Tenderimi		
	Njësia	Sasia	Gjithsej vlera	Njësi	Sasia	Totali
“Furnizimi dhe vendosja e shenjave horizontale dhe vertikale të komunikacionit”	m	1,00	31,254.00€	m ²	52,928	66,240.00€
				Copë	1,174	
“Furnizimi me perde, tepih dhe tepison për nevojat e shkollave dhe administratës-Ritender”	m	1,00	29,997.00€	Copë	20	29,997.00€
				m ²	3,390	
“Furnizim me kompjutera dhe pajisje të TI”	Copë	1,00	20,765.00€	Copë	221	20,765.00€
				m	500	
“Furnizim me dru zjarri për djegie për të gjitha njësitë shpenzuese”	m-h	3,400.00	141,100.00€	m/h	3,080.00	124,900.00€
“Furnizim me barna për QMF-të”	Copë	1,00	59,297.00€	Copë	558,480	59,297.00€
				Litër	450	
				Kuti	1160	
				Pako	4890	

Burimi: Planifikimi i prokurimit, “përshkrimi i çmimeve” e-prokurim

³³ Për më shumë shih, neni 8 Ligjit nr. 04/I-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës dhe Interpretimi Nr.133/2017 i KRPP-së.

Nga pesë (5) kontratat e monitoruara, INPO vëren se në dy (2) nga to vlera e parashikuar e kontratës nuk është e njëjtë si në planifikim. Gjithashtu, vërehet një defekt i përgjithshëm tek sasia dhe njësia matëse, tek njësia AK-ja nuk ka paraqitur të gjitha njësitë matëse, zakonisht është përdorur “metër” dhe “copë” ndërsa, pas monitorimit të INPO-së vërehet që AK-ja ka dështuar t’i përfshijë të gjitha njësitë matëse për ato kontrata/ projekte. Ashtu, siç shihet në tabelë për aktivitetet në fjalë ka pasur edhe njësi matëse litër, m² dhe edhe shprehje tjera si: sprej, komplet, roll, pako, kuti të cilat nuk bëjnë pjesë fare në “njësi matëse”.

Gjithashtu, AK Komuna e Vitisë ka dështuar që në planifikim t’i paraqes sasinë e sakta, respektivisht ka përdorur shabllonin “1,00” përveç tek kontrata “Furnizim me dru zjarri për djegie për të gjitha njësitë shpenzuese” ku ka parashikuar 3,400.00 m³, ndërsa në njoftim për kontratë ka kërkuar 3,080.00 m³, që edhe kjo dëshmon një planifikim jo të bazuar në kërkesat ligjore.

23. VUSHTRRI

23.1 Pasqyrë e planifikimit të prokurimit 2020

Komuna e Vushtrrisë në planifikimin e prokurimit për vitin 2020 kishte planifikuar të zhvillojë gjithsej 91 aktivitete të prokurimit, ky planifikim u publikua në e-prokurim me 03.04.2020 dhe në ueb-faqe të komunës me 14.04.2020. Prej këtyre aktiviteteve komuna planifikon të realizojë 42 aktivitete për furnizim për vitin 2020, ku vlera e përgjithshme e tyre arrin 1,017,99.90€, kategoria e dytë me më së shumti projekte është kategoria e punëve, ku sipas planifikimit të prokurimit janë të parapara 29 projekte të cilat janë parashikuar të kenë vlerë 2,233,485.30€. Pjesa, tjetër e planifikimit është për kategorinë e shërbimeve ku janë parashikuara 20 projekte dhe vlera e të cilave arrin parashikimin prej 1,482,015.00€. Ndërsa, për kategorinë konkurse projektimi, komuna nuk ka parashikuar ndonjë projekt për vitin fiskal 2020. INPO, është interesuar nëse Komuna e Vushtrrisë planifikon të bëjë rishikim të planifikimit të prokurimit siç i’u është mundësuar përmes njoftimit të AQP-së, Nr. 124/20 më 01.07.2020, dhe nëpërmjet intervistës me telefon me 08.09.2020 me zyrtarin për prokurim z. Hyda Dallku na është konfirmuar se: “do të këtë rishikim të planifikimit pasi që janë mbajtur takimet dhe janë identifikuar ndryshimet dhe i njëjti pastaj është i publikuar në e-prokurim”.

Tabela 92: Planifikimi i prokurimit për vitin 2020, Komuna e Vushtrrisë

Lloji i kontratës	Numri i kontratave	Vlera totale
Furnizime	42	1,017,990.90€
Shërbime	20	1,482,015.00€
Punë	29	2,233,485.30€
Konkurs projektimi	/	0.00€

Burimi: Planifikimi i prokurimit e-prokurim, Komuna e Vushtrrisë

23.2 Kontratat e planifikuara për punë dhe buxheti

Komuna Vushtrri në planifikimin e saj të prokurimit ka paraparë të zhvillojë 29 kontrata për kategorinë punë, në bazë të planifikimit të prokurimit vlerësohet si kategoria e dytë më me së shumti kontrata/ projekte që do të zhvillohen, bazuar në planifikim kjo kategori nuk është plotësuar sipas kërkesave ligjore. Pasi, në planifikimin e prokurimit u publikua të komunës janë të plotësuar vetëm përkrahimi i kontratës (titulli i kontratës), data e parashikuar e fillimit të prokurimit dhe vlera e parashikuar. Për më tepër, për këtë kategori do të thotë për projektet punë/ investimeve kapitale të parapara në planifikim dhe projektet e njëjta krahasuar me ligjin mbi ndarjet buxhetor 2020-2022 të miratuar në mars 2020 kemi një diferencë prej 3,853,514.70 €, që do të thotë në buxhetin e Kosovës kemi me shumë mjete në dispozicion në krahasim me planifikim, për më tepër, komuna vetëm në dy (2) raste ka deklaruar se janë projekte 2 dhe 3 vjeçare ndërsa, në buxhet identifikohen që për shumicë e projekteve ka mjete të ndara edhe për vitet në vijim.

Tabela 93: Numri i kontratave të planifikuara në plan të prokurimit dhe buxhet të Republikës së Kosovës, Komuna Vushtrri

Numri total i kontratave për punë	Vlera e parashikuar me plan të prokurimit (1)	Buxheti 2020-2022 (2)	Diferenca +/- (2-1)
29	2,233,485.30€	6,087,000.00€	+ 3,853,514.70 €

Burimi: Planifikimi i prokurimit e-prokurim, Ligji nr.007/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020

23.3 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë

Nga 29 kontrata sa i kishte planifikuar Komuna e Vushtrrisë për prokurim, INPO ka monitoruar pesë (5) projekte/kontrata të planifikuara me prokurim, ku kemi analizuar vlerën e parashikuar në planifikim të prokurimit dhe vlerën në njoftimin për kontratë. Nga kjo analizë vërejmë se komuna në dy (2) projekte kishte vepruar saktësisht siç edhe kishte planifikuar paraprakisht, do të thotë kishte vlerë të njëjtë si në planifikim të prokurimit edhe në njoftimin për kontratë të cilin e publikon në e-prokurim, në dy (2) kontrata tjera kishte vendosur vlerë më të vogël në njoftimin për kontratë, dhe njeri nga pesë (5) projektet e analizuar në njoftimin për kontratë kishte 15,000 € më pak në krahasim me planifikim.

Tabela 94: Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për punë për vitin 2020, Komuna e Vushtrrisë

Nr.	Kontrata	Vlera në planifikim të prokurimit (1)	Vlera në njoftim për kontratë (2)	Diferenca +/- (2-1)
1	“Ndërtimi i trotuareve”	50,000.00€	49,991.42€	8.58€
2	“Renovimi (meremetimi) i shkollave”	70,000.00€	62,587.39€	7,412.61€
3	“Rregullimi i lumenjve dhe argjinaturave”	30,000.00€	30,000.00€	0.00€
4	“Ndërtimi i kiosqeve në sheshin Adem Jashari”	20,000.00€	20,000.00€	0.00€
5	“Renovimi i QMF-ve dhe instalimi i ngrohjeve me pelet”	25,000.00€	10,000.00€	15,000.00€

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim, Komuna e Vushtrrisë

23.4 Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizim

Në planifikimin e prokurimit Komuna e Vushtrrisë siç e elaboruam edhe më lartë kishte planifikuar të zhvillon 42 aktivitete për kategorinë furnizim. INPO ka monitoruar pesë (5) kontrata për furnizime. Në përgjithësi planifikimi i prokurimit i publikuar nuk është plotësuar më të gjitha të dhënat e kërkuara siç parashihet më kërkesat ligjore dhe si i tillë nuk pasqyron transparencë të plotë këtu nuk janë të plotësuar fushat si njësia, sasia e përafërt vjetore dhe çmimi për njësi.

Nga përgjedhja e pesë (5) për furnizim, vërejmë se përkundër që në plan të prokurimit komuna nuk kishte vendosur sasi të njësit, gjatë fazës tenderuese vërehet që bëhet fjalë për sasi dhe njësi matëse të ndryshme ashtu siç mund të shihen në vijim.

Tabela 95: Zbatueshmëria e planifikimit të kontratave për furnizime për vitin 2020, Komuna e Vushtrrisë

#	Planifikimi			Tenderimi		
Kontrata	Njësia	Sasia	Vlera totale	Njësia	Sasia	Vlera totale
“Furnizimi me makina për kositjen e barit”	/	/	35,000.00€	Copë	35	44,002.00€
“Furnizimi dhe montimi i serave”	/	/	80,000.00€	Copë	2755	108,996.50€
				m	12760	
				m ²	8700	
“Furnizimi me makina për shpërndarjen e plehut organik”	/	/	36,000.00€	Copë	7	36,000.00€
“Automjet i terrenit për shëndetësi”	/	/	25,000.00€	Copë	1	25,000.00€
“Furnizim me pajisje mjekësore”	/	/	50,000.00€	Copë	11	50,000.00€

Burimi: Planifikimi i prokurimit dhe njoftimet e-prokurim (përshkrimi i çmimeve), Komuna e Vushtrrisë.

KONKLUZIONET

- Në përgjithësi, komunat kanë dështuar që të hartojnë planifikimin e prokurimit konform kërkesave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.
- INPO ka vërejtur se përveç komunave: Kamenicë, Mitrovicë e Veriut, Viti dhe Glogoc në komunat tjera të fokusit vlera e projekteve të planifikuara për punë është më e madhe sesa mjetet buxhetore që komunat i kanë në dispozicion.
- Dallimet në vlerat e mjeteve të planifikuara për kontratat për punë për komunat: Ferizaj, Kaçanik, Podujevë, Suharekë dhe Gjilan vjen si rrjedhojë e dështimit të tyre që në PP të saktësojnë se bëhet fjalë për projekte, financimi i të cilave përfshinë periudha më të gjata se një vit.
- NPO ka vërejtur se përveç komunave: Mitrovicë e Jugut, Deçan, Gjakovë, Mitrovicë e Veriut, Vushtrri, Leposaviq, komunat tjera kanë inicuar procedura të prokurimit për kontrata për punë me vlerë më të madhe sesa vlera e mjeteve të planifikuara.
- Asnjëra nga komunat e monitoruara, nuk e ka hartuar planin e prokurimit për kontratat për furnizim në bazë të kërkesave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës. Respektivisht, mungojnë detajet e arsyeshme për projektet e planifikuara. Komuna e Klinës në parim në plan të prokurimit ka vendosur artikujt, sasitë dhe njësitë, mirëpo gjatë hulumtimit vërejmë se të njëjtat nuk janë të sakta.
- Mospërputhje të mëdha tek kontratat për furnizim evidentohen në të gjitha komunat e fokusit, ku mungojnë ose nuk përputhen njësitë matëse dhe sasitë e parashikuara, përkatësisht njësitë matëse të përdorura janë të panjohura dhe joadekuate. Përgjithësisht Komuna e Kaçanikut dhe Komuna e Mitrovicës së Veriut të cilat edhe përkundër se kanë zhvilluar aktivitete të prokurimit për furnizim, asnjëra nga këto aktivitete nuk janë të përfshira në plan të prokurimit.
- Në disa komuna, edhe përkundër që janë zhvilluar aktivitete të prokurimit për punë dhe furnizime, INPO nuk ka mundur të identifikojë së paku 5 aktivitete/kontrata të përfshira në plan të prokurimit. Më konkretisht, për komunat: Deçan, Mitrovicë e Jugut, Kamenicë dhe Gjilan INPO nuk ka mundur të identifikojë së paku 5 aktivitete/kontrata për punë. Për komunat: Dragash, Ferizaj, Klinë dhe Mitrovicë e Jugut INPO nuk ka mundur të identifikojë së paku 5 aktivitete/kontrata për furnizime.
- Me përjashtim të komunave: Viti, Prizren, Dragash, Mitrovicë e Veriut dhe Kamenicë INPO ka evidentuar se për të gjitha komunat tjera të fokusit ekzistojnë projekte që janë planifikuar me plan të prokurimit por që të njëjtat nuk mund të identifikohen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.
- Në komunat: Ferizaj, Klinë, Deçan, Gjakovë, Pejë, Gjilan, Podujevë, Mitrovicë e Veriut, Shtime dhe Prishtinë INPO ka evidentuar se ekzistojnë projekte për punë të përfshira në Buxhetin e Kosovës të cilat janë fuzionuar në projekte tjera ose emërtimi i tyre nuk përshtatet me emërtimin sipas planit të prokurimit.
- Komuna e Prishtinës, Pejës dhe Gjilanit projektet për punë të përfshira në plan të prokurimit i kanë fuzionuar në kode të përbashkëta në Buxhetin e Kosovës, duke e vështirësuar kështu evidentimin nëse projekti i planifikuar ka mbulueshmëri buxhetore.

REKOMANDIMET

- Komunitat të hartojnë Planifikimin e Prokurimit në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.
- Përveç komunave: Kamenicë, Mitrovicë e Veriut, Viti dhe Glogoc, komunitat tjera të fokusit të sigurohen se vlera e projekteve të planifikuara për punë të mos jetë më e madhe sesa vlera e mjeteve buxhetore që kanë në dispozicion.
- Komunitat: Ferizaj, Kaçanik, Podujevë, Suharekë dhe Gjilan të saktësojnë në mënyrë të qartë në plan të prokurimit se projektet janë një, dy apo më shumë vjeçare.
- Përfshijë komunitat: Mitrovicë e Jugut, Deçan, Gjakovë, Mitrovicë e Veriut, Vushtrri dhe Leposaviq, komunitat tjera të fokusit të sigurohen që të mos iniciojnë procedura me vlerë më të madhe sesa vlera e planifikuar e projekteve.
- Komunitat të sigurohen që planifikimi i kontratave për furnizim të bëhet sipas kërkesave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, duke përfshirë detajet e arsyeshme për projektet e planifikuara.
- Të gjitha Komunitat e fokusit të sigurohen që gjatë zhvillimit të procedurave të tenderimit të sigurohen që të mos ketë shpërputhje të njësive matëse dhe sasive krahasuar me planin e prokurimit si dhe njësitë matëse të përdorura të jenë të njohura dhe adekuate.
- Komunitat Deçan, Mitrovicë e Jugut, Kamenicë dhe Gjilan të sigurohen që të zhvillojnë procedurat e prokurimit për aktivitetet/kontratat për punë në përputhje me planin e prokurimit. Ndërsa komunitat Dragash, Ferizaj, Klinë dhe Mitrovicë e Jugut Gjilan të sigurohen që të zhvillojnë procedurat e prokurimit për aktivitetet/kontratat për furnizim në përputhje me plan të prokurimit.
- Me përjashtim të komunave Viti, Prizren, Dragash, Mitrovicë e Veriut dhe Kamenicë, komunitat tjera të fokusit të bëjnë harmonizimin e projekteve të përfshira në plan të prokurimit me buxhetin e Republikës së Kosovës. Më konkretisht projektet e përfshira në plan të prokurimit të jenë të identifikueshme edhe në buxhet.
- Komunitat Ferizaj, Klinë, Deçan, Gjakovë, Pejë, Gjilan, Podujevë, Mitrovicë e Veriut, Shtime dhe Prishtinë të sigurohen që të mos ketë dallime në emërtimin e projekteve për punë të përfshira në plan të prokurimit krahasuar me ato në Buxhetin e Republikës së Kosovës.
- Komunitat Prishtinë, Pejë dhe Gjilan të ndryshojnë praktikën e kodeve të përgjithshme buxhetore, përkatësisht secili aktivitet i planifikuar për punë të jetë lehtë i identifikueshëm në buxhet.
- Komunitat të hartojnë Planifikimin e Prokurimit në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.
- Përveç komunave: Kamenicë, Mitrovicë e Veriut, Viti dhe Glogoc, komunitat tjera të fokusit të sigurohen se vlera e projekteve të planifikuara për punë të mos jetë më e madhe sesa vlera e mjeteve buxhetore që kanë në dispozicion.
- Komunitat: Ferizaj, Kaçanik, Podujevë, Suharekë dhe Gjilan të saktësojnë në mënyrë të qartë në plan të prokurimit se projektet janë një, dy apo më shumë vjeçare.
- Përfshijë komunitat: Mitrovicë e Jugut, Deçan, Gjakovë, Mitrovicë e Veriut, Vushtrri dhe Leposaviq, komunitat tjera të fokusit të sigurohen që të mos iniciojnë procedura me vlerë më të madhe sesa vlera e planifikuar e projekteve.
- Komunitat të sigurohen që planifikimi i kontratave për furnizim të bëhet sipas kërkesave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, duke përfshirë detajet e arsyeshme për projektet e planifikuara.

- Të gjitha Komunat e fokusit të sigurohen që gjatë zhvillimit të procedurave të tenderimit të sigurohen që të mos ketë shpërputhje të njësive matëse dhe sasive krahasuar me planin e prokurimit si dhe njësitë matëse të përdorura të jenë të njohura dhe adekuate.
- Komunat Deçan, Mitrovicë e Jugut, Kamenicë dhe Gjilan të sigurohen që të zhvillojnë procedurat e prokurimit për aktivitetet/kontratat për punë në përputhje me planin e prokurimit. Ndërsa komunat Dragash, Ferizaj, Klinë dhe Mitrovicë e Jugut Gjilan të sigurohen që të zhvillojnë procedurat e prokurimit për aktivitetet/kontratat për furnizimë në përputhje me plan të prokurimit.
- Me përjashtim të komunave Viti, Prizren, Dragash, Mitrovicë e Veriut dhe Kamenicë, komunat tjera të fokusit të bëjnë harmonizimin e projekteve të përfshira në plan të prokurimit me buxhetin e Republikës së Kosovës. Më konkretisht projektet e përfshira në plan të prokurimit të jenë të identifikueshme edhe në buxhet.
- Komunat Ferizaj, Klinë, Deçan, Gjakovë, Pejë, Gjilan, Podujevë, Mitrovicë e Veriut, Shtime dhe Prishtinë të sigurohen që të mos ketë dallime në emërtimin e projekteve për punë të përfshira në plan të prokurimit krahasuar me ato në Buxhetin e Republikës së Kosovës.
- Komunat Prishtinë, Pejë dhe Gjilan të ndryshojnë praktikën e kodeve të përgjithshme buxhetore, përkatësisht secili aktivitet i planifikuar për punë të jetë lehtë i identifikueshëm në buxhet.

www.inpo-ks.org

Iniciativa per Progres eshte organizate jo-qeveritare dhe jo-fitimprurese e themeluar ne vitin 2005 me qellim qe te perparoj pjesemarrjen e qytetareve ne proceset shoqerore. Organizata INPO funksionon ne baze te programeve te saj: Programi per Qeverisje te Mire, dhe Programit per Zhvillim Demokratik.